



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të së Drejtës**

**KOSOVË**

**SHQYRTIM I SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE  
(Mars 2002 - prill 2003)**

**“MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE”**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>FJALORI.....</b>	<b>4</b>
<b>PJESA 1: .....</b>	<b>6</b>
<b>HISTORIKU .....</b>	<b>6</b>
1. MANDATI I SEKSIONIT PËR MONITORIM TË SISTEMIT JURIDIK .....	6
2. MONITORIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE .....	7
3. MARRËDHËNIET ME SHTYLLAT DHE ORGANIZATAT TJERA .....	8
4. FUSHËVEPRIMI I RAPORTIT .....	8
<b>PJESA 2: .....</b>	<b>10</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>10</b>
<b>PJESA 3: .....</b>	<b>11</b>
<b>MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE.....</b>	<b>11</b>
A. HYRJE.....	11
B. MASAT PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE NË KOSOVË .....	13
C. ÌNCIDENTET E FRIKËSIMIT TË DËSHMITARËVE .....	15
D. PËRMIRËSIMI I SISTEMIT PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE NË KOSOVË .....	21
E. PËRFUNDIMET.....	27
F. REKOMANDIMET .....	27
<b>PJESA 4: .....</b>	<b>29</b>
<b>CËSHËTJET QË PËRSËRITEN NGA RAPORTET E KALUARA.....</b>	<b>30</b>
A: PAVARËSIA E GJYQËSISË .....	30

B:	PARABURGIMI.....	33
C:	VEPRAT PENALE QË KANË TË BËJNË ME TRAFIKIMIN DHE PËRGJIGJA E ORGANEVE TË UNMIK-UT NDAJ KËSAJ DUKURIE .....	42
D:	QASJA NË AVOKAT MBROJTËS EFIKAS.....	48

**PJESA 5: ..... 54**

**ZHVILLIMET E RËNDËSISHME NË SISTEMIN JURIDIK..... 54**

1.	REGULLORET .....	54
2.	URDHËRESAT ADMINISTRATIVE.....	54
3.	KOMITETI MBIKQYRËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE GRUPI PUNUES NDËR-SHTYLLOR MBI TË DREJTAT E NJERIUT.....	54
4.	HAPJA E GJYQEVE TË REJA PËR BASHKËSITË E PAKICAVE DHE INTEGRIMI GJYQËSOR NË ZHVILLIM E SIPËR .....	55
5.	QASJA NË GJYQE.....	55
6.	STATUSI I KODIT TË PËRKOSSHËM PENAL DHE ATIJ TË PROCEDURËS PENALE .....	56

## FJALORI

ABA/CEELI	Shoqata e Juristëve Amerikanë/ Nisma për Evropë Qëndrore dhe Juglindore
AKSH	Armata Kombëtare Shqiptare
DD	Departamenti i Drejtësisë
KEFD	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas
KOMKFOR	Komandanti i Forcës së Kosovës të udhëhequr nga NATO
NjMA	Njësiti për Mbrojtjen nga afër të personave
QPS	Qendrat për Punë Sociale
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijut
DKPK	Drafti i Kodit të Procedurës Penale
DSHMS	Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
KP RFJ	Kodi Penal i Republikës Federale të Jugosllavisë
KPK RFJ	Kodi i Procedurës Penale i Republikës Federale të Jugosllavisë
IRjM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
MNDKP	Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
NjIGj	Njësiti për Inspektim Gjyqësor
KFOR	Forca e Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KPK	Kodi Penal i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
LK	Ligji mbi Kundërvajtjet
SMSJ	Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik

GjKK	Gjykata Komunale për Kundërvajtje
NATO	Organizata e Traktatit të Alencës Veriatlantike
KLDNJ	Zyra e Komesarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RKS	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SHSFAE	Shtabi Suprem i Forcave Aleate në Evropë
NjHTP	Njësiti për Hetime të Trafikimit dhe Prostitucionit
UNHCR	Komesariati i Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
NjMNV	Njësiti për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
NjMD	Njësiti për Mbrojtje të Dëshmitarit

## PJESA 1:

### HISTORIKU

Ky shqyrtim është përgatitur nga Seksioni për monitorim të sistemit juridik (SMSJ), i cili është pjesë e Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës (Departamenti) pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë. OSBE-ja funksionon nën ombrellën e Misionit të administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, si shtyllë e saj përgjegjëse për ndërtimin e institucioneve.

Kjo pjesë ka për qëllim të ofrojë një historik të shkurtër përkitazi me këtë raport, si dhe të jap një përshkrim të saj në kontekst institucional të SMSJ-së dhe Departamentit në fjalë.

#### 1. Mandati i seksionit për monitorimin e sistemit juridik

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit (RKS 1244) e autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të themelojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë, e cila do të sigurojë një administratë të përkohshme në vend. Njëra nga përgjegjësitë kryesore të kësaj pranie ndërkombëtare është edhe “*mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut.*”<sup>1</sup>

Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve, në raportin e tij të paraqitur para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me 12 qershor 1999, rolin udhëheqës në ndërtimin e institucioneve në kuadër të UNMIK-ut, ia përcaktoi vetë OSBE-së, duke bërë me dije se njëra nga përgjegjësitë e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve (Shtylla III) duhet të përfshijë monitorimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e kapaciteteve. Ai gjithashtu udhëzoi OSBE-në të zhvillojë mekanizma të koordinuar mirë me qëllim të lehtësimit të monitorimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor:

“UNMIK-u do të ketë bazën e monitorëve të të drejtave të njeriut dhe këshilltarëve të cilët do të kenë *qasje të papenguar* në të gjitha pjesët e Kosovës, për të bërë hetimet lidhur me cënimin e të drejtave të njeriut dhe për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe çështjet e promovimit, të jenë të adresuara përgjatë aktiviteteve të gjithëmbarshme të misionit. Monitorët e të drejtave të njeriut, përmes zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Ndërtimin e Institucioneve, do t'i raportojnë konstatimet e tyre Përfaqësuesit Special. Konstatimet e monitorëve të të drejtave të njeriut do të bëhen publike në mënyrë të rregullt dhe do të ndahen, sipas nevojës, edhe me mekanizmat e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, në konsultim me zyren e Kombeve të Bashkuara të Komesarit të lartë për të drejtat e njeriut. UNMIK-u do të sigurojë raportim të koordinuar dhe aftësi përgjegjëse.” (Para.87)

Në Letrën e marrëveshjes, e datuar më 19 korrik 1999, në mes të nën-Sekretarit të Përgjithshëm për operacionet paqëruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësuesit të udhëheqësit të zyrës së OSBE-së, qëndron se, Shtylla për ndërtimin institucional- (Shtylla III), OSBE duhet të zhvilloi mekanizmat të cilët sigurojnë, që gjykatat, tribunatet administrative dhe strukturat tjera gjyqësore, të veprojnë në pajtueshmëri me standardet

ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut.<sup>2</sup> Në kuadër të OSBE-së, Departamenti ka përgjegjësi të monitorojë dhe raportojë mbi gjendjen e sistemit juridik në kontekst të sundimit të së

<sup>1</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 12 qershor 1999, para. 11/j.

<sup>2</sup> Qarkorja e Departamentit të Drejtësisë (2001/15), e lëshuar më 6 qershor 2001, vërtetoi se monitoruesit e gjykimeve të SMSJ-së me disa përjashtime, duhet të gëzojnë qasje në të gjitha seancat gjyqësore dhe shkresat e lëndës. Kjo qarkore ka për

drejtës dhe të drejtave të njeriut. Si një seksion përkatës në kuadër të Departamentit, SMSJ-ja ka për detyrë të monitorojë rastet e ndryshme në kuadër të sistemit të drejtësisë penale, duke vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare, si dhe të raportojë mbi çështjet brengosëse në këtë fushë.

## 2. Monitorimi i sistemit të drejtësisë penale

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>3</sup> janë pjesë e ligjit të zbatueshëm në Kosovë, nëpërmjet të, *inter alia*, Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 – e cila i obligon të gjithë ata persona të cilët kryejnë funksion publik t’i përmbahen standardeve të pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut – sikurse edhe nëpërmjet të Kornizës kushtetuese.<sup>4</sup> Për këtë arsye, gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë së tyre me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut OSBE-ja si bazë për analizë shfrytëzon edhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Rastet monitorohen që nga momenti i arrestimit apo paraburgimit, gjatë fazës së procedurës hetimore, gjykimit dhe procedurës sipas mjetit juridik. Të gjitha analizat dhe diskutimet në këtë shqyrtim janë të bazuara në shënime dhe informata faktike të mbledhura gjatë periudhës raportuese të monitorueve të SMSJ-së (monitoruesit) dhe atyre në dispozicion në kuadër të selisë së SMSJ-së. Monitoruesit e gjykimeve kryesisht mbulojnë rastet penale në pesë gjykata të qarkut në Kosovë, dhe rastet në procedurën sipas mjetit juridik pranë Gjykatës Supreme në Kosovë. Gjithashtu vëzhgohen edhe disa raste të caktuara pranë gjykatave komunale.

Informatat mbledhen përmes pjesëmarrjes nëpër seanca gjyqësore, raportit të shkresave të lëndës dhe duke zhvilluar intervista me gjyqtarë, nëpunës të sistemit të drejtësisë, prokurorë, avokatë dhe zyrtarë të organeve për zbatimin e ligjit. Gjatë kësaj periudhe raportuese monitoruesit e gjykimeve vëzhguan mëse 150 raste, përfshirë këtu edhe hetimet gjatë procedurës paraprake dhe vetë gjykimin. SMSJ-ja u jep prioritet të veçantë rasteve si në vazhdim:

- Krimeve të luftës
- Krimet të organizuar
- Krimeve me motive etnike
- Krimeve me motive politike
- Dhunës seksuale përfshirë këtu edhe rastet e dhunës familjare dhe trafikimit të gruas
- Paraburgimit
- Trajtimin të të miturve

---

qëllim të përmirësuar mirëkuptimin e gjyqësisë ndaj mandatit të OSBE-së, dhe të sigurojë që monitoruesit e gjykimeve të kenë mundësi të mbulojnë të gjitha fazat e procedurës penale.

<sup>3</sup> Këto standarde ndërkombëtare janë të detajuara, *inter alia*, në nenet 9, 10, 14 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat politike dhe civile (MNDPC) dhe nenet 5, 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNj). Ligji vendës, kryesisht Ligji i procedurës penale i RFJ-së dhe Ligji penal i Kosovës, janë baza për analizë të OSBE-së. Analizat e ‘gjykimit të drejtë’ në bazë të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut fillojnë nga momenti kur një person është i arrestuar dhe paraburgosur nga autoritetet, deri në zgjidhjen përfundimtare të lëndës.

<sup>4</sup> Regullorja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme, e miratuar më 15 maj 2001, kapitulli 3, neni 3.3 thotë se “dispozitat mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të parapara me këto instrumente [instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut] do të jenë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejt në Kosovë.”

### **3. Marrëdhëniet me shtyllat dhe organizatat tjera**

Shtylla I e UNMIK-ut për polici dhe drejtësi, bën përpjekje për të konsoliduar “strukturën e rendit dhe ligjit i cili do të ishte funksional, dhe në veçanti të krijojë një proces të paanshëm gjyqësor nëpërmjet të pjesëmarrjes ndërkombëtare dhe reformimit të sistemit gjyqësor.”<sup>5</sup> Ngjashëm, qëllimi i Departamentit në fjalë të OSBE-së është të promovojë zhvillimin e një shoqërie e cila bazohet në sundimin e së drejtës, shoqëri kjo e cila garanton një respekt të plotë për të drejtat e njeriut.

Departamenti punon në bashkëpunim të ngushtë me organet e KB-ve përfshirë këtu edhe KLDNJ, UNHCR-së dhe UNICEF-it sikurse edhe organizatat tjera siç janë Këshilli i Evropës, Komiteti ndërkombëtar i kryqit të kuq, Organizata ndërkombëtare për migrim (OIM) dhe Shoqatën e juristëve amerikan, nisma për Evropë Qëndrore dhe Jugindore (ABA-CEELI). Që nga nëntori 2001, OSBE-ja ka bashkëpunuar mjaft edhe me Tribunalin ndërkombëtar penal për ish-Jugosllavinë nëpërmjet të Zyrës së qasjes së këtij Tribunali, e cila ndodhet në Prishtinë/Priştina. OSBE-ja ofron informata të rregullta të azhuruara për koordinatorin e zyrës së qasjes për Kosovë, përkritazi me gjykimet në zhvillim e sipër për krime të luftës dhe krime me motive politike/etnike nëpër gjykatat vendëse.

SMSJ-ja, si pjesë e Departamentit në fjalë, mban një marrëdhënie të bashkëpunimit të mirë edhe me shtyllat dhe agjencitë tjera ndërkombëtare. Shkeljet sistematike, trendet e vëzhguara, problemet individuale dhe çështjet të cilat identifikohen nga SMSJ-ja, në kuadër të mandatit të gjerë të OSBE-së, i komunikohen Departamentit administrativ të drejtësisë (“DD-së”) nëpërmjet të raporteve javore të cilat i përpilon Departamenti në fjalë. Për më tepër SMSJ-ja ka shprehur gatishmërinë e të punojë ngushtë me DD-në me qëllim që t’i ndihmojë këtij të fundit në adresimin e shqetësimeve sistematike në këtë fushë.

### **4. Fushëveprimi i raportit**

Në dy raportet e para për sistemin e drejtësisë penale në Kosovë,<sup>6</sup> OSBE-ja ka prezentuar një pasqyrë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse për sistemin e drejtësisë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut. Shqetësimet e shprehura në këto shqyrtime i referohen rasteve të posaçme ku nëpërmjet të aktiviteteve të tyre, gjyqësia, administratorët e saj dhe organet për zbatimin e ligjit, kanë dështuar të veprojnë në pajtim me standardet dhe garancat për gjykim të drejtë dhe proces të rregullt. Raporti i tretë i OSBE-së<sup>7</sup> ka lëvizur fushëveprimin e tij drejt identifikimit të problemeve në kuadër të sistemit gjyqësor në nivel struktural të tij. Rastet e veçanta të sistemit të drejtësisë penale, të cilat janë marrë parasysh me qëllim të ngritjes së çështjeve me rëndësi të të drejtave të njeriut, janë adresuar në këtë vazhdë. Praktikant si paraburgimi i paligjshëm dhe rastet e trafikimit dhe dhunës seksuale janë adresuar me qëllim të potencimit të mospajtueshmërisë së këtyre praktikave me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Raporti i katërt me rradhë i OSBE-së raportonte mbi problemet dhe shqetësimet që kanë të bëjnë me pavarësinë e gjyqësisë, pushtetin për paraburgim të cilin e ushtrojnë organet ekzekutive ose ushtarake si dhe çështjet e vazhdueshme të paraburgimit arbitrar të personave me sëmundje mentale në Kosovë.

Raporti i tanishëm përqëndrohet në mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Ky shqyrtim gjithashtu adreson një sërë çështjesh të cilat janë ngritur në raportet paraprake (të njohura me

<sup>5</sup> Lexo prezentimin e ZPPSP-së mbi Shtyllën I në artikullin me emër “Themelimi i shtyllës së re të policisë dhe drejtësisë” në *Lajmet e UNMIK-ut Nr. 93*, 21 maj 2001.

<sup>6</sup> Raporti i OSBE-së mbi sistemin e drejtësisë penale, 1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000 (mëtuftje raporti i parë); Raporti i OSBE-së mbi sistemin e drejtësisë penale, 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001 (mëtuftje raporti i dytë).

<sup>7</sup> Raporti i OSBE-së mbi sistemin e drejtësisë penale, tetor 2001 (mëtuftje raporti i tretë).



termin “çështjet të cilat përsëriten”) të cilat kryesisht janë, pavarësia e gjyqësisë, paraburgimi, veprat penale të trafikimit dhe qasja efektive në avokat mbrojtës. Në secilën pjesë, raporti potencon rekomandimet gjegjëse me qëllim të ofrimit të ndihmës për shtyllën I të UNMIK-ut dhe organeve tjera përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe praktikave të tyre.

Rastet të cilat mbështesin apo ilustrojnë analizat dhe përfundimet e këtij raporti, paraqiten në paragrafe të ndara. Kjo ka për qëllim t’i ndihmojë lexuesit që t’i dallojë shembujt ilustrues nga paragrafët me karakter analitik.

## **PJESA 2:**

### **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Incidentet e kohëve të fundit në Kosovë, kanë dhënë shkas për brengosje se shkalla e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë është në rritje. Për më tepër, ka shenja se pjesa më e madhe e publikut të përgjithshëm nuk ka ndonjë besim të madh në aftësinë e autoriteteve për të ofruar mbrojtje të arsyeshme për këta dëshmitarë, nëse në raste të caktuara këta të fundit vendosin për të dëshmuar kundër kryesve të veprave penale. Kjo paraqet një zhvillim serioz, duke marrë parasysh se dëshmitarët luajnë një rol të rëndësishëm në ndjekjen e të pandehurve; dhe përfundimin e suksesshëm të shumicës së gjykimeve rrjedha e të cilave varet në masë të madhe nga vetë dëshmitarët të cilët e deklarojnë atë që e dijnë, çka kanë parë apo dëgjuar. Duke pranuar rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, dhe detyrimin e UNMIK-ut që të organizojë procedurën gjyqësore në atë mënyrë që interesat e dëshmitarëve të mbrohen ashtu si duhet, ky raport thekson nevojën për zhvillimin e një sistemi më efikas për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë.

Raporti në fjalë trajton edhe çështjen e sistemit për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë dhe shqyrton edhe efikasitetin e tij në dritën e incidenteve të frikësimit të dëshmitarëve të cilat janë monitoruar gjatë periudhës raportuese. Në vazhdim janë shtjelluar dy metodat kryesore në ofrimin e mbrojtjes për dëshmitarë gjatë procedurës gjyqësore. Ato janë, mbrojtja fizike e cila ofrohet nga Njësi për mbrojtjen e dëshmitarit, dhe masat të cilat kanë për qëllim fshejhen e identitetit të dëshmitarit, të cilat mund të urdhërohen nga gjykata në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/20.<sup>8</sup>

Përderisa mirëpresim vëmendjen e shtuar të cilën autoritetet i'a kushtojnë çështjeve të mbrojtjes së dëshmitarit gjatë dy viteve të fundit, raporti gjen se, shumë aspekte të sistemit në fjalë duhet të zhvillohen dhe madje edhe të përmirësohen. Në veçanti, ajo shtyt UNMIK-un që të përmirësojë mirëbesimin publik në aftësinë e tij për të ofruar mbrojtje të duhur për dëshmitarët. Në këtë drejtim, raporti potencon një sërë rekomandimesh të posaçme.

OSBE-ja është e mendimit se çështja e mbrojtjes së dëshmitarëve do të bëhet gjithnjë më e rëndësishme në muajt e ardhshëm përderisa DD-ja do t'i kushtojë një vëmendje të shtuar adresimit të çështjeve të krimit organizuar.

---

<sup>8</sup> Regullorja e UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurat gjyqësore, shtator 2001.

## PJESA 3:

### MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE

#### A. Hyrje

*“Korniza ligjore e cila mundëson marrjen e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve në mënyrë të qartë dhe të rregulluar, është e domosdoshme për garantimin e të drejtës së individit për gjykim të drejtë, që parashihet me Konventën evropiane për të drejtat e njeriut, rezultatin e duhur të gjykimit në të cilin ushtrohet shtrëngimi i paligjshëm ndaj dëshmitarit, sigurinë personale të dëshmitarëve të kanosur dhe mirëqenien e dëshmitarëve të cilët si rrjedhojë e krimit gjenden nën presion të dëmshëm psikologjik.”<sup>9</sup>*

Dëshmitarët, duke përfshirë këtu edhe ‘dëshmitarët viktimë’, luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë; që nga raportimi fillestar i krimit para policisë e deri te ndjekja e sukseshme penale gjatë gjykimit, dëshmitarët janë mëse të nevojshëm për të thënë atë që kanë dëgjuar apo parë. Sidoçoftë, nëse dëshmitarët besojnë se duke i’u ndihmuar autoriteteve do të vënë vetveten, apo familjet e tyre në rrezik, ata vendosin që të heshtin për shkak të frikës nga represaljet. Është i pakundërshtueshëm fakti se nëse dëshmitarët pushojnë të ofrojnë informata policisë, apo dëshmi gjyqit, atëherë kjo do të ketë ndikim negativ në rrjedhën e ndjekjes penale, ku si rezultat i kësaj, drejtësia do të zëvendësohet me pandëshkueshmëri. UNMIK-u ka për obligim të ofrojë një sistem të mbrojtjes efektive të dëshmitarëve, me qëllim që të sigurojë, si sigurinë personale të individëve, gjithashtu edhe funksionimin e rregullt të sistemit gjyqësor.

Kjo pjesë fillimisht e trajton çështjen e masave për mbrojtjen e dëshmitarit në Kosovë, duke përfshirë edhe objektet për mbrojtje të cilat sigurohen nga Njësi të mbrojtjes së viktimave sikurse edhe masat të cilat janë në dispozicion në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2001/20.<sup>10</sup> Mëpastaj do të shtjellojë incidentet e frikësimit të dëshmitarëve – raste këto të cilat janë monitoruar nga OSBE-ja gjatë periudhës raportuese. Dhe përfundimisht do të shqyrtojë mënyrat për përmirësimin e efikasitetit të sistemit për mbrojtjen e dëshmitarit, nëpërmjet të zhvillimeve të mundshme të reja në kuadër të programit për mbrojtjen e dëshmitarit dhe në kuadër të Rregullores, si dhe mënyrat për rritjen e besueshmërisë së publikut në gjyqësi.

#### *i. Detyrimi i shtetit për të ofruar sistem të mbrojtjes për dëshmitarë*

Në bazë të precedentit gjyqësor të KEDNJ-së, duhet t’i kushtojmë konsideratë të veçantë jetës, lirisë dhe sigurisë së dëshmitarëve. Në të vërtetë, këto interesa nuk duhet të rrezikohen pa arsye.<sup>11</sup> Përderisa të

<sup>9</sup> Lexo vendimin mbi hyrjen në fuqi të Ligjit mbi mbrojtjen e dëshmitarëve të kërcënuar dhe të rrezikuar, të pruar nga Përfaqësuesi i lartë për Bosnjë dhe Hercegovinë, 24 janar 2003.

<sup>10</sup> Rregullorja e UNMIK-ut mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore, shtator 2001.

<sup>11</sup> “Është e vërtetë që neni 6 [...] nuk parashihet në mënyrë përjashtimore që interesat e dëshmitarëve në përgjithësi, dhe të viktimave të cilët thirren për të dëshmuar, duhet të merren në konsideratë. Sidoçoftë, jeta, liria dhe siguria e tyre mund të vihet në rrezik, sikurse edhe interesat të cilat paralexohen me nenin 8 të Konventës [...]. Interesat e tilla të dëshmitarëve dhe viktimave janë në parim të mbrojtura me dispozita tjera substantive të Konventës, të cilat nënkuptojnë që palët nënshkruese të Konventës duhet t’i organizojnë procedurën penale në atë mënyrë ashtuqë interesat e tyre të mos rrezikohen pa arsye. Në bazë të kësaj çka u tha, parimet e gjykimit të drejtë kërkojnë që në rastet e caktuara interesat e palës mbrojtëse duhet vënë në baeaspeshë me ato të dëshmitarëve të cilët janë thirrur për të dëshmuar në gjyq.” Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, 23 prill 1997, paragrafi 53; *Visser kundër Holandës*, 14 shkurt 2002, paragrafi 43;

gjithë personat kanë obligim qytetar të dëshmojnë në mënyrë të sinqertë si dëshmitarë, shteti ka për obligim të ofrojë mbrojtje për dëshmitarët kundrejt çdo ndërhyrje apo rreziku i cili i'u shkaktohet atyre duke i'u ofruar atyre dhe të afërmeve të tyre mbrojtje e cila do të ofronte siguri efektive për ta, si para, gjatë dhe pas gjykimit. Mbrojtja e dëshmitarëve, për më tepër paraqet një domosdoshmëri e cila kalon përtej interesave personale të individëve dhe konsiderohet si obligim i autoriteteve publike të sigurojnë integritetin dhe efikasitetin e sistemit juridik.<sup>12</sup> Në këtë drejtim, Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës theksoi se – “ prokurorët publik duhet të marrin parasysh në mënyrë të duhur interesat e dëshmitarëve, veçanërisht të marrjes dhe promovimit të masave për mbrojtjen e jetës, sigurisë dhe jetës private të tyre, dhe të vërtetojnë mëtutje se masat e tilla janë ndërmarrë.<sup>13</sup> Këto masa, nuk duhet të cenojnë parimin themelor të ‘barazisë së palëve në procedurë,’ e cila garantohet me instrumente të numërta ndërkombëtare”.<sup>14</sup>

Për këtë arsye, shtylla I e UNMIK-ut , si autoritet publik në Kosovë, e cila është përgjegjëse për sistemin gjyqësor në Kosovë, ka për obligim të organizojë procedurat gjyqësore në atë mënyrë, ashtu që, të sigurojë mbrojtjen adekuate të interesave të dëshmitarëve.

## **ii. Pasqyrë mbi gjendjen në Kosovë**

Frikësimi i dëshmitarëve është një problem që përsëritet për vite të tëra në Kosovë, e që ka rezultuar në marrjen e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve nga ana e UNMIK-ut. Sidoqoftë, gjatë periudhës raportuese OSBE-ja ka regjistruar një numër të incidenteve të frikësimit të dëshmitarëve (apo dukjes se dëshmitarët janë frikësuar), dhe problemeve që kanë të bëjnë me kërcënime të bartësve të funksioneve gjyqësore. Ja disa shembuj për t’ju ilustruar sa më mirë seriozitetin e këtij problemi:

- Mediat e Kosovës raportuan se një bombë, e cila kishte shpërthyer në Prishtinë/Priştina në dhjetor 2002, kishte në shënjestër një dëshmitar i cili duhet të dëshmonte në gjykimin i cili do të pasonte kundër disa pjesëtarëve të lartë të UÇK-së;<sup>15</sup>

---

*Doorson kundër Holandës*, 26 mars 1996, paragrafi 70; *P.S. kundër Gjermanisë*, 20 dhjetor 2001, paragrafi 22. Lexo shtojcën mbi Këshillin e ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, Rekomandimi R\_(97)13, neni II(2).

<sup>12</sup> “Është e papranueshme që sistemi i drjetësisë penale të dështojë t’i bie të pandehurit para drejtësisë dhe të sigurojë aktgjykimin e duhur vetëm për shkak se dëshmitarët janë të diskutuar për të dëshmuar në mënyrë të lirshme dhe të sinqertë.” Rekomandimi R\_(97)13 i Këshillit të ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës mbi frikësimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e palës mbrojtëse, e miratuar më 10 shtator 1997.

<sup>13</sup> Rekomandimi R (2000)19 i Këshillit të ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës mbi rolin e ndjekjes penale në sistemin e drejtësisë penale, e miratuar më 6 tetor 2000.

<sup>14</sup> Në shikim të parë ideja që dëshmitari të jetë në gjendje të dëshmojë në mënyrë anonime në një rast penale duket të shkojë ndesh me parimet e parapara me Konventën evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNj) dhe jurisprudencën e Gjykatës evropiane. Njohja e identitetit të dëshmitarëve të ndjekjes penale e mundëson të akuzuarin dhe avokatin e tij mbrojtës të hetojnë dhe kundërshtojnë në mënyrë të duhur pohimet e dëshmitarit, veçanërisht të kundërshtojnë besueshmërinë e dëshmisë së tyre. Sidoqoftë, gjykatat në shumë jurisdikcione përballen me problemin e dëshmitarëve të cilët refuzojnë të dëshmojnë për shkak të fikës nga dhuna apo ndryshimit të rrëfimit të tyre për shkak të frikësimit. Në shumë raste dëshmitarët luajnë rol thelbësor në humbjen e rastit pas muaj e muaj të tërë të hetimeve gjatë procedurës paraprake. Së këndejmi, me qëllim që të ndihmohet në administrimin e drejtësisë, sistemet juridike kanë nxjerrur masa për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve, përfshirë këtu edhe mundësinë e dëshmisë anonime. Duke e realizuar një gjë të tillë, gjykatat mëtojnë të krijojnë një baraspeshë të të drejta e të të akuzuarit që të jetë në gjendje të testojë të gjitha dëshmitë që bihen kundër tij me domosdoshmërinë për mbrojtjen e dëshmitarit. Edhe pse nuk ekzistojnë rregulla të qarta të cilat definojnë baraspeshën, është e kuptueshme se çdo kompromis që bëhet për të baraspeshuar të drejtën e të akuzuarit për të ekzaminuar dëshmitarin duhet të jetë në pajtim me parimin e *barazisë së palëve në procedurë*. Shkalla e mbështetjes në dëshminë anonime kur të vlerësohet fajësia apo pafajësia e personit të akuzuar paraqet një faktor me rëndësi në arritjen e baraspeshës së duhur.

<sup>15</sup> “Ekzistojnë thashethëme se motivi i sulmit ishte dëshmia të cilën Enver Sekiraça [i cili supozohet të ketë qenë në shënjestër i sulmit me bombë] do ta jep në gjykimin kundër Rustem Mustafës - Remit. Në ndërkohë Enveri thekson se gjyqtarët

- Një dëshmitar në një gjykim tjetër i cili gjithashtu kishte të bënte me pjesëtarë të lartë të UÇK-së, ishte vrarë në Pejë/Peć në janar 2003, menjëherë pasi që kishte dëshmuar;
- Tetë ditë pas apelit të policisë drejtuar dëshmitarëve që të vijnë dhe të dëshmojnë në lidhje me vrasjen në fjalë, në ndërtesën e policisë rajonale të UNMIK-ut në Pejë/Peć, ishte hudhur një raketë antitank;<sup>16</sup>
- Më 5 shkurt 2003, kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren ishte sulmuar dhe rrahur jashtë shtëpisë së tij, rast ky i cili kishte shtyer anëtarët e gjyqësisë vendëse të bëjnë kërkesë për dhënien e lejes për bartjen e armëve.<sup>17</sup>

Perceptimi i opinionit publik se, as policia e as gjyqet nuk janë në gjendje të ofrojnë mbrojtje kundër dukurisë së frikësimit të dëshmitarëve, shumë lehtë mund të ashpësohet nga raportet e mjeteve të informimit publik dhe thashethëmet të cilat ekzistojnë në një shoqëri ngushtë të lidhur, siç është ajo e Kosovës. Incidentet e lartëpërmendura, për shembull, kanë rezultuar në publikimin në media të artikujve me titull si *“Dëshmitarët –një racë e cila po zhduket në Kosovë,”* *“gjyqtarët vendës kanë filluar të brengosen për vetën e tyre”* dhe *“rastet e karakterit mafioz kanë krijuar pasiguri,”*<sup>18</sup> të cilët mund të shërbejnë për të ngulitur edhe mëtej frikën në mendjen e opinionit publik dhe të krijojnë edhe mëtej një hezitim tek dëshmitarët për t’ju ndihmuar autoriteteve.

Në muajt e ardhshëm, përderisa DD-ja është duke u përqëndruar vëmendjen në luftimin e krimit të organizuar, çështja e mbrojtjes së dëshmitarëve po bëhet gjithnjë më e rëndësishme.

## **B. Masat për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë**

Në Kosovë, në përpjekjet për të ndihmuar administrimin e drejtësisë, dy metoda të reja të ndërlidhura në mes veti të cilat ofrojnë mbrojtje për dëshmitarët në procedurat gjyqësore janë prezentuar në praktikë. Së pari, mbrojtja fizike e dëshmitarëve ofrohet para, gjatë dhe pas gjykimit nga një njësi e specializuar policore e njohur si Njësi për mbrojtjen e dëshmitarit (NjMD ose Njësti). Së dyti masat për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve gjatë dhënies së dëshmisë, administrohen nga gjykatat në pajtim me kornizën ligjore, e cila kryesisht buron nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/20, mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurat gjyqësore, e shtatorit 2001 (Rregullorja).<sup>19</sup> Së bashku, këto dy metoda të ofrimit të mbrojtjes për dëshmitarët mund të quhen edhe “sistem i mbrojtjes së dëshmitarit.”

### **i. Shërbimet mbrojtëse të ofruara nga Njësi për mbrojtjen e dëshmitarit**

ndërkombëtar i kanë ofruar Saliut, [vëllaut të Enver Sekiraçës] të dëshmojë në gjyq. Mirëpo ai nuk dëshmoi. Ai ka të njëjtin mendim mirëpo nuk e di se çka do të ndodh mëpastaj. Gazeta lokale ‘Koha Ditore’, 16 dhjetor 2002 (përkthim nga Seksioni për Monitorim të Mediave i OSBE-së).

<sup>16</sup> Mediat lokale raportuan se Komisioneri i policisë së UNMIK-ut i kishte deklaruar mjeteve të informimit publik se sulmi ishte dizajnuar që të tërheq vëmendjen e policisë nga hetimet të cilat ishin në zhvillim e sipër në rajonin e Pejës/Peć. Lexo programin e RTK-së dhe Radio Kosovës të transmetuar më 24 janar 2003.

<sup>17</sup> Më 7 shkurt 2003 Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës i’a kishte dërguar një letër PSSP-së, në të cilën thuhet se “ne kërkojmë që të shfrytëzoni autoritetin tuaj që të ndikoni në organet të cilat janë përgjegjëse për siguri me qëllim që të sigurohen masa për siguri personale dhe kolektive për anëtarët e gjyqësisë kosovare. Së këndejmi, është e domosdoshme që të rilexohet qëndrimi i tanishëm i policisë që të mos u lejohet gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovar të mbajnë revole për vetëmbrojtje dhe të ndër marrin veprime tjera të nevojshme, qëndrim ky i organeve përgjegjëse për siguri në Kosovë.”

<sup>18</sup> Koha Ditore, 17 dhjetor 2002, Koha Ditore, 21 shkurt 2003, dhe Kosova Live, 23 janar 2003, respektivisht.

<sup>19</sup> Lexo gjithashtu, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/1 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore, datës 24 janar 2002, e cila zgjeron zbatueshmërinë e përkohshme të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20; dhe ‘Urdhëresës administrative Nr. 2002/25, mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore,’ e datës 13 nëntor 2002.

NjMD është themeluar në qershor 2001 nën autoritetin e komisionerit të policisë së UNMIK-ut për të formuar dhe administruar programin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Operacionet e këtij njësi përfshijnë edhe ofrimin e objekteve strehuese për dëshmitarët në Kosovë derisa ata të dëshmojnë në gjyq, ku në fund ata dërgohen edhe në ndonjë vend të jashtëm pas gjykimit.<sup>20</sup>

Njësi operon në baza të statutit i cili vepron së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/20. Të dyja këto konsiderohen të jenë të nevojshme në luftën kundër dukurisë së frikësimit të dëshmitarëve; në ofrimin e mbrojtjes për palët e dëmtuara dhe dëshmitarët, ashtu që ata të kenë mundësi të marrin pjesë në procedurat gjyqësore pa frikë apo rrezik për sigurinë e tyre personale.

Aplikacionet pranë këtij njësi për sigurim të mbrojtjes fizike parashtrihen nga persona të ndryshëm të cilët vijnë nga rradhët e ndryshme, siç janë, hetuesit, prokurorët, gjyqtarët dhe OJQ-të. Aplikacionet shyrtohen jashtë suazave të sistemit gjyqësor dhe vlerësohen nga një kolegji i cili përbëhet nga zëvendësi i komisionerit të policisë së UNMIK-ut, një prokuror i lartë ndërkombëtar dhe shefi i NjMD-së. Procedura e raportit të aplikacioneve të tilla duhet të dallojë nga ato për masa mbrojtëse të cilat parashihen me rregulloren në fjalë, të cilat bijnë nën jurisdikcionin e gjykatave dhe janë të përcaktuara nga gjykatat (duke përfshirë këtu edhe gjyqtarin hetues).

NjMD-ja për momentin përbëhet nga njëzet policë ndërkombëtar; policët e SHPK-së janë duke u trajnuar me qëllim që të caktohen për të punuar në rradhët e këtij njësi në të ardhmen e afërt. Mandati i njësitit është i kufizuar vetëm në mbrojtjen e dëshmitarëve të ndjekjes penale (së bashku me familjen e tyre të afërt) në një kategori të kufizuar të rasteve, kryesisht, rastet e krimit të organizuar, krimet e luftës dhe rastet politike të profilit të lartë. Financimi i njësitit bëhet pjesërisht nga buxheti i SHPK-së.<sup>21</sup>

Fillimisht, dëshmitarët të cilët kërkojnë mbrojtje fizike i referohen NjMD-së ku plotësojnë formularin për vlerësimin e shkallës së kërcënimit. Mëpastaj ata transportohen në një vend të sigurtë të afërt përderisa aplikacionet e tyre të procesohen. Ata të cilët pranohen në kuadër të programit zhvendosen së bashku me familjet e tyre në një lokacion të sigurtë brenda Kosovës, ku qëndrojnë derisa t'ju vie radha për të dëshmuar në gjyq.<sup>22</sup> Kurdo që mbrojtja është e nevojshme pas dhënies së dëshmisë nga ana e dëshmitarit gjatë gjykimit, NjMD-ja ka mandat që të organizojë vendosjen e atij dëshmitari në një vend tjetër jashtë Kosovës.<sup>23</sup>

## ***ii. Masat në dispozicion në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20***

<sup>20</sup> Lexo memorandumun e datës 28 qershor 2001 nga komisioneri i policisë drejtuar zëvendësit të komisionerit të policisë për operacione, administratë dhe planifikim dhe zhvillim me të cilën është aprovuar themelimi i NjMD-së.

<sup>21</sup> Nga buxheti i SHPK-së i cili sillet rreth 500,000 euro për vjet, 100,000 euro ndahen për vendosjen e dëshmitarëve në vende të sigurt. Shtetet e ndryshme gjithashtu japin kontribute shtesë në fonde. Janë duke u bërë gjithashtu kërkesa për fonde të reja për këtë qëllim.

<sup>22</sup> Objekti është i siguruar 24 orë. Qëndrimi në atë objekt mesatarisht sillet prej 9 deri në 12 muaj.

<sup>23</sup> NjMD-ja vendos dëshmitarët jashtë Kosovës nëpërmjet të ndihmës së shëfave të zyreve të ndërlidhjes të vendeve të ndryshme në Kosovë, UNHCR-së dhe IOM. Gjer më tani, ka qenë shumë vështirë që të gjinden ato vende të cilat do të ishin të gatshme të pranojnë dëshmitarët e tillë. Programi i zhvendosjes së dëshmitarëve e udhëhequr nga NjMD-ja nuk operon në baza të anonimitetit për shkak të kufizimeve buxhetore dhe për këtë arsye dëshmitarët e zhvendosur pranojnë vetëm një adresë/vendqëndrim të ri në vend se të mvshen me një identitet të ri.

Rregullorja është nxjerrur në shtator 2001 në përpjekjet për të ndihmuar zhvillimin efektiv të hetimeve dhe ndjekjes penale të krimeve serioze. Rregullorja parasheh një sërë masash që i mundësojnë gjyqit<sup>24</sup> të shqiptojnë masa për t'i mbrojtur dëshmitarët e mundshëm nga zbulimi i identitetit të tyre. Mjetet që janë në dispozicion në këtë drejtim janë paraqitur si mëposhtë:

- Ndryshimin dhe fshirjen e emrave;
- Mos-zbulimi i shkresave të lëndës;
- Përpjekjet për të fshehur përshkrimin dhe veçoritë fizike të dëshmitarëve;
- Caktimi i pseudonimeve;
- Mbajtja e seancave gjyqësore të mbyllura për publik;
- Urdhërimi i avokatëve mbrojtës të mos zbulojnë identitetin e dëshmitarëve;
- Urdhërat për largim të përkohshëm të të akuzuarit nga salla e gjykimit;
- Anonimiteti.

Këto masa janë në dispozicion si gjatë fazës së hetimeve/procedurës paraprake, mirëpo edhe gjatë gjykimit. Gjykata mund të lëshojë urdhër në bazë të kërkesës së prokurorit publik/paditësit privat, avokatit mbrojtës, palës së dëmtuar apo dëshmitarit. Masat e tilla mbrojtëse kanë për qëllim mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit dhe/apo avokatit mbrojtës. Nën rrethana përjashtimore, gjykata mund të urdhërojë masa mbrojtëse për anonimitet të plotë, nëse gjen se ekziston rrezik për dëshmitarin (familjen e tij/saj) nëse anonimiteti i tillë nuk ruhet. Kjo rregullore përfshin edhe vërejtjet ,se trupi gjykues nuk duhet të shpall një person fajtor, vetëm në bazë të dëshmisë së një dëshmitari të vetëm, identiteti i të cilit është i panjohur për avokatin mbrojtës dhe të akuzuarin.

Gjithashtu rëndësi të posaçme ka edhe Urdhëresa administrative 2002/25, mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore, e datës 13 nëntor 2002, (“Urdhëresa 2002/25”). Kjo urdhëresë i’u ofron gjyqeve udhëzime më të detajuara përkitazi me procedurat të cilave duhet përmbajtur për ekzaminimin e anonimitetit të palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve.

### **C. Incidentet e frikësimit të dëshmitarëve**

Përkundër faktit se çështjet e mbrojtjes së dëshmitarëve kanë luajtur një rol tejet të rëndësishëm gjatë dy viteve të fundit në Kosovë, me themelimin e NjMD-së dhe nxjerrjen e rregullores në fjalë, ende ekzistojnë problemet përkitazi me frikësimin e dëshmitarëve. Duket se një pjesë e madhe e publikut të përgjithshëm, ende kanë frikë se mund të jenë objekt i frikësimeve dhe sulmeve nëse vendosin për t’i dhënë deklaratat policisë apo dëshmuar në gjyq, për shkak se sistemi gjyqësor nuk është në gjendje të ofrojë mbrojtje për ta. Kjo frikë mund të jetë e pabazë. OSBE-ja ka regjistruar një sërë incidentesh me dëshmitarë të cilët janë vrarë apo kanë qenë objekt i tentim vrasjeve, frikësimit apo kërcënimeve me dhunë, në raste të llojeve të ndryshme dhe gjatë të gjitha fazave të procedurës. Disa shembuj tjerë ilustrues janë paraqitur si në vazhdim:

#### ***i. Procedura paraprake dhe gjykimi***

Në një rast i cili përfshinte pjesëtarë të lartë të UÇK-së, të shpallur fajtor për vepër penale të paraburgimit të paligjshëm i cili ka rezultuar në vdekje, ndodhën një sërë incidentesh të frikësimit të dëshmitarëve të

<sup>24</sup> ‘Gjykata’ i referohet gjyqtarit hetues gjatë procedurës hetimore apo kryetarit të trupit gjykues. (Rregullorja e UNMIK-ut neni 1(d)).

prokurorisë. Si rrjedhojë e këtyre incidenteve, në pesë raste të veçanta – janë ngritur akuzat për vrasje, tentim vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve – kundër personave për të cilët pohohet se janë përgjegjës për kryerjen e këtyre veprave penale.<sup>25</sup>

Shembujt e incidenteve të tilla të frikësimit janë paraqitur si në vazhdim:

- Dëshmitari kryesor dy herë i përjetoi tentim vrasjet (njëri nga këto incidente përfshinte edhe gruan dhe djalin e tij) pas fillimit të procedurës hetimore. Vepra e fundit e tentim vrasjes kishte ndodhur tri javë pas fillimit të seancës kryesore;
- Një dëshmitar i dytë, menjëherë pas dhënies së dëshmisë para gjyqtarit hetues, është kërcënuar, siç pohohet, se do të vritej së bashku me familjen e tij nëse nuk e tërheq deklaratën e tij;
- Një dëshmitar i tretë arriti t'ju ik përpjekjeve për vrasje disa javë pasi që kishte dhënë deklaratën para gjyqtarit hetues;<sup>26</sup>
- Familja e dëshmitarit të katërt, ishte sulmuar një natë pasi që dëshmitari në fjalë kishte dëshmuar para gjyqtarit hetues.<sup>27</sup>

Përkundër këtyre incidenteve, sipas zyrtarëve të cilët kishin qenë të përfshirë në këto raste, asnjëri nga këta dëshmitarë nuk kishte përfituar nga programi i NjMD-së dhe masave mbrojtëse të shqiptuara në bazë të rregullores në fjalë.

Sipas kërkesës së prokurorit ndërkombëtar, ishte kontaktuar NjMV-ve, në fazat e mëhershme për të siguruar dëshmitarin kryesor (palën e dëmtuar). NjMV, kishte gjetur vend për të, në një strehimore dhe e kishin regjistruar të njëjtin në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, por ai nuk kishte pranuar këtë. NjMV-ve nuk kishte ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm lidhur me këtë.

- Nuk ishte inicuar asnjë kontakt me NjMV-ve, për mbrojtjen e dy dëshmitarëve bashkëpunues. Njëri prej tyre kishte kërkuar sigurimin e vizës për në Shtete e Bashkuara të Amerikës apo Zvicërr por ai ishte njoftuar se UNMIK-u nuk mund të bëjë një gjë të tillë. Ai më pas kishte arritur ta sigurojë vizën për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e kishte braktisur Kosovën vetëm disa ditë para se t'i vinte rradha për të dëshmuar në seancën gjyqësore. Si rezultat i kësaj gjykata nuk ka mundur të dëgjojë këtë dëshmitarë bashkëpunues, dhe deklarata e tij gjatë procedurës hetimore nuk ka mundur të merret si dëshmi pasi që mbrotja nuk ka mundur ta merrë në pyetje.<sup>28</sup>
- Mirëpo, është ofruar një mbrojtje e formës *ad hoc*. Kur siguria e dëshmitarit kryesor ishte vënë në pyetje, gjykatësi hetues kishte kontaktuar policinë regjionale në Pejë/Peć, e cila kishte ofruar mbrojtje të caktuar. Krahas kësaj, sigurinë e të afërmeve të palëve të dëmtuara, e kishte në duar KFOR-i për një kohë të caktuar, ndërsa më vonë këtë pune e kishte kryer një kompani private e sigurisë. Gjatë seancës kryesore, disa dëshmitarë kanë raportuar se kishin qenë të kërcënuar nga ana e anëtarëve të publikut, dhe pas kërkesës së tyre, CPU i kishte përcjellur ata prej vendeve të tyre të banimit deri në gjykatore.<sup>29</sup>

<sup>25</sup> Më 26 dhjetor 2002 dy persona, të akuzuar fillimisht për tentim vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve, janë shpallur fajtor për vepër penale të posedimit të paligjshëm të armëve dhe kundër tyre është shqiptuar dënimi me dy vjet burg.

<sup>26</sup> Një raketë ishte lansuar në drejtim të një restorani ku gjendej dëshmitari. Ai dhe gjashtë persona të tjerë ishin lënduar.

<sup>27</sup> Gjithashtu ishte shtënë me revole në drejtim të shtëpisë ku gjithashtu ishte hedhur edhe granatë e dorës e cila për fat nuk kishte shpërthyer.

<sup>28</sup> Sipas aktgjykimit me shkrim të Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, të datës 17 dhjetor 2002, thirrjet për gjykim nuk kanë mundur të dorëzohen.

<sup>29</sup> Ky njësit, zakonisht është përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë personale të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë.



Mbulimi i gjërë nga mediat, të këtyre incidenteve por edhe të vetë gjykimit, duket se e ka shtuar ndjenjën e pasigurisë e cila ndërlihet me këtë rast gjyqësor.<sup>30</sup> Është vërejtur se brenda në gjykatore, dëshmitarët e sjellur nga prokuroria, ishin frikësuar nga sjelljet e publikut (i cili dukej së përkrahte ekskluzivisht të akuzarit). Në të vërtetë, njëri nga dëshmitarët, gjatë dhënjes së dëshmisë ka deklaruar se anëtarët e publikut e kishin sharë dhe kërcënuar. Me gjithë tërheqjeve të vëmendjes nga kryetari i trupit gjykues për të mbajtur qetësinë, ai nuk ka urdhëruar përjashtimin e publikut, të mediave televizive,<sup>31</sup> ose nuk ka shqiptuar fare masat mbrojtëse sipas Rregullores.

Sa për krahasim, në rastin më të ri, në të cilin përfshihen ish-pjesëtarë të rangut të lartë në UÇK, dhe të akuzuar për krime lufte, NJMV-ve por edhe Rregullorja janë vënë në veprim për të ofruar mbrojtje për dëshmitarët e prokurorisë. Mirëpo, pa marrë parasyshë përdorimin më të madhë të masave mbrojtëse, problemet e frikësimeve prapë janë paraqitur. Për shkak të rrezikut të frikësimeve, prokurori ka kërkuar masat mbrojtëse në pajtim me rregulloren. Sipas prokurorit ndërkombëtar:

“Shkresat e lëndës tregojnë se ndaj një numëri të dëshmitarëve janë bërë kërcënime, për të cilën arsye ka qenë e nevojshme shlyerja e emrave të tyre nga shënimet zyrtare. Për shkak të këtij niveli të frikësimeve, një numër i dëshmitarëve janë tërhequr nga qëllimi i identifikimit të të pandehurve dhe kanë dhënë dëshmi kontradiktore. Hetimet policore dhe procesi i identifikimit të dëshmitarëve tjerë ishte ngadalësuar, në pjesën më të madhe për shkak të frikës prej të bashkazuuarve dhe shoqëruesve të tyre. Në fakt, një dëshmitar i cili më heret ka qenë i involvuar në një rast, dhe kur menjëherë pas arrestimit të të akuzuarit ai ishte kontaktuar nga organet e zbatimit të ligjit, më pas në të është qëlluar dhe ai është plagosur para dyerve të shtëpisë së tij, shumë pak kohë para se atij t’i dorëzohet thirrja për t’u paraqitur në gjyq. Më tej, deklarata e dëgjuar që prej arrestimit (të të akuzuarit) ka përfshirë një dëshmitar i cili ka deklaruar se atë e ka thirrur me telefon një person i panjohur dhe i ka ofruar me atë rast një shumë të hollash si shpërblim për të mos dëshmuar. Krahas kësaj, dëshmitë janë në proces të zhvillimit të tyre dhe mund të implikojë disa nga të akuzuarit dhe shoqëruesit e tyre për vepra tjera penale që kanë ndodhur pas konfliktit në Kosovë, përfshirë këtu vrasjet, frikësimin e dëshmitarëve, mito dhe korrupsionin gjyqësor”<sup>32</sup>.

Gjykata ka urdhëruar mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve (mos-zbulimin e identitetit për publikun),<sup>33</sup> ndërsa pesë prej tyre do të mbeten anonim, madje edhe për të akuzuarit dhe avokatët mbrojtës.<sup>34</sup> Është indikative vërejtja e paraqitur nga prokurori, para fillimit të gjykimit se, “[p]ër shkak të këtij niveli të frikësimit, një numër i caktuar dëshmitarësh, janë tërhequr nga qëllimi për të identifikuar të pandehurit dhe kanë dhënë dëshmi kundërtënëse” për shkak se, scenario të ngjajshme kanë ndodhur gjatë procesit gjyqësor, në lidhje me dëshmitarët të cilët ose kanë qenë anonim ose identiteti i tyre ka qenë i mbuluar (fshehur):

<sup>30</sup> Më së shumti përmes televizionit, të cilët gjatë dëshmiave të tyre e kanë filmuar fytyrën e plotë të dëshmitarëve të prokurorisë. Edhe pse identiteti i dëshmitarëve ka qenë i njohur për të akuzuarit gjatë kohës kur ata kanë dhënë dëshmitë, ndriqimi i fytyrave të tyre përmes televizionit në tërë Kosovën, ka siguruar që një numër i madh i popullatës t’i njohin ata.

<sup>31</sup> Vendimi për të lejuar inçizimet televizive, bie nën kompetencë të kryetarit të Gjykatës Supreme. Mirëpo trupi gjykues mund të urdhërojë, që “për shkaqe të arsyeshme, disa pjesë të seancës kryesore, mos të filmohen”, lexo nenin 294 (3) të LPC RFJ. Krahas kësaj, edhe neni 10 i KEDNj-së paralexon që e drejta e shprehjes së lirë, përfshinë edhe lirinë “bartjes së të dhënave dhe ideve pa ndërhyrjen e autoriteteve publike”, dhe më tej ajo thekson se “ushtrimi i këtyre lirive, meqë bartin me vete edhe obligime dhe përgjegjësi, mund t’i nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose dënimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike, dhe në interes të [...] sigurisë publike, për parandalimin e çrregullimeve apo të krimit, [...], për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të të dhënave të pranuar nën obligimin e konfidencialitetit, ose për të ruajtur autoritetin dhe paanësinë e gjyqësorit”.

<sup>32</sup> Lexo “propozimim e prokurorit për paraburgim” që i është bashkangjitur aktakuzës së ndryshuar, të datës 4 shkurt 2003.

<sup>33</sup> Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/20.

<sup>34</sup> Neni 4.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/20 thekson: “Kur masat e parashtruara në nenin 3.1 nuk mjaftojnë për të garantuar mbrojtjen e palës së dëmtuar ose të dëshmitarit (duke mos qenë dëshmitar i propozuar nga mbrojtja), gjykata në rrethana të jashtëzakonshme mund të urdhërojë që pala e dëmtuar ose dëshmitari të mbesin anonim për personin e akuzuar dhe mbrojtësin.”

Dëshmitari i parë anonim, ka dhënë dëshminë e tij/saj në seancën e mbyllur për publik dhe nga një dhomë e ndarë, nga e cila as gjyqi por as palët nuk kanë mundur ta shohin dëshmitarin, por kanë mundur t'i shtrojnë pyetje të njëjtit. Deklarata e dëshmitarit e dhënë para gjykatësit hetues, ka qenë e natyrë mjaft inkriminuese për të akuzuarin-it. Mirëpo, gjatë gjykimit dëshmitari e ka ndryshuar tërësisht dëshminë dhe ka deklaruar se deklarata e dhënë par gjykatësit hetues ka qenë e rrejshme. Menjëherë pas seancës së mbyllur, dy avokatë mbrojtës, para përfaqësuesve të shtypit, e kanë dhënë përmbledhjen e deklaratës së dhënë në seancë të mbyllur, me ç'rast edhe është publikuar e njëjta.<sup>35</sup>

Dëshmitari i dytë i prokurorisë, identiteti i të cilit ishte mbrojtur në pajtim me urdhërin e gjykatës të lëshuar sipas Rregullores, e ka dhënë dëshminë e tij/saj gjatë seancës së mbyllur (me publik të përjashtuar). Prap, ky dëshmitarë, i cili para gjykatësit hetues ka dhënë deklaratë inkriminuese, tërësisht e ka ndryshuar dëshminë e tij gjatë deklarimit në procesin gjyqësor dhe ka konstatuar se deklarata e tij/saj para gjykatësit hetues ka qenë e rrejshme.<sup>36</sup>

Më tej, është mjaft shqetësues fakti se, përkundër asaj se gjykata ka urdhëruar anonimitetin duke u thirrur në Rregullore, përfshirë këtu edhe seancën e mbyllur, avokatët mbrojtës edhe më tej janë përcaktuar të njoftojnë mediat (prandaj edhe publikun) mbi atë se çka kanë dëgjuar.<sup>37</sup> OSBE-ja ka monitoruar edhe incidentet tjera të natyrës së ngjajshme; kjo sugjeron për mungesë të respektimit të çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e dëshmitarëve.<sup>38</sup>

Sikurse proceset gjyqësore të profilit më të lartë, OSBE, gjithashtu ka monitoruar rastet e trafikimit, në të cilat mund të pandehet se janë bërë frikësime të dëshmitarëve/viktimave (siç ishte rasti i tërhejkjes nga deklaratat fillestare inkriminuese).<sup>39</sup> Në disa raste, dëshmitarët i kanë përmendur shprehimisht kërcënimet dhe frikësimet.

Një shembull i këtillë është ai i rastit të trafikimit që ka ndodhur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë /Pristina. Gjatë hetimeve, dëshmitari ka deklaruar se e ka parë pronarin e kafe barit duke i detyruar vajzat të meren me prostitucion. Gjykatësi hetues e ka njoftuar OSBE-në se disa ditë pas dhënjes së deklaratës, dëshmitari i është paraqitur në zyren e tij/saj. Ai i ka thënë asaj, se kishte pranuar kërcënime dhe për këtë shkak ka kërkuar ta ndryshojë deklaratën e tij. Gjykatësi hetues nuk e ka pranuar kërkesën e dëshmitarit,

<sup>35</sup> “Dëshmitari nr. 4 ka mohuar secilën thënie të vetën gjatë hetimeve duke thënë se policia e UNMIK-ut ka bërë presion në të, dhe se atij i është premtuar një shumë e madhe e të hollave [...]” nga artikulli i Kosova Sot, “A ishte kërcënuar nga policia e UNMIK-ut, dëshmitari i mbrojtur nr. 4?”, i datës 21 mars 2003 (përkthimi jozyrtar). OSBE-ja është përcaktuar të publikojë këtë informatë, edhe pse kjo është seancë e tipit të mbyllur (pa prezencën e publikut), pasi që kjo informatë tani ka hyrë në domenin e publikut përmes mediave, dhe për këtë, nuk mund të konsiderohet edhe më tej si informatë konfidenciale.

<sup>36</sup> Një ditë më pas, nëpër mediat lokale është raportuar: “Gjithashtu edhe dëshmitari i dytë, sipas shënimeve tona të mangëta që i kemi në disponim, flasin për skandale gjatë hetimeve, për shkak se ai i tregoi gjykatës se nuk kishte qenë fare i malltretuar nga UÇK-ja, që ishte në kundërshtim me atë çka është e shkruar në deklaratën e dhënë në hetime. [...] Dëshmitari i tytë sekret kundër udhëheqësve të UÇK-së nga Zona e Llapit, sipas burimeve të “Epokës së Re” është tërhejkur nga deklarata e dhënë gjatë hetimeve. Ai tha se nuk kishte qenë i malltretuar nga UÇK-ja”. (përkthim jozyrtarë). Epoka e Re, 1 prill 2003, “Edhe dëshmitari i dytë flet për skandalet e mëdha gjatë hetimeve”. (artikulli nga faqja e parë).

<sup>37</sup> Sikurse që shkelin urdhërin e gjykatës për masat mbrojtëse sipas Rregullores, avokatët mbrojtës kanë mundur gjithashtu të shkelin edhe ligjin mbi zbulimin e informatave nga seancat e mbyllura gjyqësore. Ligji vendës në fuqi, paralëxon se kur një pjesë apo i tërë gjykimi zhvillohet i mbyllur për publikun, atëherë personat të cilët marrin pjesë në seancën kryesore, përfshirë edhe palët, “duhet ta ruajnë si mëshehtësi atë që kanë mësuar gjatë seancës kryesore”. (neni 289(3) i LPP RFJ).

<sup>38</sup> Gjatë hetimeve të një komandanti të ish-UÇK-së i akuzuar për rrëmbim dhe tentim vrasje, njëri prej avokatëve mbrojtës ka deklaruar para gjykatësit hetues ndërkombëtar dhe prokurorit ndërkombëtar se...“tani është tepër vonë për të fshehur identitetin e dëshmitarit për shkak se vetë avokati mbrojtës është deklaruar para gazetës Zëri.[...] kjo ishte obligim për avokatët mbrojtës [...]për të dhënë informata korrekte pasi që asnjë venim nuk është marrë nga gjykatësi hetues”. Pas këtij incidenti dëshmitari kishte pranuar kërcënime të vdejes dhe ka refuzuar të dëshmojë. Emri i tij/saj ishte shënuar në kërkesën fillestare për zhvillimin e hetimeve dhe nuk është shqiptuar asnjë masë mbrojtëse. Mund të përmendet se mbajtja e sekretit gjatë hetimeve mbrohet me nenin 178 të LPP të FRJ.

<sup>39</sup> Edhe pse është e pamundur të vërtetohet se dëshmitarët të cilët tërhiqen deklaratat e tyre, të kenë qenë frikësuar (para apo gjatë gjykimit), është e arsyeshme të prezumohet se shumica e tyre janë frikësuar. Ky prezumim ndahet nga gjykatësit dhe prokurorët që i ka intervistuar OSBE-ja.

por nuk ka ndërmarrë asgjë për ta mbrojtur dëshmitarin. Gjatë gjykimit dëshmitari tërësisht ka ndryshuar deklaratën e dhënë para gjykatësit hetues.

Pothuajse në të gjitha rastet e trafikimit në të cilat dëshmitarët janë tërhequr nga deklaratat e mëparshme, autoritetet nuk kanë ndonjë nga masat mbrojtëse.

Shembujt e sipërpërmendur, demonstrojnë nivelin e përzierjes së dëshmitarëve në krimin e organizuar, trafikim, krime të luftës, ose rastet politike. Por frikësimi nuk është i veçantë vetëm për këto procese gjyqësore, dhe mund të ndodhë madje edhe në kontestet e brendshme familjare, e që mund të përfshijnë akuza relativisht të lehta.

Për shembull, me 27 janar 2003 një i akuzuar, shqiptar i Kosovës, ishte dënuar nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës/Pristina për shkak të sjelljeve të dhunshme, për vepra të përsëritura të dhunës kundër gruas së tij në martesë, me dy vjetë e gjysmë heqje lirie. Policët e SHPK-së, i kanë ofruar mbrojtje viktimës që nga dita e parë e raportimit të rasisit, deri në ditën e burgosjes së të akuzuarit. NJMV-ve nuk ishte involvuar.

## *ii. Faza pas gjykimit*

Përgjegjësia e shtetit për të siguruar mbrojtje adekuate për dëshmitarë/palë të dëmtuara, nuk përfundon me seancën kryesore ose pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve, por vazhdon edhe më tej.<sup>40</sup>

Në njërin prej rasteve të përmendura më lartë, që kishte të bënte me ish-pjesëtarë të rangut të lartë në UÇK, policia regionale e Pejës/Pec, ka vazhduar të ofrojë mbrojtje edhe për një muaj në vazhdim pas përfundimit të gjykimit (jashtë fushëveprimet të NJMV-ve) për dëshmitarët kryesorë/palët e dëmtuara dhe dëshmitarëve bashkëpunues. OSBE i përshëndetë këto masa. Mirëpo, OSBE gjithashtu ka vërejtur disa prej dëshmitarëve të cilët nuk i janë nënshtuar masave mbrojtëse, se kanë qenë objekt i sulmeve pas paraqitjes së dëshmimeve në gjykim.

Një dëshmitarë i mirënjohur, i cili kishte dëshmuar lidhur me rastin e sipërpërmendur të profilit më të lartë, së bashku me të birin dhe kusheririn e tij, ishin qëlluar për vdekje me armë zjarri në udhëkryqin kryesor të Pejës/Pec. Edhe pse ai kishte qenë i kërcënuar dhe e kishte mbijetuar një tentim atentati para procesit gjyqësor, atij nuk i ishte ofruar asnjë mbrojtje pas gjykimit.

Nuk duhet nënvlerësuar pasojat e këtij atentati në psikologjinë e popullatës. Në të vërtetë, vështirësitë me të cilat ballafaqohet policia gjatë zhvillimit të hetimeve, e ilustrojnë shkallën e frikës të pranishme në shoqërinë e Kosovës kur do të duhej ndihmuar policinë apo gjykatat në rastet e këtilla. Sipas shefit të njësitit për luftimin (hetimin) e krimeve të rënda në Pejës/Pec, ky incident ka ndodhur para syve të së paku 40 dëshmitarëve. Megjithatë, që në fillim askush nuk ishte i gatshëm t'i ndihmojë policisë. Pas 10 ditëshë qetësie, shefi i njësitit të sipërpërmendur ka bërë një apel publik dhe i ka ftuar dëshmitarët që të paraqiten, dhe këtë e ka bërë me një ton i cili e ilustron shkallën e frustrimit për shkak të frikësimeve ndaj dëshmitarëve:

“Kjo vrasje nuk është e para e këtij lloji në regjionin e Pejës /Pec, dhe nuk do të jetë e fundit. [...] Kriminelët mund të vrasin lirshëm për shkak se ata e dinë se qytetarët nuk do t'i tregojnë policisë se çfarë kanë dëgjuar dhe parë. Pasiguria dhe frikësimet i udhëheqin qytetarët e Kosovës, të cilët më parë preferojnë

<sup>40</sup> Lexo faqen 9.

të jetojnë me elementin kriminal [*sic*] të pranishëm çdo kund në shoqëri, se sa të ngriten kundër kriminit. Kosova është shndërruar në vend ku lulëzon krimi i organizuar për shkak të qetësisë së qytetarëve. Gjatë vitit të kaluar unë personalisht i kam intervistuar shumë dëshmitarë të vrasjeve të reja por edhe atyre më të vjetra. E njëjta përgjigje është dhënë në mënyrë të vazhdueshme nga dëshmitarët: s’kam parë gjë, s’kam dëgjuar dhe nuk di fare si çfarë ka ndodhur. E njëjta përgjigje është dhënë madje edhe nga personi i cili ka qenë vetëm 10 metra largë nga vrasja apo krimi i cili sapo është kryer. [...] Kriminelët jetojnë jetë të suksesshme duke shfrytëzuar si armë kryesore frikën dhe pasigurinë.”<sup>41</sup>

Një javë pas këtij apeli, me 21 janar 2003, është hudhur një predhë antitanks në ndërtesën e policisë regjionale të UNMIK-ut në Pejë/Pec. Edhe pse, deri më tash askush nuk e ka pranuar përgjegjësinë për këtë sulm, shumë njerëz supozojnë se kjo ka të bëjë me hetimet policore lidhur me vrasjen e trefishtë. Cilatdo të jenë arsyet, ky incident duket se to të minojë edhe më tej besueshmërinë e opinionit publik në aftësinë e sistemit juridik, dhe në policinë, që t’i ndalë ata të cilët i kërcënojnë apo i sulmojnë dëshmitarët.

Përkundër dijenisë së shtuar se ish-dëshmitari në këtë proces gjyqësor të profilit të lartë, se mund të jetë objek i sulmeve, me 14 prill 2003, ish-dëshmitari i dytë ishte vrarë:

Dëshmitari i dytë i cili kishte dhënë dëshminë, ishte vrarë në një pusi me 14 prill 2004. Ky sulm i kishte lënë prapa dy të vdekur dhe tre të plagosur rëndë, përfshirë edhe një fëmijë katërvjeçar. Policia kishte konfirmuar se njëri prej viktimave të vrara, ka qenë dëshmitarë i prokurorisë në procesin gjyqësor kundër ish-luftëtarëve të UÇK-së dhe ka deklaruar “ [m]otivi i sulmit në Pejë, mund të jetë ai i hakmarrjes, për shkak se njëri prej personave të vrarë ka qenë dëshmitar i prokurorisë gjatë një procesi të gjyqësor të mbajtur mëparë.”<sup>42</sup>

Zyra e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë/Pristina, me rastin e dënimit të vrasjes, ka theksuar se “[v]rasjet e tilla, nuk i eliminojnë dhe frikësojnë thjeshtë vetëm të tjerët për të dëshmuar kundër elementeve kriminale në Kosovës, por ato gjithashtu e parandalojnë Kosovën në arritjen e standardeve para se të fillohen bisedimet për statusin final të saj.”<sup>43</sup>

Duhet të përmendet se incidentet e frikësimeve të dëshmitarëve, të monitoruara nga OSBE, paraqesin vetëm një pjesë të rasteve aktuale. Dëshmitarët të cilët ishin kërcënuar, shpeshherë kanë frikë t’ia paraqesin rastin policisë. Më tej, sipas vetë natyrës së saj, nuk mund të matet pasoja e *frikës së publikut për frikësime të mundshme*; është e mundur të dihet numri i dëshmitarëve potencial të cilët zgjedhin të mos t’i raportojnë policisë për gjërat që i dijnë për shkak të firkës nga represaljet. Shefi i njësitit për luftimin (hetimin) e krimeve të rënda në Pejë/Pec, beson sinqerisht se ky problem është i natyrës endemike. Pa marrë parasyshë numrat, nuk ka dyshim se i madh problemi i frikësimit të dëshmitarëve. Të gjithë gjykatësit e intervistuar nga OSBE, kanë konfirmuar se ky është problemi kryesor me të cilin ballafaqohet sistemi penalo-juridik i Kosovës.

#### **D. Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes së viktimave në Kosovës**

Frikësimi i dëshmitarëve do të vazhdojë të pengojë aftësitë e policisë dhe gjykatave në funksionimin e tyre të suksesshëm, deri në përfitimin e besueshmërisë nga ana e publikut në aftësitë e tyre për të mbrojtur

<sup>41</sup> Komunikatë për shtyp e UNMIK-ut, “Obligimet e qytetarëve në një shoqëri të lirë” e datës 14 janar 2003.

<sup>42</sup> Konferencë për shtyp e zëdhënësit të policisë së UNMIK-ut me 15 prill 2003. Duhet të theksohet se ky dëshmitarë kishte hjek dorë nga programi për mbrojtjen e dëshmitarëve para se të vritej.

<sup>43</sup> Komunikatë për shtyp e Zyrës së Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, “Zyra e SHB-ra, e dënon vrasjen e dyfishtë të paramenduar të Illir Selimajt dhe Feride Selimajt, 15 prill 2003.

dëshmitarët. Percepioni i publikut nuk ndryshon brenda ditës, pa marrë parasyshë zhvillimet e reja, por kërkon një ndërtim të konsiderueshëm të vetëbesimit. Por për të filluar me këtë proces, autoritetet duhet që menjëherë t'i shqyrtojnë mangësitë e numërta brenda sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë.

### *i. Përmirësimi i programit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë*

Në ndërlidhje me masat ligjore të cilat i parashikon Rregullorja, në Kosovë duhet të funksionojë një program efikas për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në disa raste, atëherë kur publiku (apo i akuzuari-it) dijnë për identitetin e dëshmitarit – është e pakuptimtë që të shtyhet (gjykimi) duke u thirrur në Rregullore – programi efikas i mbrojtjes së dëshmitarëve ofron vetëm mjete(mënyra) reale të mbrojtjes. Sidoçoftë, programi aktual i mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë, është tepër elementar (i thjeshtë) për t'u marrë me problemin e kësaj shkalle, dhe pengohet seriozisht nga një numër kufizimesh me të cilat NJMV është i detyruar të operojë.

Kufizimi kryesor është mungesa e resurseve, që nënkupton se ky njësit mund të konsiderojë dhënjen e mbrojtjes vetëm për dëshmitarët të cilët janë të involvuar në rastet e profilit të lartë politik, krimin të organizuar dhe rastet e krimeve të luftës. Madje edhe për këta dëshmitarë të involvuar në këto raste, mundësitë janë të kufizuara – sipas një pjesëtari të këtij njësi, objektet e sigurta (strehimoret) të përkohshme janë mjaft të kufizuara dhe se objekti ekzistues nuk ka mundësi të pranojë më shumë se pesë familje<sup>44</sup>. Duhet pranuar se edhe me dyfishimin ose trefishimin e resurseve, NJMV do të duhej të kishte qasje selektive lidhur me ofrimin e mbrojtjes. Por, në nivelin e tanishëm, shumë dëshmitarë, të cilët janë objekt i qartë i frikësimeve, nuk kualifikohen për ofrimin e mbrojtjes, madje edhe kur janë të involvuar në rastet e rënda. Kjo është e vërtetë edhe për rastet e shkallës relativisht më të ultë ku do të mjaftonte vetëm një mbrojtje e përkohshme, për shembull, një strehim i thjeshtë, vetëm deri në përfundimin e gjykimit.

Kufizimet e resurseve, veçmas ndikojnë në rastet e viktimave/dëshmitarëve të trafikimit, të cilët shpeshherë janë të rrezikuar ndaj frikësimeve nga shoqëruarit e tyre të mëparshëm, dhe në shumicën e rasteve, nuk janë në listën e prioritetëve të NJMV.<sup>45</sup> OSBE ka monitoruar shumë raste në të cilat viktimat/dëshmitarët kanë pranuar se janë frikësuar ose, dyshohet se janë frikësuar për shkak të ndryshimeve të befasishme të deklartave të tyre inkriminuese në ato të shfajsimin.<sup>46</sup> IOM dhe një numër i OJQ-ve vendëse dhe ndërkombëtare, kanë ofruar strehimore për viktimat e trafikimit ndërkombëtar të cilat zyjnë në kuadër të skemës së riatdhesimit. Mirëpo, viktimat të cilat nuk kualifikohen për këtë skemë, nuk mund të përfitojnë nga mundësitë e strehimit dhe mbeten të pambrojtura.<sup>47</sup> Edhe pse Rregullorja e UNMIK-ut mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, parashikon “ndërmarrjen e masave adekuate për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë çdo hetimi ose procedure gjyqësore që rezulton nga kjo rregullore”<sup>48</sup>,

<sup>44</sup> Kapaciteti maksimal është, tetëmbëdhjetë persona në të njëjtë kohë.

<sup>45</sup> Kufizimet e tanishme financiare, kanë rezultuar në pamundësitë për këtë njësit të ofrojë mbrojtjen për viktimat dhe dëshmitarët në rastet e trafikimit. Natyra dhe masat speciale të cilat nevojiten për viktimat e tilla, kanë shkaktuar sfida të natyrës logjistike dhe operacionale për resurset e tanishme të njësitit dhe si rezultat i kësaj ky i fundit nuk ka mundur të ofrojë ndihmë për viktimat/dëshmitarët e këtyllë.

<sup>46</sup> Një hulumtim i kryer nga “Anti-Slavery International” mbi temën e mbrojtjes së viktimave, ka vënë në pah se vendet me një sistem më gjithëpërfshirës të mbrojtjes së viktimave, kanë përparuar më shumë drejt ndjekjes së trafikantëve, Lexo raportin e “Anti-Slavery” të titulluar “Trafikimi i qenieve njerëzore: ndihma dhe mbrojtja për viktimat” – Dokumenti i mbledhjes së ekipit “Task Force” në kuadër të Paktit të stabilitetit, mars 2003.

<sup>47</sup> Për shembull, viktimat e “trafikimit të brendshëm”, sipas përkufizimit të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/4, dhe viktimave të huaja të trafikimit të cilat nuk dëshirojnë të riatdhesohen.

<sup>48</sup> Lexo, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/4, nenin 5.2. përfshirë, nenin 10(c) paralexon obligimin për “strehim të përkohshëm të sigurtë, ndihmë psikologjike, mjekësore dhe të mirëqenies sociale sipas nevojës për përbushjen e nevojave të tyre.” Megjithatë, ndihma sipas nenit 10, varet nga fondet e siguruar nga kontributet e dhëna për këto qëllime specifike (neni 9.2). Dështimi për të themeluar objekte të strehimit për viktimat e trafikimit, jo vetëm që është në kundërshtim me ligjin vendës por gjithashtu edhe kundër udhëzimeve të përcaktuara në instrumentet e Kombeve të Bashkuar, respektivisht Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të KB nr. 53/116 të datës 1 shkurt 1999, e cila e pranon trafikimin si shkelje të rëndë të të drejtave njerëzore dhe i fton qeveritë “të ndërmarrin hapat, përfshirë edhe programet/masat për

rrallë herë është ofruar kjo mbrojtje çoftë në formën e ofrimit të shtëpisë (strehimit) të mbrojtur, apo në ndonjë formë tjetër.

Për të lehtësuar këtë problem, në muajt e hershëm të vitit 2002 është propozuar që NJMV, Njësiti hetimor i trafikimit dhe prostitucionit (NjHTP), si dhe Njësiti i DD-së për ndihmë dhe avokim për vitimat (NjNAV) të themelojnë një objekt të përkohshëm dhe tranzitor të mbrojtur, që i dedikohet mbrojtjes të gjitha viktimave të trafikimit. Nga ky këndvështrim, OSBE, e përshëndetë lidhjen e Memorandumit të mirëkuptimit në mes të saj dhe Kombeve të Bashkuara, të datës 28 mars 2003, në bazë të të cilit, themelohet objekti i propozuar tranzitor dhe i përkohshëm. OSBE është obliguar të ofrojë 159,300 euro për Shtyllën I të UNMIK-ut, nga kontributi vullnetar i ofruar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që do t'i dedikohen këtij objekti.<sup>49</sup>

Sipas pjesëtarëve të NJMV, shumë dëshmitarë të cilët druajnë nga frikësimet dhe të cilët njoftohen mbi masat e mundshme, nuk dëshirojnë të inkuadrohen në këtë program.<sup>50</sup> Kjo përputhet me vrotimet e OSBE-së të disa prej rasteve të profilit të lartë. OSBE-ja është informuar se shumë dëshmitarë mendojnë se pasi që policia e UNMIK-ut të bartë operacionet e njësitet tek SHPK-ja, atëherë do të vëjë në rrezik mbrojtjen/rivendosjen që ndërlihet me rastin e tyre konkret. Me qëllim të adresimit të këtij shqetësimi, duhet të krijohet një procedurë e kontrollimit të hollësishtëm të përzgjedhjes së policëve të SHPK-së; vetëm ata oficerë me dosje të besueshme, të cilët kanë punuar në rastet e ndieshme, do të duhej të pranoheshin në një njësi të tillë. Pastaj, njësiti duhet të ofrojë garancë për dëshmitarët se të dhënat konfidenciale do të ruhen për një periudhë afatgjatë. Këto masa janë të domosdoshme për promovimin e besueshmërisë së programit.

Sikurse rritja e resursve, poashtu edhe bashkëpunimi më i mirë në mes të policisë NJMV-së, prokurorëve dhe gjykatave, do të sforconin sistemin. Pa marrë parasysh se programi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe masat e përcaktuara me Rregullore, do të duhej të aplikoheshin në mënyrë koherente për qëllim të ofrimit të mbrojtjes adekuate për dëshmitarë të caktuar, gjendja aktuale tregon se, marrëdhëniet institucionale dhe ligjore në mes të këtyre organeve nuk janë të qëndrueshme. Duket se gjykatësve dhe prokurorëve shpeshherë ju mungon informata e në disa raste edhe mirëkuptimi mbi llojin e shërbimeve të cilat i ofron NJMV, si operon dhe si i udhëheqë punët e veta.<sup>51</sup> Shumë prej tyre nuk e kuptojnë raportin e ndërsjellë në mes të programit të mbrojtjes së dëshmitarëve edhe masave të Rregullores. Për këtë arsye, policëve, prokurorëve dhe gjykatësve do të duhej t'ju ofrohen trajnime përkatëse mbi atë se si funksionon programi, dhe si do të mund të shfrytëzohej në kontekst të sistemit gjyqësor në tërësi.

---

mbrojtjen e dëshmitarëve, për t'ju mundësuar grave viktimat të trafikimit të ankohen në polici dhe të jenë të gatshme para sistemit penal-juridik, dhe për të siguruar gjatë kësaj kohe se ato do të kenë qasje në ndihmën sociale, mjekësore, financiare dhe të ndihmës dhe mbrojtjes juridike të duhur"; Protokollin i KB mbi parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, posaçërisht grave dhe fëmijëve, duke përfshirë Konventën e KB kundër krimit të organizuar transnacional, A/55/383; Parimet dhe udhëzimet e rekkomanduara mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimin e njerëzve, të Këshillit Ekonomik Social të KB, nr. E/2002/68/Add.1; dhe Kodi i Mirësjelljes i KB, për zyrtarët e zbatimit të ligjit, UN GA Res. 34/169.

<sup>49</sup> Qëllimi Memorandumit të mirëkuptimit është të përkrahë themelimin dhe funksionimin e Objektivit të përkohshëm të mbrojtur (OPM) për viktimat e trafikimit për periudhën njëvjeçare. Qëllim i OPM-së është mbrojtja dhe përkrahja e viktimave të trafikimit, dhe në të njëjtën kohë krijimi mundësive për t'i këshilluar viktimat lidhur me opsionet dhe mënyrat e të jetuarit në një ambient të sigurtë. Do të desajnohet për të qenë i hapur 24 orë për viktimat e trafikimit apo individët të cilët besohet se janë viktimat e trafikimit.

<sup>50</sup> Duhet të theksohet se dëshmitari i dytë i cili ka dhënë dëshmi në rastin e përmendur në faqet 17-18 të këtij Raporti (që kyqte ish anëtarët e rangut të lartë të UÇK-së dhe i cili ishte vlarë me 14 Prill 2003) hoqi dorë nga programi për mbrojtjen e dëshmitarëve para se të vritet.

<sup>51</sup> Një gjykatës i cili gjatë këtij hartimit të këtij raporti – ka qenë i involvuar në një rast të profilit të lartë, në të cilin përlxoheshin dëshmitarët anonim, ka pranuar se i ka pasur të zbehta informatat lidhur me funksionimin e NJMV. Ai përmendi se për ekzistencën e tij kishte mesuar vetëm në "mbledhjet e DD".

OSBE-ja e pranon se administrimi i programit mbrojtës, në kontekstin kosovar, paraqet çështje mjaft problematike. Shoqëria kosovare është jashtëzakonisht e dendur dhe posedon me një numër relativisht të vogël të popullatës dhe territorit.<sup>52</sup> Pasojat e programit mbrojtës janë dy llojesh: Së pari, për shak se një numër relativisht i madh i dëshmitarëve “janë të njohur” për kryesit e dyshuar ose publikun dhe gjasat janë më të mëdha që këta të përjetojnë frikësime, prandaj edhe nevojitet që të mbrohen. E dyta, është shumë vështirë që dëshmitarët të zhvendosen (dhe familjet e tyre) përbrenda dhe që mos të vërehen. Prandaj ky njësit duhet të zhvendosë dëshmitarët (dhe familjet) jashtë vendit që paraqet veprim të shtrenjtë dhe kërkon bashkëpunimin me shtetet tjera. Pa marrë parasysh vështirësitë në këtë drejtim, OSBE mendon se shërbimet e ofruara nga NJMV do të mund të përmirësoheshin, si nga aspekti cilësor, poashtu edhe nga aspekti sasior, nëse do të alokoheshin më shumë resurse, dhe nëse do të kishte një koordinim më të mirë të punëve brenda strukturës së sistemit gjyqësor.

## ii. Zhvillimi i masave të mbrojtjes së dëshmitarëve për gjykata

“Gjatë koncipimit të kornizës së masave për luftimin e krimit të organizuar, duhet të miratohen rregulla procedurale specifike për t’u ballafaquar me frikësimet. Këto masa mund të aplikohen edhe ndaj veprave tjera të rënda. Këto rregulla do të siguronin balancin e nevojshëm brenda shoqërisë demokratike, ndërmjet parandalimit të çrregullimeve ose krimit dhe mbrojtjes së të drejtës së akuzuarit për gjykim të drejtë (korrekt).”<sup>53</sup>

Rregullorja, dhe më pas, Urdhëri nr. 2002/25 janë mjete të arsyeshme përmes të cilave gjykatësi mund të urdhërojë masat mbrojtëse për dëshmitarët të cilët mund të kërcënohen. Mirëpo, masa dhe sqarime të caktuara plotësuese, mund t’ju ndihmojnë gjykatave në ofrimin e mbrojtjes më të mirë për dëshmitarët dhe të sfërcojnë besueshmërinë e publikut ndaj sistemit. Në këtë fazë, duhet të përmendet se, çdo herë kur gjykata i zbaton masat e tilla, ajo duhet të ketë kujdesë, mos të shkelë me atë rast të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë.<sup>54</sup> Duke pasurë këtë parasysh, OSBE do të merr në konsiderat zhvillimet e mundëshme.

<sup>52</sup> Numri i popullsisë së Kosovës vlerësohet të jetë afro 2.3 milion banorë, në një territor prej 10,887 km<sup>2</sup> (HCIC, Prishtinë/Pristina)

<sup>53</sup> Rekomandimi i këshillit të ministrave të Këshillit të Evropës nr. R (97) 13 (Miratuar nga këshilli i ministrave me 10 shtator 1997, në mbledhjen e 600-të të zëvendës ministrave).

<sup>54</sup> Në lidhje me dëshmitarët anonim, Gjykata evropiane ka deklaruar se “shfrytëzimi i dëshmitarëve anonim nuk është jokompatibil në të gjitha rrethanat në raport me konventën. [...] Megjithatë, nëse ruhet anonimiteti i dëshmitarit të prokurorisë, atëherë mbrojtja do të haset me vështirësi gjatë procedurës penale të cilat zakonisht nuk janë të pranishme. Bazuar në këtë, kjo gjykatë pranon se në rastet e tilla neni 6 para. 1, së bashku me nenin 6 para. 3(d) të konventës [...] kërkon që pengesat me të cilat ballafaqohet mbrojtja, të kundërbalancohen përmes procedurave të respektuara nga autoritetet gjyqësore. Në fund, duhet të ripërmendet se denimi nuk do të duhej të bazohej tërësisht në apo në pjesën më të madhe në deklaratat anonime.” (Van Mechelen dhe të tjerët v. the Holandës, op. cit., para. 52, 53, 54 & 55; Visser v. Holandës, op. cit., para. 43; Gjithashtu Birutis dhe të tjerët v. Lituanië, 28 qershor 2002, para. 29; Doorson v. Holandës, 26 mars 1996, para. 70, 72, 76; P.S. v. Gjermanisë, op. cit., para. 22, 23, 24.) Sa i përket shpalosjes së dëshmiave për mbrotjen, Gjykata evropiane konsideron se “neni 6(1) kërkon [...] që organet e prokurorisë t’i shpalosë mbrojtjes të gjitha dëshmitë materiale në disponim që janë në dëm dhe në favor të të akuzuarit. [...] Mirëpo [...] e drejta e zbulimit të të gjitha dëshmiave relevante nuk është absolute. Në procedurë penale mund të ketë interesa konkurruese, siç janë [...] nevoja për mbrojtjen e dëshmitarëve nga treziku prej represaljeve [...] e cila duhet të vlerësohet në raport me të drejtat e të akuzuarit. [...] Në disa raste mund të shfaqet e nevojshme që mbrotjes mos t’i shpalosen dëshmi të caktuara për qëllim të ruajtjes së të drejtave themelore të individit tjetër [...]. Mirëpo, vetëm masat e kufizimit të të drejtave të mbrojtjes të cilat janë rreptësisht të domosdoshme janë të lejuara sipas nenit 6(1). [...] Më tutje, për të siguruar se të akuzuarit i ofrohet gjykim i drejtë, çdo vështirësi e cila i shkaktohet mbrojtjes për shkak të kufizimit të të drejtave të saj, duhet të kundërbalancohet me procedurat e autoritetit gjyqësor.” (Rowe dhe Davis v. M.B. Dhoma e Madhe, 16 shkurt 2000, para. 60, 61; Jasper v. M.B. Dhoma e Madhe, 16 shkurt 2000, para. 51 & 52; Fitt v. M.B. Dhoma e Madhe, 16 shkurt 2000, para. 44 & 45; I.J.L. dhe të tjerët v. M.B 19 shtator 2000, para. 112; Atlan v. M.B., 19 qershor 2001, para. 40; P.G. and J.H. v. M.B., 25 shtator 2001 para. 67 & 68). Në studimin më të ri të “The Scottish Executive Central Research Unit”, mbi masat mbrojtëse, është konkluduar se “parimi i përgjithshëm i cili demonstrohet nga e drejta precedentale e GjEDNj-ut, është ai se i akuzuari duhet të ketë të drejtën e kundërshtimit nën premisat e rrethanave të caktuara, në veçanti, lidhur me kategoritë e caktuara të dëshmitarëve të cilët mund të tërhiqen anonimitetin ose masat tjera ligjore mbrojtëse”. Ky studim ka gjetur se, sipas të drejtës precedentale të GjEDNj-ut, dëshmia e dëshmitarit anonim konsiderohet e papranueshme përveç kur plotësohen kushtet si në vijim:

- Kur mbrojtja ka pasur mundësi të testojë besueshmërinë e dëshmitarit;
- Kur ekzaminimi i fakteve ka pasur mundësi që ketë qasje në besueshmërinë e dëshmitarit;
- Kur masat mbrojtëse shfrytëzohen vetëm nëse janë “rreptësisht të domosdoshme”; dhe

Së pari, gjykata ose prokurori duhet në rastin e parë të mundur, të njoftojë dëshmitarët të cilët *mund t'i* nënshtrihen kërcënimit, mbi masat mbrojtëse për dëshmitarë të cilat janë në disponim sipas Rregullores (gjatë fazës së hetimeve dhe gjatë gjykimit), dhe kjo do të duhej të kishte karakter obligativ. Momentalisht, ligji madje nuk i inkurajon gjykatësit të njoftojnë dëshmitarët. Një obligim i tillë do të siguronte dëshmitarët (gjykatat dhe prokuroritë) të jenë plotësisht të njohur me dispozitat e Rregullores.<sup>55</sup> Krahas kësaj, gjykatat kanë për obligim të japin vendime me arsyetim të duhur gjatë vendosjes për aplikimin e masave mbrojtëse.<sup>56</sup>

Së dyti, mungesa e udhëzimeve (të punës) dhe pajisjeve teknologjike ka nënkuptuar se gjykatat është dashur të krijojnë procedura të reja për zhvillimin e sancave për caktimin e masave mbrojtëse e sidomos kur është fjala për dëshmitarët anonim.<sup>57</sup> Rrjedhimisht, në disa raste kur gjykatat kanë mundësuar dëshminë anonime të dëshmitarit, janë aplikuar procedura të ndryshme.<sup>58</sup> Edhapse udhëzimet në këtë drejtim duhet të jenë mjaft fleksibile për rrethanat konkrete, duhet të ekzistojë një shkallë e qartësisë në aspekt të procedurës që duhet ndjekur. Aplikimi i procedurave të ndryshme për qëllime të njëjta mund të shkaktojë huti në mesin e palëve dhe mungesë të konsistencës në mesin e jurisprudentës. Më tej, pa udhëzimet statutorë (të punës), ekziston mundësia më e madhe e shkeljes së të drejtave të të akuzuarit me rastin e aplikimit të procedurës.

Së treti, ligji duhet të parashikojë në mënyrë shprehimore për mbajtjen e “seancës për dëshmitarë të mbrojtur” jashtë gjykatorës dhe vetëm në prani trupit gjykues, dhe duhet të parashikojë udhëzime të qarta mbi procedurën që duhet zhvilluar. Edhapse Rregullorja e fuqizon gjykatën të dëgjojë dëshmitarët anonim, ajo nuk parashikon në mënyrë specifike procedurën në të cilën dëshmitari mund të “*dëgjohet nga gjykatësit*”, pa praninë e të gjithë të tjerëve.<sup>59</sup> Për dallim nga kjo, Ligji i mbrojtjes së dëshmitarëve të kërcënuar dhe të rrezikuar, i Bosnës dhe Hercegovinës, (Ligji i Bosnës) i datës 1 mars 2003, parashikon një procedurë të tillë – e quajtur “dëgjimi i dëshmitarit të mbrojtur” – e cila i dedikon 9 nene të cilat udhëzojnë gjykatat për mënyrën e aplikimit të tij. Neni 19 i Ligjit të Bosnes thekson;

- (1) Seanca mbi dëshmitarin e mbrojtur zhvillohet nga trupi gjykues prej tre gjykatësve...]
- (2) Dëshmitari do të njoftohet se:
  - a) Do të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit të mbrojtur;

---

- Kur i akuzuari nuk dënohet duke u bazuar tërësisht në pjeësn më të madhe në dëshminë e dëshmitarit anonim. (Lexo, Dokumenti njoftues mbi çështjet ligjore të mbrojtjes së dëshmitarëve në rastet penale, “The Scottish Executive Central Research Unit 2001 sipas kërkimeve nga Universiteti në Dundee).

<sup>55</sup> Lexo për shembull, Ligjin mbi mbrojtjen e dëshmitarëve të kërcënuar dhe të rrezikuar, 1 mars 2003, i Bosnes dhe Hercegovinës, ku një obligim i tillë është i paraparë me ligj:

“(1) Gjykata, prokuroria dhe organet tjera pjesëmarrëse në procedurë **do të** këshillojnë *ex officio*, dëshmitarin e cili mund të jetë i kërcënuar apo i rrezikuar, mbi masat e mbrojtjes së dëshmitarëve të parapara me këtë ligj”. Neni 5.

<sup>56</sup> Vendimi mbi anonimitetin ofron shumë pak të dhëna dhe vetëm thekson: “ky vendim/urdhër është marrë për shkak se gjykata është bindur se ekziston rreziku i madh për dëshmitarin. Për qëllim të mbrojtjes së identitetit të dëshmitarit, nuk e këshilloeshme që të jepen më shumë arsye konkrete për këtë bindje të gjykatës (neni 4.2 (a) në ndërlidhje me nenin 4.3)”.

<sup>57</sup> Udhezimet thjeshtë theksojnë se dëshmitari anonim “do të dëgjohet në pajtim me procedurën e caktuar nga gjykata” (neni 1.1). Si duket gjykatat nuk janë pajisur me pajisjet të cilat i përmend ligji siç janë, penguesit e zërit, ekranet me fotografi të ndryshuar apo video-pajisjet tjera.

<sup>58</sup> Në një rast të mbajtur në Prizren, gjykatësit, prokurori dhe stafi esencial e kanë dëgjuar dëshminë e dëshmitarit të mbrojtur nga një dhomë e ndarë, e kanë lexuar procesverbalin e asaj dëshmie në gjykim të hapur, dhe janë kthyer prapa në dhomën e ndarë për t'i parashtruar pyetje plotësuese dëshmitarit të cilat ishin propozuar nga mbrojtja. Mbrojtja ishte përjashtuar tërësisht nga kjo procedurë – fizikisht dhe teknikisht – gjatë dhënjes së dëshmisë nga dëshmitari anonim. Në një rast tjetër në Prishtinë/Pristina, gjykatësit dhe palët kanë mbetur në gjykatore përderisa dëshmitari ishte vendosur në një dhomë tjetër, dëshmitari ka mundur të përcjellë procedurën përmes dëgjimoreve dhe i është përgjigjur pyetjeve të gjykatësve dhe mbrojtësve përmes mikrofonit. Pra, gjykatësit nuk i kanë parë sjelljet e dëshmitarit anonim gjatë dhënjes së dëshmisë së tij.

<sup>59</sup> Edhe nëse Rregullorja mund të interpretohet se e lejon një seancë të tillë, kjo nuk ofron asnjë udhëzim mbi atë se si do të duhej zhvilluar e njëjta.



- b) Identiteti i tij nuk do t'i zbulohet asnjë personi tjetër nga anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësit;
- c) Nuk do të paraqitet personalisht para trupit gjykues gjatë asnjë séance tjetër nga ajo e dedikuar për dëshmitarë të mbrojtur; dhe
- d) Nuk është i obliguar t'ju përgjigjet pyetjeve të cilat do të tregonin për identitetin e tij apo të anëtarëve të familjes.

(3) Trupi gjykues do të dëgjojë dëshmitarin hollësisht mbi rrethanat e sugjeruara nga pala përmes kërkesave dhe mbi të gjitha rrethanat të cilat i konsideron trupi gjykues si të domosdoshme.<sup>60</sup>

Ligji i Bosnes mbi dëgjimin e dëshmitarëve të mbrojtur shkon edhe më largë duke aplikuar mburoja optike, pajisjet për ndryshimin e zërit, ekranet me fotografi të ndryshuar etj. Parashikon edhe seancat speciale që zhvillohen në objektet jashtë gjykatores, dhe pa praninë e prokurorit, avokatit mbrojtës, të akuzuarit, palës së dëmtuar, punëtorëve të gjykatës, të sigurimit, publikut apo secilit person (përveç ndoshta procesmbajtësit dhe përkthyesit). Procesverbali i seancës me shënimin e pseudonimit për dëshmitarin, i jepet në shiqim palëve. Trupi gjykues mund të mbajë seancë tjetër për t'i parashtruar pyetje dëshmitarit (*ex officio* ose sipas kërkesës së prokurorit apo mbrojtjes) për sqarimet mbi dëshminë e dhënë paraprakisht apo për të marrë informata mi diçka që nuk është përmendur më heret. Ligji i Bosnës përcakton edhe procedurat e hollësishme të cilat kanë për qëllim garantimin e konfidencialitetit të identitetit të dëshmitarit gjatë apo deri në 30 vjet pas përfundimit të gjykimit.<sup>61</sup> Më tej, siguron që procedura, e cila mund të aplikohet vetëm në rrethana përjashtimore,<sup>62</sup> të mos të prekë të drejtën e të akuzuarit në gjykim të drejtë. Për të gjitha aspektet specifike, ky ligji parashikon udhëzimet përkatëse për gjykatat. Mendimi i OSBE-së është se prania e një seance për dëshmitarë të mbrojtur sikurse është paraparë me Ligjin e Bosnes, do të ndihmonte në risigurimin e dëshmitarëve se gjykatat kanë në disponim mjetet për mbrojtjen e identitetit të tyre për periudhë afatshkurte dhe afatgjate.

Së katërti, ligji duhet të parashikojë në mënyrë shprehimore sanksionin penal për shkeljen e urdhërit për masat mbrojtëse kundër secilit person, ose kur personat zyrtarë të cilët e kryejnë detyrën në ndërlidhje me masat mbrojtëse të zbulojnë të dhënat konfidenciale.<sup>63</sup> Gjykata ka për obligim të paralajmërojë të gjithë personat për këtë sanksion. Teksti i kësaj Rregulloreje nuk përmend shprehimisht se zbulimi i informacioneve të mbrojtura paraqet vepër penale. Kjo mund të sqarohet, së paku pjesërisht, se pse avokati mbrojtës në rastin më të ri në Prishtinë/Priština, e ka paraqitur para mediave përmbledhjen e dëshmisë së dëshmitarit të mbrojtur një ditë pas dhënjes së kësaj dëshmie (dëshmitari i mbrojtur është dëgjuar në mënyrë anonime pa pjesëmarrjen e publikut).<sup>64</sup> Edhe pse gjykata mund të interpretojë ligjin ekzistues në

<sup>60</sup> Teksti i plotë i Ligjit të Bosnes mund të gjendet në website-n e OHR.

<sup>61</sup> Për shembull, në lidhje me procesverbalin e dëshmisë së dëshmitarit të mbrojtur, Ligji i Bosnes parashihet që: Gjykata do të marrë të gjitha masat të sigurojë konfidencialitetin e shënimeve duke i veçuar ato nga lënda dhe duke i mbajtur në një vend të sigurtë; kthimin e procesverbalit në vendin e sigurtë pas shfrytëzimit të tij në seancën e duhur në procedurë penale dhe kur vendimi të bëhet i plotëfuqishëm; dhe sigurimin e arkivimit afatgjatë të shënimeve në mënyrën e cila e lejon qasjen në këto shënime vetëm për kryetarin e devizionit penal për periudhën e cila konsiderohet e nevojshme, por nuk duhet të tejkalohet periudhën 30 vjeçare pas plotfuqishmërisë së vendimit (neni 20).

<sup>62</sup> “Në rrethana të jashtëzakonshme, kur ekziston rreziku për sigurinë personale të dëshmitarit apo familjes së tij, dhe rreziku është aq i lartë sa që ekzistojnë shkaqet e arsyeshme për të besuar se rreziku nuk do të largohet pas dhënjes së dëshmisë, gjykata mund të zhvillojë seancën për dëshmitarë të mbrojtur në pajtim me nenet 15 deri 23 të këtij ligji” (Ligji i Bosnes, neni 14).

<sup>63</sup> Për shembull, Ligji i Bosnes, i cili në tekstin e vet thekson se zbulimi i të dhënave të siguruar në lidhje me asat mbrojtëse paraqet vepër penale:

Gjykata apo prokurori **do të** paralajmërojnë personat e pranishëm në seancë, të cilët përndryshe posedojnë me të dhënat sekrete gjatë kryerjes së detyrës së tyre, se zbulimi i paautorizuar i informatave **paraqet vepër penale**.

Nga personat të cilët e kryejnë detyrën zyrtare në lidhje me masat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të cilët posedojnë informatat nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund të kërkohej në asnjë procedurë gjyqësore, tribunal apo hetim, që të prodhojnë ndonjë dokument ose të komunikojnë çfarëdo çështje që ndërlidhet me atë informatë (neni 24).

<sup>64</sup> Publikuar në Kosova Sot, 21 mars 2003.

Kosovë, në mënyrën e cila e lejon sanksionin për shkak të shkeljes së urdhërit mbrojtës, prapë në këtë rast ligji është i dykuptimtë.<sup>65</sup>

Në fund, gjykatësit, prokurorët dhe avokatët mbrojtës duhet të jenë të gatshëm dhe të kenë mundësi të përdorimit të Rregullores atëherë kur kjo është e mundur. Përderisa janë kërkuar masat mbrojtëse dhe për anonimitet për dëshmitarë, për disa raste të pakta të profilit të lartë, në shumicën e madhe të rasteve në të cilat dëshmitarët ishin frikësuar, prokurorët nuk i kanë kërkuar masat, dhe gjykatësit nuk i kanë caktuar ato. Që nga shtatori i vitit 2001, që kur ka hyrë në fuqi, kjo Rregullore është zbatuar në vetëm tre raste. Kjo është për t'u habitur kur merret parasyshë numri i incidenteve që involvojnë frikësimin e dëshmitarëve. Por nuk është befasuese – duket se (si rregull) as gjykatësit dhe prokurorët vendës e as ata ndërkombëtarë, nuk kanë përvojë të mjaftushme për rastet të cilat involvojnë masat mbrojtëse për dëshmitarë. Për këtë arsye, për gjykatësit dhe avokatët duhet të organizohet trajnim mbi aplikimin e Rregullores 2001/20.<sup>66</sup>

### *iii. Ndërtimi i besueshmërisë së opinionit publik*

Krahas zhvillimit të sitemit mbrojtës për dëshmitarët, autoritetet duhet të kërkojnë edhe ndërtimin e besueshmërisë së opinionit publik. Për të realizuar këtë, autoritetet e UNMIK-ut duhet të vëjnë nën shënjestër dy grupe: së pari, dëshmitarët potencial të cilët për shkak të frikës së tyre dhe mosbesimit në sistem, vendosin në rend të parë të mos i raportojnë rastet në polici. Në lidhje me këtë, duhet të inicohet një fushatë e publike informative për të ofruar një pasqyrë më të qartë dhe të dhëna precize mbi masat ekzistuese për dëshmitarët të cilët kualifikohen për mbrojtje, përmes NJMV ose përmes gjykatave. Së dyti, dëshmitarët të cilët vendosin të paraqiten dhe t'i raportojnë rastet policisë, por të cilët më pas mund të ndryshojnë deklaratën e tyre për shkak të frikësimeve nga ata kundër të cilëve raportohet. Për t'u siguruar se këta dëshmitarë të vazhdojnë t'u ndihmojnë autoriteteve, ata të cilët mund të bëhen objekt i frikësimeve duhet të njfotohen me sistemin e mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë, në mënyrë sa më reale dhe të sinqertë, menjëherë pas paraqitjes së rastit në polici.<sup>67</sup>

Duke vënë në cak këto grupe, UNMIK-u do të inkurajojë dëshmitarët që t'i ndihmojnë policisë në hetimet e tyre dhe mund të ofrojnë dëshmi për gjykatat.

## **E. Përfundim**

Frikësimi i dëshmitarëve në sistemin penalo-juridik të Kosovës paraqitet si problem mjaft brengosës. OSBE ka regjistruar incidente të shumta të frikësimeve apo kërcënimeve nëpër regjione të ndryshme të krahinës, pra në një vistër rastesh, prej tyre më të dalluarat, ato të gjykimeve të profilit të lartë politik. Ekziston një druajtje e rritur për dëshmitarët se ata mund të bëhen tepër të frikësuar për t'i ndihmuar autoritetet në luftën kundër krimit – posaçërisht krimit të organizuar – për shkak se nuk i besojnë sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve. Kjo do të minonte seriozisht aftësinë e autoriteteve për promovimin e të

<sup>65</sup> Psh, Ligji Penal i Kosovës, neni 50 (zbulimi i paautorizuar i sekretit) dhe neni 178 (shkelja e konfidentalitetit gjatë procedurës).

<sup>66</sup> "Personeli i judikaturës duhet të trajnohet në mënyrë adekuate për t'u marrë me rastet kur dëshmitarët mund të rrezikohen nga frikësimet" Parimi i përgjithshëm nr. 7, i Rekomandimeve të këshillit të ministrave të Këshillit të Evropës nr. R (97) 13 (Miratuar nga këshilli i ministrave me 10 shtator 1997, në mbledhjen e 600-të të zëvendës ministrave).

<sup>67</sup> Për momentin, duket se ka shumë pak informacione në opinionin publik mbi NJMV ose programin e tij. Më tej, sipas një pjesëtari të njësitit, disa dëshmitarë pasi që fillimisht ishin pajtuar të japin deklaratë para policisë, atyre i u janë dhënë premtime joreale lidhur me natyrën dhe shkallën embrojtjes e cila kishte mundur t'ju ofrohet. Për dallim nga kjo, në sistemin federal të SHBA-ve dëshmitari pasi të pajtohet me u inkuadru në program, ai dhe familja e tij e nënshkruajnë një Memorandum të mirëkuptimit e cili precizon pritjet dhe obligimet të cilat priten të përbushën nga të gjitha palët. Shërbimi Marshall i SHBA-ve pastaj obligohet t'i plotësoj të gjitha zotimet sipas dokumentit të nënshkruar për atë kohë sa qëndron në program dëshmitari. Në këtë mënyrë këto pritje mund të adresohen në mënyrë më reale para se të fillojë vetë programi. Kjo masë lejohet atëherë kur rasti kërkon masa të posaçme dhe kur dëshmitari i përbushë kriteret e caktuara.

drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës. Në këtë drejtim, vlenë të rikujtohet deklarata e zyrës së SHB-ra në Prishtinë, e bërë pas vrasjes së ish-dëshmitarit të dytë të prokurorisë të një procesi gjyqësor të rangut të lartë të UÇK-së.

“Edhe një herë, me gjakftohtësi është vrarë një dëshmitarë i një procesi gjyqësor për vrasje në Kosovë. Ende nuk është provuar nëse vrasja mund të ndërlidhet me gjykimin në të cilin Z. Selimaj ka dëshmuar, por mbetet fakti se kjo është hera e dytë, brenda katër muajsh, që me gjakftohtësi vritet dëshmitari i një gjykimi për vrasje, dhe në një pusi të planifikuar me kujdes në regjionin e Pejës. Brutaliteti i këtyrë vrasjeve – të cilat gjithashtu kanë vënë nën shënjestër fëmijët, me një mospërfillje të pashpirtë të jetës njerëzore – duket se kanë për qëllim terrorizimin e komunitetit më të gjërë të Kosovës dhe minimin e sundimit të së drejtës. Të jemi të qartë lidhur me këtë. Vrasjet e tilla jo vetëm që eliminojnë thjeshtë dëshmitarët dhe i frikësojnë ata për të dëshmuar kundër elementeve kriminale në Kosovë, por edhe e parandalojnë Kosovën në arritjen e standardeve para fillimit të bisedimeve për statusin final të saj.”<sup>68</sup>

Autoritetet duhet t’i japin prioritet zhvillimit të sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve që do të ishte efikas për Kosovën. Masat e shqiptuara nga UNMIK-u gjatë dy viteve të kaluara, vuajnë nga mungesa e vendosshmërisë, por edhe mungesa e koordinimit gjatë zbatimit të tyre. Këto mangësi, duhet të mënjanohen. Pastaj, duhet të organizohen trajnime për gjykatës dhe avokatë lidhur me shfrytëzimin e sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve, dhe autoritetet duhet të mëtojnë ndërtimin e besueshmërisë tek opinionioni publik mbi aftësinë e tyre për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Edhe pse frikësimi i dëshmitarëve mund të mos zhduket kurrë – veçanërisht në një shoqëri të dendur sikur që është kjo e Kosovës – zhvillimi i sistemit në mënyrën e përkufizuar me këtë raport do të ndihmonte reduktimin e konsiderueshëm të këtyre incidenteve.

## **F. Rekomandimet**

*RE: Programi për mbrojtjen e dëshmitarit:*

- \* Shtylla I, duhet t’i ofrojë Njësitit për mbrojtjen e dëshmitarit (“NjMD”), më shumë burime financiare, me qëllim të ofrimit të një programi të gjerë të mbrojtjes së dëshmitarit për një numër më të madh të dëshmitarëve. Ajo duhet gjithashtu të siguroj se NjMD do të ketë në dispozicion nivelin e domosdoshëm të ekspertizës teknike.
- \* Shtylla I duhet të ndërmerr të gjitha hapat e domosdoshme për të identifikuar shtetet që janë të pajtimit të pranojnë dëshmitarët e mbrojtur të cilët duhet të zhvendosen jashtë Kosovës.
- \* NjMD-ja duhet të jetë në gjendje të garantojë që informatat senzitive duhet të mbesin konfidenciale në planin afatgjatë, edhe pasi që administrimi i NjMD-së t’i jetë dorëzuar në kompetencë të SHPK-së.
- \* Duhet të vendoset një procedurë e thellësishme për përzgjedhjen e policëve të SHPK për angazhimin në NjMD

<sup>68</sup> Komunikatë për shtyp e Zyrës së SHB-re në Prishtinë 15prill 2003.

- \* Një marrëdhënie më formale dhe më e strukturuar duhet të krijohet me qëllim të promovimit të koordinimit më të mirë ndërmjet policisë, NjMD-së, prokurorëve dhe gjykatave, dhe të sigurojë që masat për mbrojtjen e dëshmitarëve të zbatohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të plotë.
- \* Duhet të ofrohen trajnime për gjyqtarë dhe juristë, nga Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Qendra e resurseve për mbrojtje penalo-juridike, mbi rolin dhe veprimin e NjMD-së dhe programit të saj për mbrojtjen e dëshmitarit.
- \* DD duhet të lëshojë një Qarkore Gjyqësore për të gjithë gjykatësit dhe prokurorët për të bërë të ditur rolin e NjMD si dhe lehtësirat që rezultojnë nga programi për mbrojtjen e dëshmitarëve

*RE: Rregullorja e UNMIK-ut 2001/20:*

- \* PSSP duhet të nxjerrë një urdhëresë administrative e cila do të parahihte obligimin e gjykatës apo prokurorit, që në rastin e parë të mundshëm, të informojë dëshmitarin i cili mund të jetë i kanosur, për masat për mbrojtjen e dëshmitarit të cilat janë në dispozicion në bazë të rregullores në fjalë.
- \* PSSP duhet të nxjerrë një urdhëresë administrative me qëllim që të ofrohen më shumë udhëzime të punës për gjykatat të cilat në procedurat e tyre gjyqësore përfshijnë dëshmitarët anonim. Për më tepër, secila gjykatë e qarkut duhet të furnizohet me mjete praktike dhe teknike për fshehjen më të lehtë të identitetit të dëshmitarëve, siç janë: ekranet, pajisjet për ndërrimin e zërit, ekranet televizive apo pajisjet video për ndërrimin e fotografisë. Kjo do të ndihmojë që procedurat e tilla të jenë të qarta dhe të qëndrueshme.
- \* Rregullorja duhet të ndryshohet me qëllim që të parasheh ‘mbajtjen e seancës dëgjimore që përfshin dëshmitarin e mbrojtur’ të mbahet jashtë gjykatores dhe vetëm në prani të trupit gjykues. Ndryshimet duhet të përfshijnë udhëzime për justifikimin e mbajtjes së seancës së tillë dëgjimore, procedurën e cila duhet zbatuar, formën dhe përdorimin të shkresave lëndës dhe të drejtës për ankesë.
- \* Rregullorja duhet të ndryshohet me qëllim që të parasheh në mënyrë shprehimore se shkelja e urdhërit për masa mbrojtëse paraqet vepër penale, apo zbulimi i informatave konfidenciale nga ana e zyrtarit i cili vepron në zbatimin e masave mbrojtëse.

*RE: Ndërtimi i besimit të publikut:*

- \* Shtylla I duhet të lansojë një fushatë e informimit publik me qëllim që të risigurohet publiku i përgjithshëm se ekzistojnë mjete nëpërmjet të cilave autoritetet mund t’i mbrojnë dëshmitarët në Kosovë.
- \* Policia duhet të fillojë të ofrojë informata dëshmitarëve mbi ekzistimin e sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë, në mënyrë reale dhe të sinqertë, menjëherë pasi këta dëshmitarë të kenë raportuar krimin për herë të parë në polici.

## PJESA 4:

### ÇËSHTJET E PËRSËRITURA NGA RAPORTET E MËPARSHME

#### *Pavarësia e gjyqësisë*

##### *Çështjet*

- Shqetësimet për mungesën e pavarësisë gjyqësore
- Ekzekutivi në mënyrë të parregullt ndërhyrë në punën e gjyqësisë; ekziston droja se ndarja e pushtetit nuk është bërë në mënyrë absolute.

#### *Hyrje*

Pavarësia e gjyqësisë është pjesë përbërëse e demokracisë; e cila ruan procesin gjyqësor nga intervenimet e jolegjitime të shtetit. Gjithashtu, individëve u ofron garanca që sistemi i gjyqësisë posedon mekanizmat për të ofruar mbrojtje ligjore, kur është e nevojshme, nga veprimet apo vendimet e autoriteteve shtetërore. Raporti i fundit<sup>69</sup> ka analizuar shkallën e pavarësisë gjyqësore ekzistuese brenda strukturës së UNMIK-ut, nga dy pikëpamje, respektivisht, pavarësinë insitucionale dhe pavarësinë funksionale.

#### *Pavarsia institucionle*

Në lidhje me pavarësinë institucionale, OSBE ka rekomanduar që Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64<sup>70</sup> të ndryshohet në mënyrë që t'i adresojë shqetësimet lidhur me dukurinë e mungesës së pavarësisë gjyqësore.<sup>71</sup> Në bazë të këtyre rekomandimeve, drejtori i atëherëshëm i Departamentit të Drejtësisë inicoi konsultime me OSBE-në dhe shqyrtoi të gjitha rregulloret e UNMIK-ut që kanë të bëjnë me emrimin e zyrtarëve ndërkombëtarë të gjyqësisë.<sup>72</sup> Që këto shqetësime të adresohen, DD përpiloi një rregullore të re, e cila tentonte të zëvendësonte

<sup>69</sup> Raporti i katërt, shtator 2001-shkurt 2002, faqe 25.

<sup>70</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 për caktimin e gjykatësve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndërrimin e vendit, e hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2000.

<sup>71</sup> Pavarësia e gjyqësisë në kuptimin e saj institucional kryesisht tenton që të sigurojë shfaqjen e pavarësisë nga qfardo dyshimi i intervenimit të jashtëm. Kërkohej që gjyqësia të përbëhet nga zyrtarë që gëzojnë garanca të definuara mirë lidhur me emrimet apo largimet nga zyra, përgjegjësia disiplinore dhe rregullat e caktimit të rastit. Në lidhje me gjykatësit ndërkombëtarë OSBE është e shqetësuar, *inter alia*, që ka shfaqje të kontrollit ekzekutiv për arsye të statusit të tyre si puntorë civil të UNMIK-ut, procedura dhe kohëzgjatja e emrimit të tyre, dhe fakti që vetë ekzekutivi vendosë përfundimisht për vazhdimin e kontratave të tyre. Për shkak të mungesës së procedurës disiplinore për gjykatësit ndërkombëtarë, opioni i vetëm për ekzekutivin për të mbajtur një gjykatës të përgje gjëshëm për veprimet e tij është kur të vazhdohet kopntrata. Një opion i tillë, megjithatë, jo në përputhshmëri me garancat e pavarësisë funksionale. Më tepër gjykatësit ndërkombëtarë të caktuar në rastet nën dispozitat e Rregullorës së UNMIK-ut 2000/64 nuk caktohen në raste përmes mekanizmave të rregullt-siç duhet të jetë- por janë të caktuar nga DD, me aprovimin e PSSP. Për më tepër detaje lexo shqyrtimet e më parshme, shtator 2001-shkurt 2002, faqe 25.

<sup>72</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 mbi emrimin dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, siç është e përmirësuar nga Rregulloret e UNMIK-ut 2000/34, dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/2, dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi caktimin e gjykatësve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndërrimin e vendit, siç është e përmirësuar me Rregullorën e UNMIK-ut 2001/34.

gjithë legjislacionin mbi këtë çështje. OSBE përshëndetë nivelin e konsultimeve të zhvilluara nga DD si the përmbajtjen e projekt Rregullores, e cila i adreson shumicën e shqetësimeve. Megjithatë, deri më sot, kjo rregullorja nuk është nënshkruar. Përkundrazi, në dhjetor 2002, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 është vazhduar deri me 15 dhjetor 2003.<sup>73</sup> Rrjedhimisht, përkundër përpjekjeve në anë të DD dhe OSBE-së për të prezentuar një procedurë të re, ende ekzistojnë shqetësimet lidhur me shfaqjen e mungesës së pavarësisë gjyqësore.

### ***Pavarsia funksionale:***

Gjyqësia duhet gjithashtu të gëzojë pavarësi funksionale, përkatësisht, liri nga ndërhyrja e ekzekutivit në veprimtarinë gjyqësore.<sup>74</sup> OSBE ka monitoruar raste në të cilat ekzekutivi në mënyrë jo të drejtë ka ndërhyrë në marrjen e vendimeve gjyqësore:

Në një rast të tillë, Gjykata e Qarkut në Prizren, kishte filluar hetimet kundër një oficeri të policisë së UNMIK-ut për arsye të supozimit se ky gjatë marrjës në pyetje e kishte keqtrajtuar një të dyshimtë. Me 5 qershor 2002, gjykatësi ndërkombëtarë kryetar i kolegjit përgjegjës për këtë rast, kishte konstatuar se, dosja nuk përmbante dëshmi të mjaftueshme për të treguar se ishte tërhequr imuniteti i policit. Rrjedhimisht gjykatësi e kishte kthyer aktakuzën te prokurori, me urdhër që të përmirësojë këtë të metë.<sup>75</sup> Në bazë të informatave të OSBE-së<sup>76</sup>, me 28 qershor 2002, drejtori DD-së ka vizituar gjykatësin ndërkombëtarë në Prizren. Drejtori i atëherëshëm i DD-së kishte kërkuar nga gjykatësi që të mos këmbëngulë në këtë urdhër për kërkimin e dëshmive mbi heqjen e imunitetit, dhe në mes tjerash, kishte deklaruar, “*pas vetëm katër javësh qëndrimi këtu, do të ishte shumë herët për të ndryshuar një praktikë të vendosur, përkitazi me mënyrën e heqjes së imunitetit*”. Ditën e nesërme në një takim të Divizionit të përkrahjes gjyqësore/gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë, sipas gjykatësit ndërkombëtar, këshilltari juridik i PSSP-së e kishte ngritur këtë çështje konkrete dhe kishte udhëzuar secilin gjykatës që të pranojnë praktikën e themeluar, e jo të urdhërojnë për dëshmi plotësuesenë në raste të tilla. Prandaj, dy antarë të lartë ekzekutivit kanë bërë presion në gjykatësin për të ndryshuar vendimin e tij në rastin që ishte duke vazhduar.<sup>77</sup>

Pa hyrë në nevojën meritore të urdhërit gjyqësor, pikëpamja e OSBE-së është se, është i papranueshëm ushtrimi i presionit të tillë në gjykatës nga ana e pushtetit ekzekutiv. Trajnimit mbi “*praktikat e themeluara*” do të mund të ofroheshin për gjykatësit, por vërtetimi faktik dhe vendimet ligjore mbi rastet e caktuara, i takojnë vetëm gjykatësit.

Ndërhyrja e ekzekutivit veçanërisht është shqetësues, duke pasë parasyshë faktin se, dega e ekzekutivit të UNMIK-ut, (DD dhe PSSP), ua vazhdon kontratat gjykatësve.

<sup>73</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2002/20 duke përmirësuar Rregullorën e UNMIK-ut 2000/64, mbi caktimin e gjykatësve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndërrimin e vendit.

<sup>74</sup> Lexo *Beaumontin v. Francës*, KNDNJ, 24 nëntor, 1994.

<sup>75</sup> Neni 263 (2) LPP RFJ parasheh që “Menjëherë pas marrjes së aktakuzës, kryetari i kolegjit para të cilit do të mbahet seanca kryesore, do të lexojë nëse aktakuza është përpiluar në rregull (neni 262) dhe kur gjenë se nuk është në rregull, do t’ja kthejë paditësit që brenda afatit prej tri ditësh të korrigjojë të metat”.

<sup>76</sup> Shënim për dosje, i datuar 3 korrik 2002, nga gjykatësi kryesues ndërkombëtarë.

<sup>77</sup> Shënimi në dosje, i datuar 3 korrik 2002, nga gjykatësi kryesues ndërkombëtarë shkruan: “Pas përpjekjeve për të bindur gjykatësin ndërkombëtarë {...} – si anëtarë të mundshëm të kolegjit të ardhshëm – në telefon drejtori {...} dhe asistenti i tij {...} erdhën me helikopter në kampin e KFOR-it gjerman vetëm për të biseduar me të nënshkruarin lidhur me “problemin e imunitetit në {...} rast” {drejtori} i tha të nënshkruarit pas vetëm katër javësh qëndrimi këtu, do të ishte shumë herët për të ndryshuar një praktikë të vendosur, përkitazi me mënyrën e heqjes së imunitetit”. Edhe spe i nënshkruari u spjegoi atyre që nuk do të pranojë kurfarë presioni dhe që do të veprojë në përputhshmëri strikte me ligjin ashtu ai si e kupton subjekti prap[ është diskutuar në mbledhjen mujore të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në Prishtinë ditën e nesërme – 29 qershor 2002 në të cilën këshilltari juridik {...} morri pjesë. Ai diskutoi para gjithë pjesëmarrësve problemin e heqjes së imunitetit në {...} rast dhe urdhëroi secilin që të pranoi praktikën e themeluar. Ai prezantoi një dokument të ri, të datuar 27 qershor 2002 të përgaditur nga vet ai dhe e adresoi te {...} në të cilin ai personalisht konfirmoi që Sekretari i Përgjithshëm ia ka hequr imunitetin me 1 mars 2002.”

***Për arsyet e përmendura më lart, OSBE rithekson rekomandimet e veta:***

- Zyrtarisht duhet të miratohen kriteret precize dhe transparente, përmes udhëzimit administrativ, për të definuar dhe vlerësuar zbatueshmërinë e Rregullores 2000/64 për rastet konkrete. Këto kritere duhet të zbatohen në mënyrë strikte. Për të përforcuar përgjegjshmërinë, vendimet e PSSP për të aplikuar Rregulloren, duhet të jenë të arsyetuara nga pikëpamja e ligjit dhe fakteve.
- Duhet të krijohet një mekanizëm, për ndarjen e lëndëve për gjykatësit, sipas sistemit të rastësisë; ndarja e rasteve për gjykatësit, nuk duhet të bëhet sipas diskrecionit të drejtorit të DD dhe PSSP-së. Gjykatësit e çështjes (lëndës së ndarë) sipas Rregullores 2000/64, duhet të obligohen me të gjitha garancitë procedurale të parapara me ligjin vendës, përfshirë këtu edhe dispozitat mbi përjashtimin e tyre mbi bazat e njëanshmërisë.
- Gjykatësit ndërkombëtarë duhet t'i nënshtrohen mekanizmave të njëjtë të përgjegjësisë disiplinore, të cilëve u nënshtrohen anëtarët tjerë të gjyqësisë në Kosovë.<sup>78</sup>
- Duke pasë parasyshë se kontratat e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, kanë kohëzgjatje relativisht të shkurtë, vendimi mbi vazhdimin e kontratave duhet të merret jashtë autoritetit të DD dhe PSSP-së, si një lloj garancioni për pavarësinë efikase institucionale. Vendimet e tilla do të duhej të merreshin nga Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës apo së paku mbi baza të rekomandimeve të bëra nga Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës.
- OSBE, më tej rekomandon që raportuesi special për pavarësi të gjykatësve dhe avokatëve, i Komisionit për të drejtat e njeriut të KB-ra, të vizitojë Kosovën

**B: Paraburgimi**

***Çështjet***

- Mungesa e mekanizmit *habeas corpus*;
- Ruajtja e kompetencës për PSSP-në për të paraburgosur është e paligjshme;
- Paraburgimet e kryera nga KFOR-i, ende janë të paligjshme dhe të pa arsyetuara.
- Paraburgimi i personave me sëmundje mentale.

<sup>78</sup> Drita  
disipl

sanksionet

## Hyrje

E drejta e kundërshtimit të paraburgimit para një organi gjyqësor (*habeas corpus*) është parim themelor i të drejtës ndërkombëtare.<sup>79</sup> Ligji ndërkombëtarë ua garanton këtë të drejtë të gjithë njerëzve të cilëve u është hequr liria, dhe jo vetëm për ata të cilët janë paraburgosur në lidhje me ndonjë vepër penale.<sup>80</sup> Gjithashtu, personat e arrestuar dhe të paraburgosur kanë të drejtë në vendim të shpejtë gjyqësorë lidhur me ligjëshmërinë e paraburgimit dhe nëse ky i fundit dëshkohet të jetë i paligjshëm, duhet të urdhërohet ndërprerja e tij.<sup>81</sup> Në procedurat e tilla, duhet të ofrohen garancat për procedurë gjyqësore dhe procedura duhet të jetë kontradiktore dhe duhet të sigurojë “barazinë e armëve (mjeteve)” për palët në procedurë, prokurorin dhe personin e paraburgosur.<sup>82</sup> Gjithashtu, duhet të jenë mjaft të sigurta, përndryshe kërkesat që kanë të bëjnë me qasjen dhe efikasitetin konsiderohen të papërbushura.<sup>83</sup> E drejta për kundërshtimin e paraburgimit para organit gjyqësor kompetent për urdhërimin e lirimimit nga paraburgimi, zbatohet edhe gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme (emergjencës publike).<sup>84</sup> Në lidhje me këtë, GjEDNJ ka theksuar se autoritetet nuk e kanë *carte blanche* në disponim duke u bazuar në 5 të KEDNJ, për të arrestuar të dyshuarit dhe për t'i paraburgosur, të liruar nga kontrolli efikas i gjykatave vendëse, sa herë që këto autoritete thirren se ekziston kërcënimi për sigurinë kombëtare.<sup>85</sup>

Edhe pse standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë<sup>86</sup>, mekanizmi i *habeas corpus*, i cili mbulon të gjitha paraburgimet e kryera nga autoritetet në Kosovë, ende

<sup>79</sup> Neni 9(4)KNDCP; parimi 31 i Parimeve themelore, neni 5(4) KEDNJ thotë; “Secili që është e privuar nga liria e tij nga arresti apo paraburgimi do të ketë të drejtë të marrë procedura nga të cilat ligjëshmëria e paraburgimit të tij do të vendoset shpejt nga një gjykatë dhe lirimimi i tij do të urdhërohet nëse paraburgimi është i paligjshëm.”

<sup>80</sup> KEDNJ qëndron se “secili që është i privuar nga liria e tij ka të drejtë në një mbikqyrje të ligjëshmërisë së paraburgimit të tij nga një gjykatë. Kërkesa e konventës që një akt i privimit të lirisë ti nënshtrohet mbikqyrjes së pavarur gjyqësore është e një rëndësie fundamentale në kontekstin e qëllimit të paraparë të nenit 5 të konventës që të ofrojë mjete brojtëse kundër arbitraritetit. Çfarë rëndësie ka është mbrojtja e e lirisë fizike e individëve dhe siguria e tyre personale”, lexo *Kurt vs Turqisë*, 25 maj 1998; *Vrbano vs Gullgarisë*, 5 tetor 2000. Shqyrtim i tillë duhet të mbahet “në kushtet procedurale dhe substanciale të cialt janë të cilat janë esenciale për ligjëshmërinë, në kuptim të Konventës, për privimin e lirisë së tyre. Kjo do të thotë që gjykata kompetente duhet të kontrolloj jo vetëm përputhshmërinë me me kërkesat procedurale por të caktuara në {ligjin vendës} por edhe arsyeshmërinë e dyshimit që bazon arrestin si dhe legjitimitetin e qëllimit të ndjekur nga arrestimi dhe paraburgimit të ndjekur”, lexo *Brogan dhe të tjerët vs Britanisë së Madhe.*, seanca plenare, 28 nëntor 1988; *Nikolova vs Bullgarisë*, Dhoma e Lartë, 25 mars 1999; *Chahal vs Britania Madhe.*, Dhoma e Lartë 15 nëntor 1996.

<sup>81</sup> Lexo *Baranowski vs Polonisë* 28 mars 2000; *Britania e Madhe vs Zvicrës*, 1 mars 2001; *Sabeur Ben Ali vs Malta*, 29 shtator 2000. KEDNJ ka konsideruar, për shembull, që një perudhë prej përafërsisht 8 javë nga dorëzimi i aplikacionit për vendim gjyqësor shfaqet vështirësia *prima facie* për pajtim me nocionin e “procedurës së shpejtë” (*E vs Norvegjia*, 29 gusht 1990).

<sup>82</sup> Lexo *Nikolova vs Bullgarisë* op. Cit.; *Sanchez-Reisse vs Zvicrës*, 21 tetor 1986; *Toth vs Austrisë*, 12 dhjetor 1991; *Kampanis vs Greqisë*, 13 korrik 1995.

<sup>83</sup> Lexo *Sakik dhe të tjerët vs Turqisë*, 26 nëntor 1997; *Sabeur Ben Ali vs Maltës*, op. Cit. Shënim Gjithashtu edhe KEDNJ ka për qëndrim që është detyrë e shtetit “që të organizojë sistemin gjyqësor në atë mënyrë që të mundësojë gjykatat e saj të përputhen me kërkesat e nenit 5(4), lexo *Britania e Madhe vs Zvicrës*, op.cit.; *R.M.D. vs Zvicrës*, 26 shtator 1997.

<sup>84</sup> *Brannigan dhe McBride vs. Britanisë së Madhe*, 26 maj 1993; *Chahal vs. Britanisë së Madhe*, op. Cit.; *Aksoz vs. Turqisë*, 18 dhjetor 1996; *Sakik dhe të tjerët*, op. Cit.; *Demir dhe të tjerët vs. Turqisë*, 23 shtator 1998; Për analiza të më tutjeshme, lexo raportin tretë në faqen 34&36.

<sup>85</sup> *Sakik dhe të tjerët*, op. cit.; *Demirdhe të tjerët v. Turqisë*, op. cit.; *Chahal v. M.B. op. cit.*; *Murray v. M.B.* 28 tetor 1994. Lexo, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohëshme, e aprovuar me 15 maj 2001, kapitulli 3, neni 3,3 thotë që “Dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në {të drejtat ndërkombëtare të njeriut} këto instrumente aplikohen drejtpërsëdrejti në Kosovë”.

<sup>86</sup> Lexo, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohëshme, e aprovuar me 15 maj 2001, kapitulli 3, neni 3,3 thotë që “Dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në {të drejtat ndërkombëtare të njeriut} këto instrumente aplikohen drejtpërsëdrejti në Kosovë”.



nuk është implementuar<sup>87</sup>. Përderisa sot, rastet e paraburgimeve të kundërligjshme nëpër qendrat UNMIK-ut për paraburgim, janë vetëm përjashtim, prap ndodhin, dhe për këto, duhet të ketë mjete juridike në disponim. Përkundër rënjes së numrit të rasteve të urdhërave për paraburgim nga PSSP dhe KFOR-i, faktit se kjo e drejtë e shfrytëzimit të pushtetit jashtëgjyqësor për paraburgim ende nuk është braktisur, vetvetiu paraqitet si shqetësim, veçanërisht duke pasur parasysh përmirësimin e konsideruar të gjendjes së sigurisë në Kosovë.<sup>88</sup>

### ***Paraburgimet e kundërligjshme në qendrat e paraburgimit të UNMIK-ut***

Pasojat serioze për shkak të mungesës së mekanizmit funksional të *habeas corpus*, janë bërë evidente në një rast të monitoruar nga OSBE në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në prill të vitit 2002, i cili kishte të bënte me një shqiptar të Kosovës, të akuzuar për vrasjen e një shtatasi të FRJ-së në Gjermani, dhe ishte paraburgosur për një periudhë kohore prej thujtë pesë muaj e gjysmë, në qendrat për paraburgim të UNMIK-ut, dhe pa kurrfarë vendimi apo urdhëri gjyqësor për mbajtjen e tij në paraburgim.

I akuzuari është arrestuar në Kosovë me 13 dhjetor 1997 nga autoritetet e RFJ-së, është paraburgosur dhe më vonë transferuar në Serbi. Gjykata e Qarkut në Nish, që vepronte si Gjykatë e Qarkut të Prishtinës vazhdimisht ia vazhdonte paraburgimin pasi që nuk kishte qasje në shkresat e lëndës (për shkak të bombardimeve të NATO-s). Me 25 mars 2002 gjykimi tij filloi në Serbi. Megjithatë ishte ndërprerë menjëherë, pasi që i akuzuari ishte njëri ndër 146 shqiptarët e Kosovës, të paraburgosur në Serbi që nga konflikti i vitit 1999, dhe ishte transferuar me 27 mars 2002 në njërin nga qendrat e paraburgimit në Kosovë, si rezultat i dokumentit të përbashkët në mes të UNMIK-ut dhe Jugosllavisë të datës 5 nëntor 2001.<sup>89</sup> Me 11 prill 2002, DD-së i kishte arritur një kërkesë nga Ministria Federale Gjermane e Drejtësisë për t'a pranuar bartjen e procedurës nga Gjermania, për zhvillimin e lëndës në të cilën i akuzuari ishte i pandehur. Ky rast ishte i njëjtë me atë për të cilin ai ishte paraburgosur dhe ndjekur penalisht në Serbi. Me 10 qershor, Gjykata Supreme e Serbisë, ia kishte siguruar DD-së një kopje të lëndës gjyqësore për të akuzuarin. Me 22 qershor, i akuzuari duke u mbështetur në nenin 6 të KEDNj-së, kishte protestuar kundër paraburgimit të tij i cili vazhdonte dhe kishte njoftuar drejtorin e qendrës së paraburgimit për vendimin e tij që të mbajë grevë urie.<sup>90</sup> Me 6 shtator, Gjykata e Qarkut në Prishtinë vazhdoi paraburgimin ndaj të akuzuarit për një muaj për shkak të rrezikut nga ikja dhe rrezikut të ndikimit në dëshmitë. Mbrojtësi i të akuzuarit parashtrroi ankesë kundër këtij vendimi, duke pohuar për shkelje të të drejtës së të akuzuarit për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme, me ç'rast ka kërkuar lirimin e tij të menjëhershëm. Me 3 tetor, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe konstatuar se mbajtja e të akuzuarit në paraburgim 27 marsit, deri me 9 shtator 2002, përbënte shkelje të ligjit vendës të procedurës penale, si dhe të nenit 5 të KEDNj dhe për këtë gjykata e shkallës së parë duhet konsiderojë mundësinë e kompenzimit për të akuzuarin për shkeljen e të drejtës së tij sipas 5 të KEDNj.

### ***Paraburgimet përmes urdhërit ekzekutiv të PSSP-së***

OSBE përhëndet faktin se që nga 19 dhjetori 2001, pushteti ekzekutiv i PSSP-së nuk është ushtruar në çështjet e paraburgimit. Megjithatë, OSBE nuk pajtohet me ruajtjen e këtij pushteti pasi që ky nuk ka mbështetje në ligj.

### ***Paraburgimet nga KFOR-i***

<sup>87</sup> Projekt-kodi i procedurës penale të Kosovës përmban një dispozitë *habeas corpus*

<sup>88</sup> Për analiza më të thellëshme për çështjet e paraburgimit, lexo raportin e dytë, faqe 24, raportin e tretë, faqe 16 dhe raportin e katërt, faqe 45

<sup>89</sup> Lidhur me këtë çështje dokumenti i përbashkët "konfirmon që të paraburgosurit shqiptarë nëpër burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Serbi për veprat që janë raportuar se i kanë kryer në Kosovë duhet, pas një shqyrtimi të rasteve të tyre sipas standardeve ndërkombëtare, duhet të transferohen në Kosovë dhe nën pushtetin e UNMIK-ut mbi sistemin e burgjeve sa më shpejtë që është e mundur."

<sup>90</sup> Në këtë fazë i akuzuari kishte kaluar 4 vite e shtatë muaj në burg pa kurrfarë urdhëri nga gjykata.

Në raportet e mëparshme, gjerësisht janë trajtuar aspektet e të drejtave të njeriut që ndërlidhen me autorizimet e KFOR-it për të paraburgosur njerëz jashtë procesit gjyqësor.<sup>91</sup> Në raportin e fundit, OSBE ka shprehur shqetësimet e veta për mungesën riraportit gjyqësorë të paraburgimeve të KFOR-it dhe nevojën për akuzim formal, por gjithashtu theksoi zhvillimet pozitive lidhur me rregullat e paraburgimeve nga KFOR-i. Ky shënim pozitiv konkretisht ndërlidhet me direktivën nr. 42<sup>92</sup> të KFOR-it e cila, në një rën të anë mëtonte rregullimin e procedurës së KFOR-it për çështjet e arrestimit dhe paraburgimit, ndërsa në anën tjetër, të garantimit të të drejtave themelore për personat e paraburgosur. Sidoqoftë, OSBE vazhdimisht ka mbajtur qëndrimin se, nën rrethanat ekzistuese në Kosovë, paraburgimet nga KFOR-i janë jologjore dhe të pajustificueshme; më nuk ekziston gjendja e emergjencës në Kosovë dhe gjatë 4 vitesh është bërë një përparim i madh në rihvillimin e sistemit gjyqësor penal. Incidentet penale të cilat ishin më parë shqetësim ushtarak, me to tani kanë të bëjnë, në mënyrë të kënaqshme, procedurat penale, e jo ushtarake, në gjykata.

OSBE përshëndetë rënjen e numrit të përgjithshëm të personave që mbahen nga KFOR-i në kampin amerikan Bondsteel (QPB) gjatë periudhës së raportimit. Kjo rënje, pranohet të jetë kryesisht si rezultat i përfundimit të konfliktit në IRJM dhe në Serbi Jugore, që ka bërë, që një numër i madh i të paraburgosurve të mbahen nga KFOR-i gjatë verës së vitit 2001<sup>93</sup>.

Megjithatë një numër arrestimesh të kryera KFOR-i gjatë gushtit dhe shtatorit 2002, dhe përsëri gjatë marsit 2003, janë për t'u shqetësuar. OSBE ka vërejtur se disa nga këto paraburgime jo vetëm që shkelin të drejtat ndërkombëtare të njeriut, por gjithashtu nuk përfillin garancat e përcaktuara në direktivën nr. 42 të KFOR-it. OSBE ishte veçanërisht e shqetësuar për trajtimin e shtetasve algjerian, tre prej të cilëve ishin në paraburgim për më tepër se 30 ditë:

Gjatë intervistave të cilat i ka zhvilluar OSBE-ja me të paraburgosurit algjerian, ishin ankuar se edhe pas disa kërkesave të parashtruara, e drejta e tyre për t'u konsultuar me avokatin iu është mohuar. Nëse ky ishte rasti, mohimi i të drejtës në avokat, mund të kishte shkelje të direktivës nr. 42 të KFOR-it,<sup>94</sup> e cila parashikon që të paraburgosurit të mbajtur nën autoritetin e KFOR-it, "*kanë të drejtën e qasjes në këshilltar apo përfaqësues ligjor nën shpenzime të veta*"<sup>95</sup>. Më tej, ata janë mbajtur pa pasur të drejtë në një rishqyrtim gjyqësor dhe, sipas të paraburgosurve, pa sqarime të hollësishme mbi bazat për paraburgimin e tyre.<sup>96</sup> Në të vërtetë, OSBE ishte informuar se marrja në pyetje e të tyre shumë pak kishte të bënte çështjet e sigurisë në Kosovë, dhe më shumë ndërlidhej me lidhjet e tyre të mundshme me aktivistët islamik në Bosnje dhe Hercegovinë, Algjeri apo rrjetin terrorist Al-Qaeda. Siq shihet, kjo mund të jetë në kundërshtim me direktivën nr.42 të KFOR-it e cila thekson "*fakti që një person mund të ketë informata me vlerë për inteligjencën vet-vetiu nuk është bazë për paraburgim*".<sup>97</sup>

Tani, kohëve të fundit, me 4 prill 2003, OSBE kishte zhvilluar një intervistë me katër të paraburgosur. Sipas fletëparaqitjes penale kundër tyre, të gjithë këta, ishin paraburgosur si të dyshuar për rrezikimin e sigurisë së regjionit (në bazë të Rezolutës 1244). Në të gjitha rastet, komandanti i forcës së Kosovës të

<sup>91</sup> Lexo raportin e tretë/katërt, në faqen 37 respektivisht 46.

<sup>92</sup> KOMKFOR direktiva 42 për paraburgimet (tashe tutje direktiva 42 e KFOR-it), e datës 9 tetor 2001, e cila zëvendësoi një direktivë të klasifikuar të paraburgimit të njohur si FRAGO 997.

<sup>93</sup> Nganjëherë gati edhe nga 200 persona.

<sup>94</sup> Sekcioni 7(1) i Direktivës së KFOR-it 42

<sup>95</sup> Neni 7(1) i direktivës 42 të KFOR-it

<sup>96</sup> Vlerësimi se të paraburgosurit nuk kanë pasur ndonjë shpjegim të qartë për bazat e paraburgimit të tyre dhe se u është refuzuar qasja tek avokati mbrojtës është bazuar vetëm në deklaratat e të paraburgosurve në lidhje me rastin, për shkak të mungesës së mënyrave tjera me të cilat OSBE mund të vlerësojë se a ka pasur pajtueshmëri me të drejtat e të paraburgosurve. Një procedurë e cila do të regjistroj detajet e të drejtave të të ofruara të paraburgosurve dhe të nënshkruara nga ata, si provë e këtij fakti, do të ishte shumë e mirëseardhur në këtë drejtim.

<sup>97</sup> Sekcioni 4(b)I Direktivës së KFOR-it 42.

udhëhequr nga NATO (COMKFOR), kishte autorizuar paraburgimin për tridhjetë ditë tjera. Tre nga të paraburgosurit, kishin deklaruar se ata ishin njoftuar se janë burgosur nën dyshimin e angazhimit të tyre në aktivitetet e Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH). Kurse njëri nga ta, ka theksuar se nuk ka qenë i njoftuar mbi arsyet konkrete të paraburgimit të tij. Ndonëse KFOR-i kishte vepruar sipas procedurës së vet interne, OSBE është e mendimit se vet paraburgimi ishte i paarsyeshëm dhe i kundërligjshëm.

OSBE rikujton se, edhe pse procedurat e parapara në direktivën 42 të KFOR-it përfaqësojnë një hap përpara në ofrimin e një kornize për urdhërimin, raportin, dhe ndërprerjen e paraburgimit, këto procedura nuk i bëjnë të ligjshme paraburgimet e KFOR-it. Për këtë OSBE rithekson rekomandimet e veta ndaj KFOR-it, që ky i fundit të ndërprejë paraburgimet dhe me këtë, zyrtarisht ta braktisë autorizimin e vet në këtë lëmi.

Deri sot 3563 persona ishin të paraburgosur në QPB(Bondsteel).

### ***Paraburgimi i personave me sëmundje mentale***

Një lëmi tjetër në të cilën përparimi ka qenë zhgënjyes, është paraburgimi i personave të sëmurë mental. OSBE në mënyrë këmbëngulëse ka theksuar në raportet e saj të sistemit gjyqësor, se numri më i madh i personave të paraburgosur në mënyrë të kundërligjshme në Kosovë ndodhë përbrenda sistemit shëndetësor mental.<sup>98</sup> Sipas instrumenteve ndërkombëtare dhe praktikës së GjEDNJ, personat e paraburgosur për shkaqe të shëndetit mental duhet të paraburgosen si zgjidhje e fundit, dhe kur trajtimi është i mundshëm.<sup>99</sup>

Që nga raporti i fundit i OSBE-së, është arritur përparimi në kalimin prej sistemit të bazuar në shëndetin mental të institucionalizuar në sistem të bazuar në komunitet. Ministria e Shëndetësisë, me ndihmën e

---

<sup>98</sup>Lexo raportin e katërt, pjesa 5, faqet 52-62 dhe raportin e tretë, pjesa 4, faqet 41-42

<sup>99</sup>Lexo parimet e KB për mbrojtjen e personave me sëmundje mentale dhe përmirësimin e kujdesit të shëndetit mental, Parimet 16; Winterwerp vs. Holanda, GJEDNJ, 24 tetor 1979.

Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) ka hapur Qendrat e shëndetit mental të bazuara në komunitet<sup>100</sup> për pacientët e jashtëm dhe në tri lokacione kanë filluar të themelohen apartamentet e mbrojtura të bazuara në komunitet (AMBK).<sup>101</sup> Krahas kësaj, në përgjithësi, spitalet dhe departamentet neuropsikiatrike janë ndarë në repartin neurologjik dhe atë psikiatrik.<sup>102</sup>

Përkundër pikëpyetjeve përkitazi me statusin ligjor të personave që tani transferohen në apartamentet e mbrojtura, numri më i madh i personave të paraburgosur në mënyrë të kundërligjshme në Kosovë, mbetet në institutet sociale: në institucionin special të Shtimes/Stimlje për personat e retarduar (në tekstin e mëtejme: Institucioni i Shtimes/Stimlje) dhe në Qendrën e Klinikës Universitare (QKU) në Prishtinë/Pristina.<sup>103</sup> Sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS) e cila është përgjegjëse për Institutin e Shtimjes/Stimlje, OSBE është informuar se që nga 14 marsi 2002, ishin 222 banorë në atë institucion, nga të cilët 111 mashkuj dhe 111 femra. Shumica e banorëve ishin me origjinë jashtë territorit të Kosovës.<sup>104</sup>

Raportet e mëparshme të OSBE gjithashtu kanë përmendur ngurrimin e gjykatave për të adresuar këto çështje. OSBE ka konkluduar se kjo rrjedhë nga mungesa e ligjit të qartë të aplikueshëm, nga mungesa e përvojës së gjykatësve për të vepruar me çështjet e shëndetit mental,<sup>105</sup> si dhe për shkak të ngurrimit të gjykatave që në mënyrë të drejtëpërdrejtë të përdorin dispozitat themelore për të drejtat e njeriut të cilat potencojnë se çdo person i paraburgosur ka të drejtë që rasti i tij/saj të shqyrtohet nga gjykata që është kompetente edhe për urdhërimin e lirimit të tij/saj.<sup>106</sup> Në raportin e saj të fundit OSBE kishte përmbledhur shqetësimet e saj përkitazi me personat me paafësi mentale dhe sistemit gjyqësor – në tre aspekte kryesore: përdorimin e paraburgimit; trajtimin e të burgosurve të ligjshëm dhe përdorimin e ekspertizës së shëndetit mental brenda sistemit të së drejtës penale.

### *Paraburgimi*

Sa i përket paraburgimit të personave me sëmundje mentale, OSBE ka rekomanduar miratimin e draftit të “*Rregullores mbi heqjen e lirisë dhe mbi trajtimin e dhunshëm të personave me sëmundje mentale*”.<sup>107</sup> Në mars 2002, ZKL e informoi OSBE se ky draft do të ketë prioritet. Më 5 shtator 2002, nga aspekti i urgjencës dhe situatës specifike në institucionin e Shtimes/Stimlje, ZKL ia paraqiti grupit punues dy projekt ligje: *Projekt ligjin mbi raportin e personave të mbajtur në Institutin special për të retarduarit mental në Shtime/Stimlje* (Ligji i Shtimes/Stimlje) dhe *Projekt ligjin mbi mbrojtjen e personave që vuajnë nga çrregullimet mentale* (në tekstin e mëtejme Ligji i përgjithshëm për shëndetin mental).

<sup>100</sup> Gjashtë (6) qendra të bazuara në komunitet të shëndetit mental janë hapur në Gjakovë/Djakovica, Ferizaj/Uroševac, Mitrovicë, Prizren, Pejë/Pec dhe Gjilan/Gnjilane, dhe një pritet të hapet në Prishtinë.

<sup>101</sup> Dy AMBK janë hapur në Gjakovë/Djakovica dhe Gjilan/Gnjilane, përderisa ndërtimet janë në punë e sipër në Prizren.

<sup>102</sup> Ndonëse është bërë ndarja fizike dhe organizative, duhet të tejkalohen vështirësitë ligjore dhe administrative.

<sup>103</sup> Lexo raportin e katërt, pjesën 5, faqet 52-55 për detaje të mëtejme.

<sup>104</sup> Këto numra janë ofruar në mbledhjet që OSBE ka pasur më 14 mars dhe 16 prill me MPMS, zyrtarët e institutit të Shtimjes/Stimlje dhe OBSh. Sipas informatave që OSBE mblodhi në këto mbledhje, në pajtim me marrëveshjen e arritur në mes të MPMS dhe Ministrisë për Shëndetësi (MSH) 4 banorë ishin dërguar në AMBK në Gjakovë/Djakovica, dy banorë ishin dërguar në AMBK në Gjilan/Gnjilane (AMBK janë projekt i përbashkët i MSH dhe OBSh) dhe dy banorë ishin dërguar në Serbi.

<sup>105</sup> Nuk ka gjykatës e as avokatë të specializuar për shëndetin mental në Kosovë, përkundër numrit të madhë të personave me probleme të shëndetit mental, dhe siç duket ligjet ishin përdorë rrallë nëse jo fare, në të kaluarën.

<sup>106</sup> Neni 5(4) KEDNJ, neni 9 KNDKP.

<sup>107</sup> Rregullorja ishte përpiluar nga Grupi punues i reformës ligjore të shëndetit mental (Grupi punues), i themeluar në prill 2000 dhe kishte në përbërje përfaqësuesit e DD, OSBE, OBSh, Odës së Avokatëve, profesionist psikiatrik të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe MPMS.

OSBE përshëndet themelimin, në shtator 2002, të *Forcave detyruese për implementimin e rregullave të shëndetit mental dhe paaftësisë mentale* (Forcat detyruese),<sup>108</sup> të cilat bashkojnë të gjithë aktorët relevant. Megjithatë OSBE konsideron se promulgimi i draft ligjeve është hapi i parë i domosdoshëm drejt rregullimit e paraburgimeve përkitazi me shëndetin mental. Si plotësim, OSBE konsideron se këto ligje, pasi të promulgohen, do të inkurajojnë zhvillimin e aktiviteteve të nevojshme nga të gjitha palët drejt implementimit efektiv të sistemit të pajtueshëm me të drejtat e njeriut.<sup>109</sup>

### *Përdorimi i “masave të sigurisë” brenda sistemit gjyqësor*

Që nga prilli 2003, 19 persona janë paraburgosur në sistemin e rregullt të burgjeve, në bazat e “masave të sigurisë”. Raporti i mëparshëm i OSBE theksonte problemet e shkaktuara nga përdorimi i “masave të sigurisë” nga sistemi penal gjyqësor, përmes urdhërimit të paraburgimit të personave për trajtim.<sup>110</sup> OSBE rekomandoi që përdorimi i “masave të sigurimit” të ndërpritet dhe të aprovohet Projekt-rregullorja (tani Projekti i ligjit të përgjithshëm mental) dhe Projekti i Ligjit të përkohshëm penal dhe Ligjit të përkohshëm të procedurës penale. Këto ligje të reja do të zgjidhin problemin duke hequr të drejtën e gjykatave penale për të urdhëruar paraburgimin për qëllim të trajtimit (shërimit të detyruar) (jo qëllime penale) dhe duke i bartur këto kompetenca në Kolegjet për Shëndetin Mental, nën jurisdikcionin civil.

### *Trajtimi i të burgosurve me nevoja të shëndetit mental*

Një shqetësim i veçantë i shtruar në raportet e mëparshme ndarazi nga ato të paraburgimeve dhe/ose shërimit të detyrueshëm, është trajtimi i të burgosurve në mënyrë të ligjshme nga sistemi gjyqësor penal, të cilët kanë nevojë për trajtim të shëndetit mental. Autoritetet e burgjeve dhe ato shëndetësore janë nën obligimin për të siguruar që të burgosurit e tillë të pranojnë nivelin më të lartë të mundshëm të kujdesit shëndetësor.<sup>111</sup> Për personat e sëmurë rëndë, kjo duhet të bëhet ose në një mjedis terapeutik të spitalit apo të një objekti të specializuar me kushte adekuate të sigurisë, apo në një njësit të pajisur tërësisht dhe me personel, përbrenda sistemit të burgut.<sup>112</sup> OSBE rekomandoi që të gjithë të burgosurit duhet të jenë të informuar për të drejtat e tyre për të shkuar në gjykatë për të kërkuar trajtimin adekuat. Asnjëri nuk duhet t’i mohohet trajtimi i domosdoshëm mbi arsyet e sigurisë. OSBE gjithashtu rekomandoi që Ministria e Shëndetësisë dhe Divizioni i administrimit të burgjeve të DD, duhet të pajtohen mbi një dokument të gjërësishëm për nevojat për kujdesin shëndetësor në burgje dhe siguri të duhur për të burgosurit në spitale

<sup>108</sup> Forcat detyruese ishin themeluar në shtator 2002 dhe përbëheshin prej përfaqësuesve nga DD, MPMS, Ministrisë së shëndetësisë Zyres së ZvPSP- Administrata Civile, Zyres së Kryeministrit, dhe Drejtorit për autoritetin shëndetësor regional të Prishtinës/Pristina. Këshilltarët teknik të Forcave detyruese janë OSBE, OBSH, dhe Komisioneri i lartë për të drejtat e njeriut të KB. Qëllimi i Forcave detyruese është që të koordinojnë, lehtësojnë dhe monitorojnë implementimin e vendimeve përkitazi me rregullat, mbi paaftësinë mentale dhe shëndetin mental në Kosovë.

<sup>109</sup> OSBE ka në dijeni se resurset e nevojshme, kapacitetet dhe lehtësirat nuk ekzistojnë ende për të implementuar këto draft ligje. Sidoqoftë OSBE konsideron se ekzistimi i ligjeve do të nxisë aktivitetet e domosdoshme për implementimin e tyre.

<sup>110</sup> OSBE vëren se shumica e urdhërave për “masa të sigurisë” është bërë ose kur prokuroria ka hjekur dorë, apo kur personi nuk ishte gjetur penalisht përgjegjës. Në të dy rastet, gjykata është në efekt të urdhërimit të paraburgimit për trajtim psikiatrik, e cila është një lëmi ku gjykatat nuk kanë ekspertizë. Personat e tillë kanë nevojë për trajtim në spitale e jo në qendra paraburgimi.

<sup>111</sup> Lexo parimet 24 të Parimeve themelore të KB mbi mbrojtjen e të gjithë personave nën çdo formë të paraburgimit apo burgimit.

<sup>112</sup> Lexo Standardet minimale të KB të rregullave për trajtimin e të burgosurve, neni 22(2).

(duke pranuar që spitalet janë mjedise terapeutike, dhe nevojat për të pasur kontroll mbi objektet e tyre dhe kujdesin).

OSBE përshëndet Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) i cili është arritur në mes të DD dhe autoriteteve përkatëse shëndetësore të qarkut, që siguron që të burgosurit të pranojnë vizita nga psikiatrat.<sup>113</sup>

Raporti i fundit i OSBE shprehu shqetësim të thellë përkitazi me uzurpimin efektiv nga policia e UNMIK-ut të dy dhomave në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës, dega e psikiatrisë, për t'u shfrytëzuar nga "të burgosurit". OSBE rekomandoi që këto dy dhoma të sigurohen në spital, duhet menjëherë të hapen dhe që policët e uniformuar të largohen nga aty. Për më tepër, OSBE rekomandoi që të adoptohet një kornizë pune e qartë dhe operacionale ligjore që lejon që me këto raste të personave me sëmundje mentale të punohet në mënyrë të duhur brenda sistemit penal dhe korrektues.<sup>114</sup> Më 17 prill 2003 OSBE vizitoi Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë/Pristina, degën e psikiatrisë dhe vërejti se deri tani kjo situatë nuk ka ndryshuar.

### *Ekspertizat e shëndetit mental brenda sistemit të gjyqësisë penale*

Lëmia e fundit e madhe shqetësimeve të OSBE-së e shtruar në raportin e fundit është përdorimi i dobët i ekspertizave psikiatrike në rastet penale.<sup>115</sup> OSBE rekomandoi se nevojitet trajnim urgjent i më shumë psikiatrive, përkitazi me provat forenzike dhe se duhet të krijohet Njësi psikiatrik forenzik, i cili është i aftë të ofroj ekspertizë mjekësore dhe trajtim për të burgosurit brenda sistemit gjyqësor penal. OSBE vëren se deri më sot nuk është arritur asnjë përparim.

Për shkaqet e përmendura më lart OSBE përsërit rekomandimet e veta në relacion me paraburgimin e të sëmurëve mental;

### *Ligjet*

- Duhet të hyjnë në fuqi, atë si çështje prioritare Projekt Ligji mbi mbrojtjen e personave që vuajnë nga sëmundjet mentale dhe Projekt ligji mbi raportin e personave të mbajtur në Institucionin special të Shtimes/Stimlje. Kjo do të vendosë baza të qarta ligjore për paraburgim dhe trajtim të dhunshëm nga të gjitha autoritetet, një procedurë funksionale për shqyrtim gjyqësor dhe periudha të kufizuara paraburgimi në mes të shqyrtimeve.

<sup>113</sup> Një MM është nënshkruar nga DMP dhe autoriteteve shëndetësore të qarkut në Pejë/Pec dhe Prishtinë/Pristina për të mbuluar objektet e DMP në Pejë/Pec, Dubravë/Dubrava Prishtinë/Pristina, dhe Lipjan/Lipljane. Një MM tjetër është në negociatë e sipër në mes të DMP dhe zyrtarëve shëndetësor të qarkut në Prizren.

Si plotësim Burgu i Lipjanit/Ljipljane është dizajnuar për kujdesin e të burgosurve që kërkojnë kujdesin shëndetësor mental dhe trajtim, i cili nuk mund të ofrohet në objekte tjera. Resurse të theksueshme janë investuar për këtë qëllim. Një bllok i tërë në Burgun në Lipjan/Ljipljane është renovuar dhe është plotësisht funksional për të ofruar kujdes dhe trajtim për të burgosurit të sëmurë mental. Burgu i Lipjanit/Ljipljane ka tani për tani të punësuar një (1) psikiatër ndërkombëtar, një (1) psikiatër vendor, dy (2) motra psikiatrike ndërkombëtare, gjashtë (6) motra vendore, një (1) punëtor social dhe një (1) teknik medicinal. Oficerët korrektues të përcaktuar për at bllok gjithashtu janë duke u trajnuar nga psikiatrat dhe motrat në lidhje me kujdesin ndaj të burgosurve të sëmurë mentalisht.

<sup>114</sup> Lexo raportin e katërt, pjesa 5, faqe 56 për më tepër detaje.

<sup>115</sup> Raporti i katërt vuri në pah nevojën për ekspertizën psikiatrike në (1) vlerësimin e shkallës së përgjegjshmërisë penale të personit në kohën e kryerjes së krimit të raportuar; (2) përcaktimin e mundësisë së personit për të pasur një gjykim të drejtë; (3) se a është personi në nevojë për trajtim të obliguar psikiatrik. Raporti i katërt gjithashtu vërejti disponueshmërinë shumë të kufizuar për ekspertizën forenzike psikiatrike dhe se raportet vlerësuese psikiatrike në përgjithësi konsistojnë nga disa rreshta të thjeshtë të cilat nuk mund të sfidohen nga mbrojtja apo gjykata.

- Ligji i përkohshëm penal dhe Ligji i përkohshëm i procedurës penale gjithashtu menjëherë duhet të hyjnë në fuqi<sup>116</sup>, në kuptimin se këto ligje sigurojnë largimin e “masave të sigurisë”, për procedura të qarta për vlerësimin e zotësisë së personit për të qëndruar në gjykim apo shkallën e përgjegjësisë mentale, si dhe për mjetet juridike kur provat janë të vonshme apo joadekuate.

### *Paraburgimi*

- Gjykatat do të shqyrtojnë menjëherë ligjshmërinë e paraburgimit të pacientëve. Dështimi për të bërë një gjë të tillë duhet të rezultojë në ankesë pranë NJIGJ.
- Çdo spital që don të mbajë personat kundër dëshirës së tyre apo detyrimisht t’i trajtojë, duhet të paraqesin rastin tek gjykata kompetente për vendim.
- Personeli mjekësor dhe profesionistët ligjor duhet të ndërmarrin një sërë seancash të kombinuara trajnuese (IGJK u pajtua për të ofruar trajnim pas hyrjes në fuqi të ligjeve) në lidhje me ligjin mbi çështjet e shëndetit mental.
- Në QKU të Prishtinës/Pristina, dhe në spitalet tjera regjionale, duhet menjëherë të krijohet një repart i sigurtë psikiatrik dhe akut, me personel dhe specialista të trajnuar.
- Duhet të ndërpritet përdorimi i “masave të sigurisë” nga gjykatat penale.

### *Trajtimi i të burgosurve*

- Të gjithë të burgosurit duhet të informohen për të drejtat e tyre që të shkojnë në gjykatë që të urdhërohet trajtimi i duhur.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Divizioni i administrimit të burgjeve të DD duhet të pajtohen mbi një dokument gjithpërfshirës mbi nevojat për kujdesin shëndetësor nëpër burgje dhe siguri të duhur për të burgosurit nëpër spitale, për ato raste ku trajtimi adekuat nuk mund të ofrohet në sistemin e burgut (duke pranuar që spitalet janë mjedise terapeutike, dhe duhet të kenë kontroll mbi objektet e tyre dhe kujdesin).
- Dy dhoma të sigurisë në spital duhet menjëherë të hapen dhe policët e uniformuar dhe të armatosur të largohen nga aty. Për më tepër, kjo masë duhet menjëherë të përcillet nga një kornizë pune e qartë dhe operacionale ligjore që lejon që me këto raste të personave me sëmundje mentale të punohet në mënyrë të duhur brenda sistemit penal dhe korrektues.

### *Provat e ekspertëve*

- Urgjentisht nevojitet trajnimi i më shumë psikiatrive në lidhje me provat forenzike.
- Duhet të krijohet Njësi forenzik psikiatrik, i cili do të jetë i aftë për të ofruar ekspertizë mjekësore dhe trajtim për të burgosurit brenda sistemit penal gjyqësor. Këto dy role duhet të jenë qartë të ndara. Personat të cilët nuk janë brenda sistemit gjyqësor penal (përfshirë ata që nuk janë gjetur përgjegjës) nuk duhet të mbahen në burg.

<sup>116</sup> Lexo faqen 53 të këtij raporti për statusin e tanishëm të ligjeve.





## C: Kriminaliteti në lidhje me trafikim dhe përgjegjia e UNMIK-ut

### Çështjet

- Kushtet për përkthim dhe interpretim në gjykata, në rastet e trafikimit vazhdojnë të jenë jo-adekuate;
- Gjykatësit vazhdojnë të pranojnë dëshmi në rastet e trafikimit në rrethana kur ata nuk marrin parasysh garancat procedurale të menduara për të mbrojtur të pandehurit e raportuar gjatë hetimeve dhe gjatë gjyqimit;
- Sanksionimi në rastet e trafikimit: Gjykatat dështojnë të shqiptojnë denime, të cilat përputhen me dispozitat minimale statutores për denim.

### Hyrje

Trafikimi me njerëz, në veçanti me gra dhe vajza vazhdon të jetë një fenomen i vazhdueshëm në Kosovë. Një grup masash të dedikuara për luftimin e trafikimit janë implementuar, duke u radhitur prej reformave legjislative, deri te iniciativat që kanë për qëllim dhënjen e ndihmes dhe mbrojtjen e dëshmitarëve për rastet e trafikimit dhe këto janë:

- Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, që ka hyrë në fuqi me 12 janar 2001 dhe parashikon ndjekjen dhe denimin e kryesve të krimit të trafikimit me njerëz dhe parashikon dhënjen e ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat e trafikimit.
- Në tetor të vitit 2000, është themeluar njësi special “Njësi për hetimet e trafikimit dhe prostitucionit” (NjHTP), për të hetuar krimet lidhur me trafikimin dhe prostitucionin;
- Masat për mbrojtjen e dëshmitarëve kanë hyrë në fuqi përmes shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut 2001/20<sup>117</sup> mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurat penale dhe atë përmes themelimit të Njesitit për mbrojtjen e dëshmitarëve (NjMD);<sup>118</sup>
- Njesiti për mbrojtje dhe ndihmë është krijuar nën ombrellën e DD dhe ka për mandat që të ofrojë forma të ndryshme të ndihmës për viktimat e trafikimit.<sup>119</sup>

Gjersa këto masa paraqesin një zhvillim pozitiv në këtë lëmi, çështjet e theksuara më lartë ende japin arsye për shqetësim. Disa nga këto çështje janë theksuar në raportet e mëparshme<sup>120</sup> të OSBE-së, por përparimi në adresimin e tyre ka qenë i ngadalshëm.

<sup>117</sup> E hyrë në fuqi me 19 shtator 2001.

<sup>118</sup> Duhe të cekët që gjithashtu edhe Direktiva administrative 2002/25, e cila implementon Rregullorën 2001/20, ka hyrë në fuqi në qershor 2001.

<sup>119</sup> NjNBV është krijuar në janar 2002 që të sigurojë një shërbim të përkrahjes së ko-ordinuar dhe të gjithëanëshme për të gjitha viktimat e krimit, përfshirë këtu edhe viktimat e trafikimit.

<sup>120</sup> Raporti i dytë, faqe 55, raporti i tretë, faqe 47; raporti i katërt faqe 17.

## ***Dështimi i autoriteteve të UNMIK-ut që të ofrojnë kushte për strehimin e dëshmitarëve për të garantuar mbrojtjen e tyre fizike.***

Kësaj çështje i është dhënë konsideratë e hollësishme në seksionin që ka të bëjë me mbrojtjen e dëshmitarëve.

## ***Dështimi për të ofruar kushte adekuate për përkthim/interpretim në gjykata për të akuzuarit dhe dëshmitarët***

Deri sot, njëri ndër problemet kryesor në rastet e trafikimit ka qenë dështimi i gjykatave që të ofrojnë kushte adekuate për përkthim, për të dyshimtit/akuzuarit dhe dëshmitarët.<sup>121</sup> Deri më tash, sa u përket të dyshuarve/akuzuarve, e drejta për t'u informuar në një gjuhë që e kupton ai/ajo për natyrën e akuzave kundër tij/saj<sup>122</sup> dhe e drejta që t'i sigurohet një përkthyes gjatë procedurës gjyqësore kur ai/ajo nuk mund t'a kuptoj apo flet gjuhën e përdorur në gjykatë, parashikohen sikur në ligjin vendës në fuqi, poashtu edhe me ligjin ndërkombëtar.<sup>123</sup> Për më tepër, ligji vendës parashikon gjithashtu të drejtën e dëshmitarëve në përdorimin e gjuhës së tyre gjatë procedurës gjyqësore dhe të drejtën e tyre, në rastet e trafikimit, që t'ju ofrohet shërbimi, pa pagesë, i përkthimit në gjuhën të cilën ata e zgjedhin.<sup>124</sup> Shkeljet e dispozitave të lartpërmendura janë vërejtur nga OSBE si të vazhdueshme në tërë Kosovën, me gjithë faktin se këto janë theksuar në raportet e mëparshme të OSBE-së.<sup>125</sup>

Me 5 shkurt 2003 një femër bullgare dhe një shqiptar i Kosovës, nga Gjykata e Qarkut në Pejë/Pec, janë denuar me një vjet, respektivisht, një vjet e gjysmë heqje lirie me kusht. Të akuzuarës nga Bullgaria i është privuar e drejta për t'u informuar menjëherë për natyrën e akuzës që i vihej në barrë, kur i është dorëzuar aktakuza në gjuhën shqipe edhe pse nuk e ka kuptuar apo folur gjuhën shqipe.<sup>126</sup> Ndërsa duke u bazuar në mendimin e gjykatësit se e akuzuara kupton nga pak serbisht, asaj i është mundësuar shërbimi për përkthim në gjuhën serbe në gjykatë (nuk ka patur përkthyes bullgar gjatë tërë gjykimit). Mirëpo, kur më

<sup>121</sup> Lexo raportin e katërt, faqe 20.

<sup>122</sup> LPP RFJ neni 4 ofron që i pandehuri qyshë në marrjen e parë në pyetje duhet të jetë i njoftuar mbi veprën për të cilën ngarkohet dhe mbi bazat e akuzës. Rregullorja e UNMIK 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet e zbatimit të ligjit thotë që personi i arrestuar ka drejtë të informohet për arsyet e arrestimit të tij/saj në gjuhën ai/ajo kupton. Për më tepër, neni 6(3)(a) i KEDNj dhe neni 14(3)(a) i KNDCP të dyjat ofrojnë që secili i ngarkuar me vepër penale do të ketë të drejtë që menjëherë të informohet në gjuhë që e kupton për natyrën dhe qëllimin e veprës me të cilën ngarkohet. Lexo gjithashtu vendimin e GjEDNj në rastin *Brozicek vs Italisë*, 19 dhjetor, 1989.

<sup>123</sup> LPP RFJ neni 7(2) thotë që të dyshimtit apo të akuzuarit kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre gjatë hetimeve apo gjatë gjykimit; atëherë kur procedura është duke u zhvilluar në një gjuhë që personi nuk kupton do të bëhet e mundur për përkthim gojor të dëshmive dhe dokumenteve. Si shtesë, gjithashtu edhe neni 6(3)(e) i KNDNj dhe neni 14(3)(f) i KNDCP ofrojnë për ndihmë falas në përkthyes nëse i dyshimti apo i akuzuari nuk mundet të kuptojë apo të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë. Për më tepër GjEDNj në rastin e *Kamasinski vs. Austrisë*, 19 dhjetor 1989 mbajti qëndrimin, që në shiqim të të nevojës për të drejtat e garantuara nga neni 6(3) të jenë praktike dhe efektive, rrethanat e caktuara, mund të zgjerohen deri në një shkallë të kontrollit të pausëshëm mbi përshtatëshmërinë e përkthimit të ofruar, lexo, gjithashtu vendimin e GjEDNj në rastin e *Luedicke, Belkacem dhe Koc vs. Gjermanisë*, 28 nëntor, 1978. Për më tepër Komiteti për të drejtat e njeriut ka shprehur në komentin e përgjithshëm 13, alinea 13, (të aprovuar nga Komiteti për të drejtat e njeriut nën nenin 40, alinea 4 të KNDCP) që e drejta për të përkthyes është pjesë përbërëse e të drejtës për tu mbrojtur vetën dhe e së drejtës për kohë të kushte adekuate për të përgatitur mbrojtjen.

<sup>124</sup> Lexo neni 7(2) i LPP RFJ i cili përshkruan që dëshmitarët kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre përgjatë procedurës hetimore dhe gjytë gjykimit; kur procedura nuk zhvillohet në gjuhën që ai person e kupton, kushtet do të mundësohen për përkthim oral të dëshmive dhe dokumenteve dhe lexo nenin 10.1(a) të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/4.

<sup>125</sup> Lexo, raporti i parë, faqe 21; raporti i tretë, faqe 66.

<sup>126</sup> Sipas avokatit mbrojtës, ka qenë deri në ditën e gjykimit (kur aktakuza i është lexuar asaj në gjuhën derbe) që e akuzuara është informuar për natyrën e akuzës kundër saj në një gjuhë që ajo e kupton.

pas, u bë e qartë se gjatë dëshmisë së saj ajo nuk mund të komunikonte si duhet në gjuhë serbe, gjykatësi nuk e shtyri seancën për të kërkuar shërbimet e përkthyesit bullgar.<sup>127</sup>

Në një rast në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në maj 2002, që kishte të bëjë me një femër rumune të akuzuar për trafikim, e akuzuara ka ditur të flasë shumë pakë gjuhën angleze apo shqipe, por gjykata nuk e siguroi përkthyesin rumun. Asaj i'u siguroa një përkthyes për gjuhën angleze/shqipe për dëshminë e saj (por jo edhe për leximin e aktakuzës) por gjatë procedurës, kryetari i trupit gjykues, thjeshtë diktonte dëshmi të ndryshme për futjen e tyre në procesverbal dhe nuk është siguruar përkthimi i procesit gjyqësor. Kjo mënyrë e ka privuar të akuzuarën nga e drejta e saj për t'u njoftuar mbi natyrën e akuzave që i viheshin në barrë, dhe nga e drejta për t'u gjykuar në gjuhën të cilën ajo e kupton.

Këto shkelje vazhdojnë të ndohdhen, pamarrë parasyshë faktin se DD e ka themeluar një grup përkthyesish të cilët janë në dispozicion për të marrur pjesë në procedurat gjyqësore në tërë Kosovën dhe të ofrojnë shërbime përkthimi në gjuhën shqipe, serbe, rumune dhe ruse, simbas kërkesës.<sup>128</sup> Siç duket, gjykatësit ose nuk janë të njoftuar për këtë mundësi të shërbimit të përkthimit ose nuk kërkojnë këtë shërbim kur shfaqet nevoja.

### ***Pranimi i dëshmimeve në rastet e trafikimit në rrethana kur shkelen garnecat procedurale që kanë për qëllim mbrojtjen e kryesve të supozuar.***

Në raportet e mëparshme OSBE ka shfaqur brengën në lidhje me gjykatësit, prokurorët dhe avokatët mbrojtës që nuk merrnin parasysh procedurat e dedikuara për të siguruar garancat për gjykim korrekt për të dyshuarit dhe të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale.<sup>129</sup> Gjykatësit vazhdojnë që t'i mos përfillin disa nga këto procedura. Ajë që më së tepërmi vërehet, është se ata në fazën e gjykimit i pranojnë dëshmitë e nxjerra në procedurën në të cilën i akuzuari apo mbrojtësi, nuk kanë pasur mundësinë e kundërshtimit të atyre provave, kur është fjala për rastet e trafikimit.

Sipas ligjit në fuqi, kur dëshmitari jepë deklaratën gjatë fazës së hetimeve, dhe kur i njëjti pritet të dëshmojë edhe në fazën e gjykimit, vetëm në raste të caktuara dhe të jashtëzakonshme mund të lejohet gjatë gjykimit që të lexohet për procesverbal deklarata e dhënë në fazën e hetimeve.<sup>130</sup> Logjika që qëndron prapa kësaj dispozite është që t'i ofrohet mundësia të akuzuarit apo mbrojtësit të tij/saj që gjatë fazës së gjykimit të marrin në pyetje dëshmitarin dhe që t'i mundësoj trupit gjykues që të vlerësojë kredibilitetin e dëshmitarit duke vlerësuar sjellet e tij/saj. Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjithashtu garantojnë të drejtën për të akuzuarin apo mbrojtësin e tij/saj, që të ekzaminonjë dëshmitarin gjatë dëgjimit publik.<sup>131</sup> Çdo devijim nga kjo procedurë nuk duhet të cenojë të drejtat e të akuzuarit. Në lidhje

<sup>127</sup> Prezumimi që e akuzuara e kupton dhe e flet gjuhën serbe ishte bazuar në atë që gjykatësi kishte kuptuar se gjatë hetimeve e akuzuara ka thënë din të flasë pak serbisht. Si pasojë, megjithatë përkthyesi deklaroi në gjykatë se nuk munteta kuptonte të akuzuarën plotësisht pasi që ajo përdorte shumë fjalë në gjuhën bullgare, të cilat ai nuk i dinte. Si përgjegjëje e kësaj kryetari i trupit gjykues e udhëzoi përkthyesin që të përkthejë sa më mirë që mundet dhe shtoi që e akuzuara duhet ta ngrisë pak zërin pasi që njëri nga gjykatësit në kolegji fliste nga pak gjuhën bullgare. Në fakt ishte e pa qartë nëse e akuzuara dëshmonte në gjuhën serbe apo bullgare (apo kombinim i të dy gjuhëve), por çka ishte e qartë është se përkthyesi nuk ka mundur të japë gjykatë dëshminë e plotë dhe të saktë të të akuzuarës. Thjesht vetëm pse një gjykatës në trupin gjykues dinte pak gjuhën bullgare nuk e arsyeton gjykatën nga obligimet e saj për të ofruar përkthyes të kualifikuar.

<sup>128</sup> DD për momentin punëson përkthyes serb, shqiptarë dhe një rumun. Ato gjithashtu përdorin shërbimet e dy përkthyesëve të lirë rusë kur shfaqet nevoja.

<sup>129</sup> Lexo raportin e katërt, faqe 18,

<sup>130</sup> Lexo LPP RFJ neni 333.

<sup>131</sup> Neni 6(3) i KEDNj dhe neni 4(3) i KNDCP në të dy këto konventa parashikon që një i dyshimtë/akuzuar ka të drejtë të ekzaminonjë apo të ketë ekzaminuar dëshmitarin kundër tij dhe të marrë pjesë në ekzaminimin për të nën të njejtat kushte si dhe dëshmitari kundër tij. KEDNj e ka interpretuar këtë që të nënkuptohet se “dëgjimi i dëshmitarit duhet të jetë gjithëanshëm” dhe që “të gjitha dëshmitë në parim duhet të prodhohen në prezencën e të akuzuarit në ndëgjim publik me qëndrim të argumenteve

me këtë, ligji vendës përmbanë dispozitën e cila lejon pjesëmarrjen e prokurorit, të dyshuarit dhe mbrojtësit në fazën e hetimeve për t'a marrë në pyetje ose dëgjuar dëshmitarin i cili më vonë mund të mos paraqitet në fazën e gjykimit.<sup>132</sup> Kjo dispozitë në këtë mënyrë e zvogëlon paragjykimin ndaj të akuzuarit në rastet kur dëshmia e dëshmitarit të tillë, lexohet për procesverbal më vonë gjatë fazës së gjykimit dhe këtë procedurë e vënë në pajtim me standardet dhe shkencën ndërkombëtare juridike për të drejtat e njeriut.<sup>133</sup>

Në rastet e trafikimit dëshmitarët kryesorë zakonisht janë viktimat e trafikimit dhe për deri sa ato mund të japin dëshmi gjatë fazës hetimore të procedurës penale, në shumicën e rasteve ato nuk marrin pjesë në gjykim, pasi që normalisht ato riatdhesohen para se të fillojë gjykimi.<sup>134</sup> Në këtë drejtim, gjykatësit hetues në rastet e trafikimit duhet të tentojnë që t'i informojnë mbrojtësit për të drejtën e tyre që të marrin pjesë në fazën hetimore në mënyrë që t'u jipet mundësia për të ekzaminuar dëshmitarin. Dështimi i gjykatësit hetues apo mbrojtësit që t'i përmbahet procedurës së përmendur më lartë, mund të prodhojë pasoja serioze për prokurorinë dhe mbrojtësin gjatë fazës së gjykimit kur dëshmitari nuk është i pranishëm në seancë. Për shembull, mbrojtësi mund të kundërshtojë pranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit të tillë, duke u bazuar në shkeljen e të drejtave të të akuzuarit për shkak të dështimit të gjykatësit hetues për t'ia mundësuar rastin atij/saj për të sfiduar atë dëshmi.

Më tej, kur gjykata pranon këtë situatë dhe e konsideron dëshminë e dëshmitarit si të papranueshme, në rrethanat kur kjo dëshmi është kyçe ose e vetmja dëshmi për prokurorinë, kjo situatë mund të rezultojë në shturrje të lëndës së prokurorisë. Kur mbrojtësi nuk e kundërshton pranueshmërinë e provës së nxjerrë në fazën e hetimeve, të cilën nuk ka mundur ta shqyrtojë paraprakisht, atëherë kjo mund të paraqet cenim të të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë. Gjatë monitorimit të rasteve të trafikimit OSBE ka vërejtur dështime të vazhdueshme nga ana e gjykatësve hetues për të njoftuar mbrojtësit mbi të drejtën e tyre të pjesëmarrjes në ekzaminimin e dëshmitarëve, ose për të caktuar mbrojtës për t'i përfaqësuar viktimat/dëshmitarët gjatë dëgjimit hetimor. Në disa raste edhe me informimin me kohë të gjykatësit hetues, mbrojtësit nuk kanë marrë pjesë në këtë dëgjim. Në disa raste është raportuar se mbrojtësit thjeshtë nuk e kanë parë të nevojshme që të marrin pjesë gjatë ekzaminimit të dëshmitarëve.<sup>135</sup> Për më tepër, e gjithë kjo nuk ka rezultuar domosdoshmërisht në shturrjen e lëndës së prokurorisë. Në pakë raste, kur gjykatësit kanë vazhduar të lexojnë për procesverbal deklaratat e dhëna para gjykatësit hetues, dhe kur mbrojtësit nuk janë njoftuar për të drejtën e tyre të pjesëmarrjes në dëgjimin hetimor, as avokati mbrojtës, as prokurori por as anëtarët e kolegjit nuk e kanë kundërshtuar një procedurë të tillë, dhe me atë rast kanë treguar një mospërfillje totale të dispozitave të sipërpërmendura të ligjit në fuqi.

---

kundërshtuese”, lexo *Barbera, Messegue dhe Jabardo vs. Spanjës*, 6 dhjetor, 1998, al. 78; *McCann dhe t tjerët vs. Britanisë së Madhe*, 27 shtator, 1995 në al. 47; *Asch vs Austrisë*, 26 prill, 1991 në al. 27; *A.M. vs Italisë*, 14 dhjetor, 1999 në al. 25; *Delta vs Francës*, 19 dhjetor 1990 në al. 36.

<sup>132</sup> Lexo LPP RFJ, neni 168(8).

<sup>133</sup> Në *Kostovski vs. Holanda, op. Cit.* shënim 44, në al. 41, KEDNj mban si rregull që të drejtat e përbëra në nenin 6(3)(d) kërkojnë që një të akuzuari duhet ti ipet një mundësi adekuate për të sffuar dhe pyetur dëshmitarin kundër tij ose gjat fazës kur dëshmitari jep deklaratën e tij apo në ndonjë fazë të më vonëshme të procedurës dhe që deklaratat e dëshmitarit nuk duhet që gjithmonë të bëhen në ndëgjimet publike në gjykatë: për të përdorur si dëshmi deklarata të tilla të marra në fazën para gjykimit nuk është vetvetiu në kundërshtim me nenin 6(3)(d), nëse sigurohet që të drejtat e mbrojtëjes janë rrespektuar. Lexo gjithashtu *McCann dhe t tjerët vs Britanisë së Madhe, op. Cit. Shënim 44, në al. 36.*

<sup>134</sup> Lexo nenin 5 të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/4, e cila ofron që riatdhesimi i viktimave nuk mund të pengohet apo të shtyhet nga marrja e deklaratës nga zyrtarët e zbatimit të ligjit apo gjykatësi hetues.

<sup>135</sup> Lexo më tutje rasti i monitoruar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në mars 2002, faqe 41.

Mirëpo, në një rast të përcjellur nga OSBE, është vërejtur se edhe kur avokati mbrojtës kishte kundërshtuar pranueshmërinë e deklartës së tillë të dëshmitarit, trupi gjykues e kishte refuzuar parashtrësën e tij.

Në rastin e dy shqiptarëve të Kosovës, të shpallur fajtor dhe të denuar me katër vjet heqje lirie nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Pristina, në maj të vitit 2002, gjykata e kishte fajësuar të akuzuarit duke u bazuar në dy deklaratave të bëra me shkrim para gjykatësit hetues të dy dëshmitarëve/viktimave (të dyja këto turke nga Bullgaria). Gjerësa të akuzuarit kishin qenë të pranishëm gjatë dëgjimit hetimor, ata nuk kanë pasur avokatë mbrojtës gjatë asaj kohe dhe gjykatësi hetues nuk ua kishte caktuar avokatin mbrojtës për t'i përfaqësuar ata. Gjatë fjalës së tij përfundimtare, mbrojtësi kundërshtoi pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve, duke u bazuar në atë se atij nuk i ishte dhënë mundësia për t'i marrë në pyetje dëshmitarët.<sup>136</sup> Sidoçoftë, gjykata nuk e ka marrë këtë në konsideratë dhe nuk ka hyrë në çështjet e ligjit vendës apo ndërkombëtar lidhur me këtë çështje.

Të akuzuarit në rastin e lartpërmendur, dhe në shumë raste tjera, janë denuar në bazë të provave, vërtetësia e të cilave në shumicën e rasteve nuk ka mundur të shqyrtohet nga ana e avokatëve të tyre, dhe kjo ka rezultuar në shkelje të rënda të të drejtës së tyre për gjykim të drejtë.

### ***Dështimi për të shqiptuar sanksionet për rastet e trafikimit, që janë në përputhje me rregullat e shqiptimit të denimeve (sanksioneve)***

Pas një monitorimi të vazhdueshëm të gjykimeve dhe hetimeve të rasteve të trafikimit, OSBE shprehë shqetësimin e vazhdueshëm në lidhje me qëndrimin e gjykatësve me rastin e shqiptimit të denimeve, për rastet e trafikimit. Intencat e OSBE-së nuk janë që të analizojnë procesin gjyqësor të vendim marrjes në kuptim të vlerësimit të provave/dëshmimeve, e as të komentojnë këshillimet ose aktgjykimet liruese. Por, dëshiron që megjithatë, të shprehë shqetësimin e vet për disa sanksione të shqiptuara për ata që janë shpallur fajtor për trafikim, dhe të cilat nuk janë në pajtim me rregullat e shqiptimit të sanksioneve, për rastet e tilla.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 parasheh denimet pas shpalljes së fajsisë për trafikim me njerëz ,prej 2 deri në 12 vjet për ata që merren apo tentojnë të merren me trafikim; 2 deri në 15 vjet kur viktimat është nën moshën 18 vjeqare; dhe 2 deri 20 vite kur personi është shpallur fajtor për organizimin e një grupi personash që të merren apo që të tentojnë të merren me trafikim.<sup>137</sup> Vlenë të përmendet se këto nuk janë thjeshtë udhëzime mbi shqiptimin e sanksioneve, por janë parametra ligjor të cilat janë obligative.

<sup>136</sup> Ai megjithatë dështoi të paraqesë faktin që prania e deklaratave të dëshmitareve në rrova gjithashtu shkel dispozitat ligjit të aplikueshëm ndërkombëtarë, rrespektivisht neni 6(3)(d) KEDNj dhe neni 14(3)(e) KNDCP.

<sup>137</sup> Lexo më tutje neni 2 i Rregullorës së UNMIK-ut 2001/4 ku thotë:

- 2.1 Çdo person që merret ose tenton të merret me trafikimin e njerëzve kryen veprë penale dhe pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet burg.
- 2.3 Çdo person që organizon ndonjë grup të personave me qëllim të kryerjes së veprave të përmendura në paragrafet 2.1 dhe 2.2 pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet burg.
- 2.4 Çdo person i cili nga pakujdesia ndihmon trafikimin me njerëz kryen veprë penale dhe pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet burg.

Mirëpo, deri me sot, gjykatësit në disa raste të trafikimit, nuk i janë përmbajtur këtyre standardeve të shqiptimit të sanksioneve. Në një numër të rasteve, janë shqiptuar denimet më të vogla se dy vjet heqje lirie. Kjo praktikë është në kundërshtim me ligjin vendës, dhe ngrisin shqetësime legjitime mbi mënyrën sipas të cilës gjykatat vendës e vlerësojnë peshën e krimeve të trafikimit. Logjika pas shpalljes së Rregullores 2001/4 të UNMIK-ut, ishte të përcaktojë një kufi më të lartë të përgjegjësisë penale si dhe sanksione më të larta për ata të shpallur fajtor për krimet e trafikimit. Reagimi i gjykatave vendëse nuk është konsistent me synimet e legjislacionit të ri. Kjo, potencialisht mund të cenojë përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të luftuar trafikimin në regjion.

### **Rekomandimi**

- DD duhet të lëshoj një Qarkore Gjyqësore për të gjithë gjykatësit dhe prokurorët, për ti informuar se përkthyesit janë në dispozicion për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore sipas kërkesës.

## D. Qasja efi kase në avokatin mbrojtës

### *Çështjet:*

Avokatët mbrojtës dështojnë të mbrojnë interesat e klientëve të tyre:

- Ata vazhdimisht dështojnë të kundërshtojnë pranueshmërinë e provave në rrethanat kur një gjë e tillë paragjykon mbrojtjen e klientëve të tyre dhe është potencialisht e papranueshme bazuar në ligjin në fuqi;
- Ata dështojnë të sfidojnë pranueshmërinë e provave të nxjerra përmes torturimit apo keqtrajtimit;
- Ata nuk kundërshtojnë rastet kur klienti i tyre nuk është informuar menjëherë për arsyet e arrestimit dhe natyrës së akuzave kundër tyre;
- Ata nuk përgatiten në mënyrë adekuate për dëgjimet gjyqësore dhe nuk kërkojnë kohë për të bërë këtë.

### *Hyrje*

Avokatët mbrojtës janë të obliguar të veprojnë në interesin më të mirë të klientëve të tyre. LPP RFJ i obligon avokatët mbrojtës të luajnë një rol aktiv gjatë procedurës ashtu që të sigurojnë se të drejtat dhe interesat e klientëve të tyre të jenë të mbrojtura.<sup>138</sup> E drejta ndërkombëtare gjithashtu u imponon avokatëve mbrojtës një obligim të ngjashëm.<sup>139</sup>

Monitorimi i procedurave gjyqësore në të kaluarën ka zbuluar së në shumë raste avokatët mbrojtës kanë dështuar të këshillojnë dhe përfaqësojnë klientët e tyre në mënyrë efektive.<sup>140</sup> Posaçërisht, ata kanë dështuar të observojnë procedurat e dizajnuara që të garantojnë të drejtat e klientëve të tyre për një gjykim të drejtë. Monitorimi i vazhdueshëm i procedurave gjyqësore zbulon se ky është një problem i vazhdueshëm.

### ***Dështimi për të kundërshtuar provat në rrethanat kur një gjë e tillë paragjykon mbrojtjen e klientëve të tyre dhe është potencialisht e papranueshme bazuar në ligjin në fuqi***

Si e drejta vendëse ashtu edhe ajo ndërkombëtare kërkojnë që të gjitha provat e prokurorisë në procedurë penale të paraqiten në prezencën e të akuzuarit në seancë publike nga këndvështrimi i argumentimit reciprok.<sup>141</sup> Kjo është vendimtare për të drejtat e të akuzuarit për një gjykim të drejtë. Ligji në fuqi

<sup>138</sup> Lexo më tutje Kodin e etikës profesionale për avokatë, në pjesën e titulluar “Detyrat e mbrojtësit”, i cili obligon të gjithë avokatët që të këshillojnë dhe mbrojnë klientët e tyre pa vonesë, me ndërgjegje dhe zell, në paragrafin 2.1. Lexo gjithashtu, raportin e tretë, në faqe 28; raportin e parë, në faqe 45.

<sup>139</sup> Lexo më tutje parimet 13-15 të Parimeve themelore mbi rolin e avokatëve, të cilat kërkojnë që avokatët mbrojtës aktivisht të asistojnë klientët e tyre duke i këshilluar mbi të drejtat e tyre dhe duke i përfaqësuar në gjykata gjatë procedurave si dhe duke u ofruar atyre shërbime të cilat janë ‘praktike dhe efektive’. Lexo gjithashtu vendimin e GJEDNJ në rastin e *Artico v. Italia*, 13 maj 1980.

<sup>140</sup> Lexo më tutje, raporti i parë, në faqe 49; raporti i dytë në faqe 38; raporti i tretë në faqe 28; raporti i katërt në faqe 18.

<sup>141</sup> Për një diskutim më të detajizuar të dispozitave ligjore si vendëse ashtu edhe atyre ndërkombëtare, lexo faqen 36 të këtij raporti.

parasheh përjashtime me qëllim që të drejtat e të akuzuarit për një gjykim të drejtë të mos çënohen në rrethanat kur dëshmitari i cili jep deklaratë në fazën e hetimeve ka gjasa të mos paraqitet në gjykim. Në rrethana të tilla kur pretendohet të mbështetet në deklaratën e tij/saj gjatë gjykimit, ligji në fuqi, siguron që i akuzuari dhe avokati i tij/saj mbrojtës duhet të njoftohen për të drejtat e tyre që të marrin pjesë dhe ekzaminojnë deklaratën e dëshmitarit në fazën e hetuesisë.<sup>142</sup>

OSBE, megjithatë, ka monitoruar dështimet e vazhdueshme të një pjese të avokatëve mbrojtës për të kundërshtuar në rastet kur procedurat e lartpërmendura nuk kishin qenë në pajtueshmëri, që ka rezultuar në pranimin e deklaratave të dhëna para gjykatësit hetues, në fazën e gjykimit, në rrethanat kur avokatit mbrojtës nuk i ishte ofruar mundësia për të testuar deklaratën. Kjo kryesisht ka ndodhë si rezultat i dështimit të gjykatësit hetues për të respektuar procedurën apo i dështimit të avokatit për të marrë pjesë në dëgjimin gjatë fazës paraprake, pa marrë parasysh faktin se ata ishin informuar për të drejtën e tyre për pjesëmarrje.

Në një rast në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Pristina, në mars 2002, që kishte të bënte me një të dyshuar shqiptar të Kosovës, të ngarkuar për trafikim, pasi që gjykatësi hetues e ka informuar avokatin mbrojtës për të drejtën e tij që të marrë pjesë në dëgjimin e dëshmitarëve kryesor, avokati mbrojtës, thjeshtë u përgjegj se nuk ishte e domosdoshme për te që të jetë i pranishëm në dëgjim.

Në një rast, të një shqiptari të Kosovës, i cili në korrik 2002, ishte dënuar për përdhunim dhe i ishte shqiptuar dënimi prej një vjet heqje lirie nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Pristina, të akuzuarit i ishte mohuar e drejta e tij për gjykim të drejtë, kur avokati i tij mbrojtës dështoi të kundërshtojë pranueshmërinë e deklaratës së dy dëshmitarëve kryesor në procesverbalin e gjykimit (dy femra bullgare) në rrethanat kur nuk i ishte ofruar mundësia për të dëgjuar këta dëshmitarë në fazën hetimore të procedimit. Krahas kësaj, gjykata vazhdoi të lexojë raportin e mjekut ligjor për procesverbal, pa marrë parasysh faktin se as kolegji gjykues e as avokati mbrojtës nuk kishin pasur mundësi të kundërshtojnë dhe të ekzaminojnë dëshminë e mjekut. I akuzuari ishte dënuar kryesisht në bazë të deklaratëve të këtyre dëshmitarëve.

Në një rast tjetër, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Pristina, që përfshinte një mashkull shqiptar të Kosovës, i cili ishte dënuar në dhjetor 2002 për vrasje dhe i ishte shqiptuar dënimi prej 10 vjet e e 6 muaj heqje lirie, i akuzuari kryesisht ishte dënuar në bazë të provave të dhëna nga tre dëshmitarë në dëgjimin e mbajtur në Gjermani, në rrethanat kur avokatit mbrojtës nuk kishte pasur mundësia për të dëgjuar këta dëshmitarë.

Të tre dëshmitarët okularë<sup>143</sup> në këtë rast, të cilët jetonin në Gjermani, refuzuan të vijnë në Kosovë dhe kolegji gjykues, duke bashkëpunuar me autoritetet Gjermane, vendosi t'i dëgjojë ata në Gjermani, në pajtim me dispozitat e nenit 330(1) LPP RFJ.<sup>144</sup> Në këtë rast duket se avokati mbrojtës ishte informuar në mënyrë të rregullt mbi dëgjimet dhe të gjitha përgatitjet ishin bërë për të, nga ana e zyres së prokurorit ndërkombëtar, që ai të udhëtonte për të marrë pjesë në seancën dëgjimore në Gjermani.<sup>145</sup> Sidoqoftë, avokati mbrojtës nuk u paraqit në aeroport dhe nuk muar pjesë në dëgjimet në Gjermani dhe si rrjedhojë

<sup>142</sup> Për diskutim më të detajzuar të ligjit vendës, lexo faqet 35-36 të këtij raporti.

<sup>143</sup> Përprjekjet për të kontaktuar dëshmitarin e katërt në këtë rast ishin të pasuksesshme.

<sup>144</sup> Neni 330 (1) LPP RFJ parasheh se nëse mësohet gjatë seancës kryesore se dëshmitari i ftuar i cili nuk ishte dëgjuar më parë, nuk mund të paraqitet në gjykatë apo do të kishte vështirësi ta bënte këtë, kolegji mund të urdhëronte, nëse konsideron se deklaratata e tij është e rëndësishme që ai të dëgjohej jashtë seancës kryesore, nga kryetari i kolegjit apo nga gjykatësi i cili është anëtar i kolegjit. Lexo gjithashtu nenin 330 (3) LPP RFJ.

<sup>145</sup> Sipas aktgjykimit, ishte arritur marrëveshja që shpenzimet e avokatit mbrojtës do të paguheshin nga buxheti i Departamentit të Drejtësisë. Sidoqoftë, pasi që rregullimi i letrave kërkonte kohë, ishte arritur pajtimi që shpenzimet e tij do të kompenzoheshin më vonë. Asnjëherë avokati mbrojtës nuk kontestoi marrëveshjen e tillë. Në fakt, ai paralajmëroi se do të përpiqej të mirrte pjesë.



nuk kishte avokat mbrojtës për të përfaqësuar të akuzuarin.<sup>146</sup> Në provat e tyre, të tre dëshmitarët e identifikuan pozitivisht të akuzuarin, si personi i cili kishte shtjerë në viktimën.

Kur deklaratat e këtyre tre dëshmitarëve ishin lexuar për procesverbal, avokati mbrojtës nuk kontestoi pranueshmërinë e tyre. Në vend të kësaj, ai shprehu keqardhjen e tij që dëgjimet në Gjermani kishin zbuluar provat, të cilat ishin të pafavorshme për klientin e tij. Në shpalljen e aktgjykimit dënues, kolegji deklaroi se dënimi ishte bazuar në deklaratat e tre dëshmitarëve okular të dëgjuar në Gjermani. Gjykata gjithashtu përmendi se: “Ndonëse këta dëshmitarë nuk iu nënshtroan marrjes në pyetje nga mbrojtja, vet avokati mbrojtës pranoi pas shënimit të procesverbalit të deklaratave të këtyre dëshmitarëve se prezenca e tij gjatë dëgjimit të këtyre dëshmitarëve nuk do të kishte bërë ndonjë ndryshim në deklaratat që ata kishin dhënë. Andaj avokati mbrojtës shprehimisht ka paralajmëruar qëllimin e tij për të mos kontestuar deklaratat apo edhe pse ai do të ishte përpjekur për të bërë këtë, ai nuk do të ishte në gjendje për të thyer besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve.”

Ky rast i veçantë, shtron shqetësime përkitazi me profesionalizmin e avokatit mbrojtës dhe aftësisë së tij për të përfaqësuar në mënyrë efektive klientin e tij. I akuzuari ishte dënuar me 10 vjet e 6 muaj heqje lirie vetëm në bazë të provave, të cilat nuk ishin testuar nga mbrojtja.

### ***Dështimi për të kontestuar pranueshmërinë e provave të fituara me torturë apo keqtrajtim***

Dëshmina, prëfshirë këtu edhe pranimi nga ana e të dyshuarit/akuzuarit, i nxjerrë përmes torturës apo trajtimit tjetër jonjerëzor apo degradues, është e papranueshme sipas ligjit i cili mjaft mirë e rregullon këtë çështje. Si ligji vendës ashtu edhe e drejta ndërkombëtare, në mënyrë të qartë e parashikojnë përjashtimin e provave të tilla.<sup>147</sup> Në një gjykim për tentim vrasje, pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane, në gusht të v.2002, avokati mbrojtës nuk e kundërshtoi pranueshmërinë aktit të pranimit të veprës, të klientit të tij ndonëse ishte i vetëdijshëm se e njëjta ishte fituar nën presion. Prokurori ndërkombëtar në këtë rast kërkonte që këto prova të pranoheshin.

Rasti kishte të bënte me katër shqiptar të Kosovës, të akuzuar për tentim vrasje të një shqiptari të Kosovës, ish komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rrethanat e rastit konsistonin në atë se dy prej të pandehurve ishin rrëmbyer, siç besohej, nga bashkëvepruesit e panjohur të viktimit, dhe ishin dërguar në një shtëpi të braktisur ku, siç pohohet, pas rrahjeve ishin shtrënguar që përmes inçizimit me video, të pranojnë kryerjen e krimit. Pas të ashtuquajturave pranime, dy të akuzuarit i ishin dorëzuar KFOR-it amerikan, dhe më pastaj, i ishin dorëzuar autoriteteve zbatuese të ligjit të UNMIK-ut. Prokurori ndërkombëtar në këtë rast kërkonte që të pranoheshin pranimet e incizuara në video, si prova zyrtare në këtë rast, pa marrë parasysh faktin se edhe ligji vendës ashtu edhe e drejta ndërkombëtare, parashikojnë qartazi përjashtimin e tyre si prova.<sup>148</sup> Gjykata sidoqoftë, i konsideroi këto prova të papranueshme.

Dështimi i avokatit mbrojtës në këtë rast, që të kundërshtoj pranueshmërinë e pranimit të klientit të tij, duke i ditur rrethanat nën të cilat ai pranim ishte fituar, konstituon një dështim serioz nga ana e tij për t'u thirrur në garancat themelore të të drejtave njerëzore të klientit të tij.

### ***Dështimi i avokatëve mbrojtës për të kundërshtuar në rastet kur klienti i tij/saj nuk kishte qenë i informuar menjëherë për shkaqet e arrestimit dhe për natyrën e akuzave kundër tyre***

<sup>146</sup> Para marrjes në pyetje të dëshmitarëve, gjykatësi gjerman, dy anëtarët ndërkombëtar të kolegjit dhe prokurori ndërkombëtar diskutuan mundësinë e caktimit të një avokati gjerman për të përfaqësuar të akuzuarin por ata nuk proceduan me këtë.

<sup>147</sup> Lexo LPP RFJ, neni 218, al. 7-8; neni 12 i Deklaratës kundër torturës; neni 15 i Konventës kundër torturës; neni 6 KEDNJ; udhëzimi 16 i Udhëzimeve mbi rolin e prokurorit dhe neni 69(7) i Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale.

<sup>148</sup> Ishin indikacione të fortanë rastin se provat ishin fituar nën presion. Ato gjithashtu ishin fituar jashtë kornizave të hetimeve gjyqësore dhe nga personat e paautorizuar jo-zyrtar.

Dështimi për të informuar të dyshuarin apo të akuzuarin për shkaqet e arrestimit të tij/saj dhe për akuzat kundër tij/saj, shkelë të drejtat e dyshuarit për gjykim të drejtë edhe sipas të drejtës vendëse<sup>149</sup> ashtu edhe asaj ndërkombëtare.<sup>150</sup>

Shkeljet e këtyre dispozitave vazhdojnë të observohen në baza të vazhdueshme në tërë Kosovën. Disa raste janë potencuar në këtë raport, ku i dyshuari apo i akuzuari nuk ishin informuar mbi natyrën e akuzave kundër tij/saj për shkak të vështirësive në përkthim apo për shkak se avokati mbrojtës nuk ka kundërshtuar.<sup>151</sup> Megjithate, edhe pse në disa raste nuk ka pasur vështirësi përkthimi/interpretimi, prap se prap, të dyshuarit dhe të akuzuarit nuk kanë qenë të informuar.

Për shembull, në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, në tetor 2002, që kishte të bënte me katër të dyshuar shqiptar të Kosovës, tre prej tyre të mitur, të akuzuar për dhunim, parburgim të paligjshëm dhe kidnapim, dy prej të dyshuarve, u ishte mohuar e drejta për të ditur dhe kuptuar akuzat kundër tyre. Gjykatësi hetues ndërkombëtar nuk i kishte informuar të dyshuarit për akuzat kundër tyre, apo për bazat mbi të cilat ata ishin dyshuar për kryerjen e veprave me të cilat ngarkoheshin në fillim të dëgjimit hetimor. Kur avokati mbrojtës i të miturit të parë e ngriti këtë çështje, gjykatësi hetues ndërkombëtar u përgjigj se pasi që klienti i tij kishte qenë në parburgim policor ai duhej të kishte të ditur akuzat kundër tij. Vetëm kur avokati mbrojtës në fjalë insistoi më tutje që gjykatësi hetues të informoj klientin e tij mbi natyrën e akuzave kundër tij, i dyshuari ishte informuar për to.<sup>152</sup>

Megjithate, asnjëri nga dy avokatët tjerë mbrojtës që përfaqësonin të miturit tjerë nuk e shtruan këtë çështje para se klientët e tyre të jepnin deklaratën para gjykatësit hetues. Njëri prej avokatëve mbrojtës iu referua kësaj çështje vetëm në fund të marrjes në pyetje të klientit të tij dhe i dyshuari vetëm atëherë ishte informuar mbi natyrën e akuzave. Avokati mbrojtës reagoi duke deklaruar se ai ishte shumë i befashuar që po dëgjon se klienti i tij ishte ngarkuar për krime të tilla dhe shtoi se ai do të kishte bërë pyetje tjera klientit të tij, po të kishte qenë në dijeni për natyrën e akuzave kundër tij.

Dështimi i avokatëve mbrojtës për të ndërhyrë në procedurën hetimore kur ishte evidente se gjykatësit hetues kanë dështuar të informojnë të dyshuarit për akuzat kundër tyre, përfaqëson një mangësi serioze në obligimin e avokatëve mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të klientëve të tyre.

### ***Dështimi i avokatëve mbrojtës që në mënyrë të duhur të përgatitetn për gjykim apo të kërkojnë kohë për ta bërë këtë***

Edhe e drejta vendëse e aplikueshme e edhe ajo ndërkombëtare sigurojnë se të akuzuarit duhet t'i jipet kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij/saj.<sup>153</sup> Sidoçoftë, OSBE ka observuar që kjo e drejtë

<sup>149</sup> Për një diskutim më të detajizuar të dispozitave të së drejtës vendëse dhe asaj ndërkombëtare lexo, *op. cit.*, shënimi 35.

<sup>150</sup> Lexo gjithashtu nenin 5(2) të KEDNJ. KEDNJ deklaron se neni 5(2) siguron ‘masat mbrojtëse elementare që secili person i arrestuar duhet të dij se pse është privuar prej lirisë. Çdo personi të arrestuar duhet treguar, me një gjuhë të thjeshtë, jo teknike ashtu që ai të kuptoj, bazat esenciale ligjore dhe faktike për arrestimin e tij, ashtu që të jetë në gjendje, nëse konsideron se një gjë e tillë qëndron, të aplikoj pranë gjykatës për të sfiduar ligjshmërinë e tij’ lexo *Fox, Campbell & Hartley v Britania e Madhe*, 30 gusht 1990, par. 40.

<sup>151</sup> Lexo rastet e diskutuara në faqet 34-35 të këtij raporti.

<sup>152</sup> Gjykatësi hetues e arsyetoi dështimin e tij për të bërë këtë më heret duke deklaruar se ngutej dhe nuk kishte kohë për të bërë një gjë të tillë.

<sup>153</sup> Lexo nenin 11.3 të LPP RFJ dhe gjithashtu nenin 6(3) KEDNJ dhe nenin 14(2)(b) të KNDCP të cilat parashohin se çdonjëri i akuzuar për vepër penale do të ketë të drejtë për kohë të duhur dhe lehtësira për përgatitjen e mbrojtjes së tij/saj. Kjo ishte theksuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ në një numër rastesh ku gjykata vazhdimisht ka mbajtur qëndrimin se “nën parimin e barazisë së armëve, si njërin prej tipareve të një koncepti më të gjërë të gjykimit të drejtë, çdonjëres palë duhet ti jipet mundësia e arsyeshme për të prezentuar rastin e vet në kushtet të cilat nuk e vendosin atë në pozitë të disfavorshme viza-vi

kishte qenë cënuar jo vetëm nga gjykatat por edhe nga avokatët mbrojtës të cilët kanë dështuar të kërkojnë kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e klientëve të tyre. Ky problem ishte vërejtur posaçërisht në rastin e një seance ankimore para Gjykatës Supreme.

Një rast i tillë kishte të bënte një shtetas gjerman të dënuar për terrorizëm, vrasje dhe tentim vrasje, me 23 vjet heqje lirie nga gjykata e shkallës së parë. Pas parashtrimit të ankesës nga avokati pranë Gjykatës Supreme, kryeprokurori pas 11 ditësh parashtrroi përgjigjen e tij të përmbledhur duke i propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e mbrojtësit si të pabazuar. Asnjë përgjigje tjetër nuk ishte parashtruar nga ana e zyrës së prokurorisë deri para pak minutash para se të fillonte procedura ankimore kur prokurori ndërkombëtar i dorëzoi avokatit shqiptar të Kosovës përgjigjen e tij katërdhjetë faqëshe në gjuhën angleze. Pa marrë parasysh faktin se avokati shqiptar e përmendi çështjen e dorëzimit të vonë të përgjigjes, si dhe faktin se kjo ishte parashtruar pa u përkthyer në gjuhën shqipe, ai nuk kërkoi për shtyrjen e procedurës për t'i lejuar vehtes kohë për të vlerësuar rastin e prokurorit.

Avokati mbrojtës gjithashtu kishte cënuar të drejtën e klientit të tij për të kërkuar kohë të duhur për t'u përgatitur për gjykim, në rrethanat kur ata kishin dështuar të kërkojnë kohë për t'u konsultuar në mes veti privatisht në lidhje me mbrojtjen e tyre. E drejta për kohë të mjaftueshme dhe adekuate nënkupton edhe të drejtën e lehtësirave për përgatitjen e mbrojtjes, ku i akuzuari apo i dyshuari, ka të drejtë të komunikojë në mënyrë private me avokatin e tij mbrojtës dhe pa paraninë e policisë në atë ambient apo të zyrtarëve tjerë.<sup>154</sup> Sidoçoftë, gjatë rrjedhës së monitorimit OSBE ka vërejtur disa instanca ku të dyshuarit apo të akuzuarit nuk kanë qenë në gjendje të ushtrojnë këtë të drejtë dhe avokati mbrojtës nuk ka kundërshtuar apo nuk ka kërkuar më tepër kohë brenda së cilës do ta bënin këtë.

Në një rast të monitoruar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, në shtator të v.2002, që kishte të bënte me një të pandehur, i cili ishte i mitur në kohën e kryerjes së veprës dhe i cili ishte akuzuar për dhunim dhe akt të panatyrshëm seksual, avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata, kërkoi nga gjykata që, para se të fillojë seanca, t'i lejohej disa minuta për të diskutuar rastin në mënyrë private me klientin e tij. Pasi që i ishte lejuar një periudhë e shkurtë kohore për konsultim jashtë gjykatës, prokurori publik duke u bazuar në dispozitat e ligjit vendës kërkoi që avokati mbrojtës të thirret.<sup>155</sup> Pa asnjë kundërshtim avokati mbrojtës u kthye në gjykatore dhe seanca filloi. Avokati mbrojtës nuk kërkoi më tepër kohë brenda së cilës do t'i lejohej të konsultohet me klientin e tij përkundër faktit se rasti kishte të bëjë me akuza mjaft serioze kundër klientit të tij, dhe se kërkonte një përgatitje të hollësishme. Për më tepër, avokati mbrojtës ishte dashur të bazohej në dispozitat e ligjit të aplikueshëm, të cilat parashohin qasje dhe konsultime të pakufizuara me të akuzuarin pas ngritjes së aktakuzës.<sup>156</sup> Në këtë rast, dispozita ligjore mbi të cilën prokuroria bazohej, respektivisht neni 74.1 i LPP RFJ, nuk ishte e aplikueshëm pasi që kjo mund të aplikohet vetëm gjatë

---

kundërshtarit të tij” lexo gjithashtu vendimin e GJEDNJ në *Bulut V. Austria*, 22 shkurt 1996, par. 47; *Foucher v. France*, 18 mars 1997, par. 37; *Lanz v. Austria*, 31 shkurt 2002, par. 57. Gjykata kishte theksuar gjithashtu “nevojën për të respektuar të drejtën e procedurës kontradiktore, duke theksuar se kjo përfshin ‘të drejtën e palëve për të pasur dijeni për, dhe të komentoj mbi të gjitha provat e nxjerruna dhe vërejtjet e parashtruara’, lexo *Kress v. Franca*, 7 prill 2001, par. 65, *Brandstetter v. Austria*, 28 gusht 1992, par. 67, *Kremzov v. Austria*, 21 shtator 1993, par. 48; *Campbell dhe Fell v. B.M.* 28 qershor 1984 në par. 113.

<sup>154</sup> Jurisprudenca e GJEDNJ ka konfirmuar këtë, lexo më tej, *Campbell & Fell v. Britania e Madhe*, 28 qershor 1984 par. 113. Vërej gjithashtu Rregulloren e UNMIK-ut 2001/28 e cila shprehimisht parashihet dispozitë për këtë të drejtë. Neni 3.3 i Rregullores siguron se personi i arrestuar ka të drejtë të komunikojë në mënyrë konfidenciale me avokatin mbrojtës gojarisht apo me shkrim dhe se komunikimi në mes të personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij/saj mund të jetë në shikimin por jo në dëgjim të organeve zbatuese të ligjit.

<sup>155</sup> Lexo nenin 74 (2) LPP RFJ i cili deklaron se i akuzuari mund të bisedoj me avokatin vetëm në prezencë të gjykatësit hetues apo zyrtarit tjetër gjatë dëgjimit hetimor.

<sup>156</sup> LPP RFJ, neni 74(3) parashihet se kur marrja në pyetje ka përfunduar, apo kur është ngritur aktakuza apo informata e kërkuar pa ekzaminim, i akuzuari nuk mund të ndalohej nga komunikimi i lirë bisedimi me avokatin e tij mbrojtës pa mbikqyrje; lexo gjithashtu jurisprudencën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, i cituar, op. cit. shënimi 70.

dëgjimit hetimor, por avokati mbrojtës gjithashtu dështoi të ngrisë këtë çështje.<sup>157</sup> Në përfundim të seancës, i akuzuari ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 8 vjet heqje lirie.

Rastet si këto, shërbejnë për të ndriçuar faktin se në vazhdimësi dhe në tërë Kosovën, avokatët mbrojtës rregullisht dështojnë të përfaqësojnë interesat e klientëve të tyre.

## **PJESA 5**

### **ZHVILLIMET E RËNDËSISHME BRENDIA SISTEMIT LIGJOR**

Që nga raporti i fundit i OSBE për sistemin penal gjyqësor, kanë ndodhur disa zhvillime të rëndësishme, disa prej të cilave janë nënvizuar më poshtë:

#### **1. Rregulloret**

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/1 që ndryshon ligjin në fuqi për veprat penale në lidhje me dhunën seksuale, e hyrë në fuqi më 6 janar 2003.

---

<sup>157</sup> Duhet megjithatë të përmendet se OSBE në mënyrë të vazhdueshme ka shprehur pikëpamjen se LPP RFJ neni 74(1), i cili parasheh ndalimin e qasjes të avokati mbrojtës derisa gjindet në paraburgim deri pas marrjes në pyetje, është shkelje e të drejtës ndërkombëtare, lexo raportin e dytë në faqe 13 dhe raportet speciale 7 dhe 8 të SMSL, mbi të drejtën në avokatin mbrojtës efektiv, maj respektivisht qershor 2000.

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/20 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64 mbi caktimin e gjykatësve/prokurorëve ndërkombëtar dhe/ose ndryshimin e vendit të gjykimit, e hyrë në fuqi më 14 dhjetor 2002

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/7 mbi përdorimin e shënimeve me shkrim me rastin e marrjes në pyetje gjatë procedurës penale të udhëhequr nga organet e zbatimit të ligjit, e hyrë në fuqi më 28 mars 2002,.

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/6 mbi masat e fshehta dhe masat teknike të vëzhgimit dhe hetimit, e hyrë në fuqi më 18 mars 2002.

## **2. Udhëzimet Administrative**

Udhëzimi administrativ 2003/1 që implementon Rregulloren e UNMIK-ut 2001/7 mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, e hyrë në fuqi më 17 janar 2003.

Udhëzimi administrativ 2002/25 që implementon Rregulloren e UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurat penale, e hyrë në fuqi më 13 nëntor 2002.

## **3. Komiteti mbikqyrës i të drejtave të njeriut dhe grupi punues ndër-shtyllor mbi të drejtat e njeriut**

Më parë OSBE ka shprehur shqetësime përkitazi me mungesën e vështirimit të të drejtave të njeriut në Rregulloret e UNMIK-ut.<sup>158</sup> Në këtë drejtim, OSBE mirëpret njohjen e Komitetit mbikqyrës për të drejtat e njeriut (Komiteti) si dhe grupit punues ndër-shtyllor mbi të drejtat e njeriut (GPNSHDNJ), të themeluar në qershor 2002, i cili shënon një përmirësim të qartë të situatës që nga raporti i fundit i SMSL. Qëllimi i Komitetit është që të “marrë në konsiderim dhe të pajtohen përkitazi me veprimet dhe rregullat për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe për të siguruar që veprimet dhe rregullat e të gjitha shtyllave dhe zyrave të UNMIK-ut, të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”<sup>159</sup> GPNSHDNJ vepron si “ushqyes” për Komitetin dhe është i obliguar të “shqyrtoj nga aspekti i perspektivës së të drejtave të njeriut projekt rregulloret dhe udhëzimet administrative të përgatitura me iniciativën e komponentave të UNMIK-ut (dhe mundet gjithashtu) të shqyrtoj projektet e udhëzimeve administrative, urdhëresave dhe dokumenteve tjera legjislative, ekzekutive apo administrative nga perspektiva e të drejtave të njeriut.”<sup>160</sup> Çështjet e pa zgjidhura në GPNSHDNJ i prezentohen Komitetit kur kjo është e përshtatshme. Departamenti vepron si sekretar për Komitetin dhe kryesues i GPNSHDNJ. Sidoçoftë, OSBE vëren me keqardhje se në disa raste UNMIK-u ka dështuar të sjellë projekt legjislacionin para Komitetit për shqyrtim.

## **3. Hapja e gjykatave të reja në komunitetet minoritare dhe integrimi i vazhdueshëm gjyqësor**

Që nga raporti i kaluar, DD ka ndërmarrë hapa pozitiv drejt integritit të minoriteteve në gjyqësi. Krahas integritit dhe punësimit të gjykatësve dhe prokurorëve nga pakicat, kohëve të fundit janë hapur disa gjykata në komunitetet pakicave. UNMIK-u ka themeluar gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje në Leposavic/Leposaviq dhe Zubin Potok, të cilat që të gjitha zyrtarisht u hapën më 13 janar 2003. Krahas

<sup>158</sup> Lexo raportin e datërt, në faqe 11.

<sup>159</sup> Shprehjet e referencave të Komitetit mbikqyrës për të drejtat e njeriut (“Komiteti”) si dhe Grupit punues ndër-shtyllor mbi të drejtat e njeriut, në faqe 1.

<sup>160</sup> *Ibid*, në faqe 3.

kësaj, Departamenti i Gjykatës Komunale të Ferizajit/Urosevac dhe Gjykata për Kundërvajtje janë paraparë të hapen së shpejti në Strpce/Shtpce.<sup>161</sup>

Pasiqë një shtyrje e madhe për integrimin e gjykatësve, prokurorëve dhe personelit ndihmës është në proces e sipër, UNMIK-u mbetet përgjegjës për sigurimin që këta të cilët janë të punësuar në gjykata janë në gjendje që të arrijnë atje në mënyrë të sigurtë dhe të punojnë në një ambient të sigurtë. Deklarata e përbashkët mbi rekrutimin e gjykatësve dhe prokurorëve të përkatësisë etnike serbe në një sistem multi-etnik gjyqësor<sup>162</sup> në Kosovë, përmban dispozita mbi sigurinë për gjykatësit dhe prokurorët e rinj të emëruar, duke deklaruar se UNMIK-u do të sigurojë mbrojtje bazuar në vlerësimet individuale të kërcnimeve. OSBE do të monitorojë për së afërmi implementimin e këtij procesi. Në anën tjetër, personeli ndihmës gjyqësor duhet gjithashtu të sigurohet, posaçërisht personeli i cili udhëton prej enklavave. Në këtë drejtim, ishin bërë disa përmirësime të vogla.<sup>163</sup>

Krahas kësaj, pas një sërë vështirësive diplomatike dhe teknike, UNMIK-u është dëshmuar si i suksesshëm në punësimin e një numri substancial të gjykatësve dhe prokurorëve nga komunitetet minoritare në gjyqësinë e UNMIK-ut.<sup>164</sup>

#### 4. Qasja në gjykata

Njëri prej problemeve më të mëdha të qasjes publike gjyqësisë, mbetet qasja fizike në gjykata. Përderisa qasja në gjykata ndryshon theksueshëm prej regjionit në regjion,<sup>165</sup> që nga Raporti i fundit situata është përmirësuar. Në këtë drejtim është bërë referencë në Projektin për qasjen në gjykata në Graçanicë/Gracanica, i cili është zhvilluar nga DD Sekcioni për Integrim Gjyqësor (JDD). Ky projekt i cili ka filluar në janar 2003, siguron transport për qytetarët nga Graçanica (enklavë e Serbëve të Kosovës) deri te gjykatat e ndryshme në Prishtinë/Pristina. Si plotësim dy zyrtarë të ndërlidhjes me gjykata ofrojnë udhërrëfim dhe ndihmojnë në lidhjen në mes të popullatës në Graçanicë dhe gjykatave. Personat e zhvendosur (të cilët tani jetojnë në Serbi) kanë filluar gjithashtu të përdorin këtë shërbim.

Ekzistenca e gjykatave paralele në tërë Kosovën, vazhdon të ketë efekt në qasjen gjyqësisë për sa i përket serbëve të Kosovës. Për më tepër, instancat e përputhjes së kompetencës gjyqësore, dhe rreziku i dënimit të dyfishtë ende dokumentohen nga ana e OSBE.<sup>166</sup> Një prej efekteve të pretenduara të programit të UNMIK-ut për integrimin gjyqësor do të jetë shpërbërja e njëkohëshme e gjykatave paralele. Krijimi i

<sup>161</sup> Kjo ka bërë që të hapen disa konkurse për personelin ndihmës dhe Departamenti i Administratës Gjyqësore (DAGJ), me mbështetjen e DD, tani po i plotëson disa vende ndihmëse dhe anëtarët e komuniteteve minoritare kishin qenë inkurajuar të aplikojnë, lexo më tej vlerësimin e dhjetë mbi gjendjen e pakicave në Kosovë, mars 2003 në faqen 29.

<sup>162</sup> Kjo Deklaratë e përbashkët është nënshkruar më 9 korrik 2002 në mes të Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Serbisë dhe Përfaqësuesit të PSSP të UNMIK-ut për polici dhe gjyqësi për lehtësimin e mëtejshëm të rekrutimit të gjykatësve dhe prokurorëve serb të Kosovës, lexo më tej vlerësimin e dhjetë mbi gjendjen e pakicave në Kosovë, mars 2003 në faqen 29.

<sup>163</sup> Lexo më tej, vlerësimin e dhjetë mbi gjendjen e pakicave në Kosovë, mars 2003 në faqen 29-30.

<sup>164</sup> Një pjesë e madhe e “Dokumentit të përbashkët UNMIK-Jugosllavi” (Dokumenti i përbashkët) i cili është nënshkruar më 5 nëntor 2001, fokusohet në integrimin e minoriteteve në gjyqësi dhe konfirmon vendosmërinë e UNMIK-ut drejt vijimësisë së gjyqësisë multi-etnike duke punësuar më tepër gjykatës dhe prokuror serb të Kosovës, andaj duke adresuar shqetësimet e rrënjësura thellë për anshmërinë etnike. Procesi i integritit gjyqësor sidoçoftë ka qenë i ngadalshëm të shumtën për shkak të mosmarrëveshjeve diplomatike në mes të UNMIK-ut dhe Republikës së Serbisë. Sipas dokumentit UNMIK-u gjithashtu është pajtuar që të “krijoj dhe të angazhoj një njësi të re të DD i cili do të ishte përgjegjës për vazhdimësinë e përpjekjeve në këtë lëmi”, lexo më tej vlerësimin e dhjetë mbi gjendjen e pakicave në Kosovë, mars 2003 në faqen 29.

<sup>165</sup> Lexo më tej, vlerësimin e dhjetë mbi gjendjen e pakicave në Kosovë, mars 2003 në faqen 31.

<sup>166</sup> Lexo analizat ligjore dhe vlerësimet në *OSBE/UNHCR vlerësimin e përbashkët të nëntë të gjendjes së pakicave në Kosovë*-shtator 2001 deri në prill 2002 (në tekstin e mëtejshëm vlerësimi i nëntë). Rastet e mëtejme me rrezik të dënimit të dyfishtë ishin monitoruar nga OSBE gjatë periudhës së tanishme raportuese.

gjykatave komunale dhe atyre për kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposavic do të përforcojë kompetecat e UNMIK-ut mbi komunat veriore, dhe fenomeni i gjykatave paralele duhet të filloj të shuhet. Rekrutimi i gjykatësve, prokurorëve dhe personelit ndihmës për këto gjykata do të jetë në proporcion të drejtëpërdrejtë me përbërjen etnike të popullatës. Vetëm gjykatësit serb të Kosovës me gjasë do të emërohen për këto gjykata të reja në veri. Gjithashtu pritet që integrimi i gjykatësve serb të Kosovës në gjykatat në Mitrovicë, do të dobësojë gjykatën paralele në Zvečan/Zveçan.

#### **5. *Statusi i Kodit të përkohshëm penal dhe i Kodit të përkohshëm të procedurës penale***

Kodi i përkohshëm penal (KPP) dhe Kodi i përkohshëm i procedurës penale (KPPP), tani rishtazi janë dërguar nga UNMIK-u tek Kryeministri i Kosovës për shqyrtim nga Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës. Më 7 maj 2003 Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese shqyrtoi draftin e Ligjeve të përkohshme dhe i parashtrori rekomandimet e veta Parlamentit të Kosovës. Kur komentet dhe observimet nga Qeveria dhe Parlamenti t'i jenë komunikuar UNMIK-ut, Kodet do të shqyrtohen dhe shtohen, nëse nevojitet dhe menjëherë do të promulgohen.

Shqyrtimi dhe revizioni i kodeve ishte ndërmarrë nga Zyra e këshilltarit ligjor të UNMIK-ut pas finalizimit të drafteve fillestare nga Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës mbi Qështjet Legjislative në nëntor 2001 në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës. Procesi gjithashtu kishte kyqur edhe OSBE-në, Këshillin e Evropës, UNICEF-in, dhe Odën e avokatëve amerikan për iniciativën ligjore për Evropën Lindore e Qendrore, juristët e Kosovës, siç janë gjykatësit dhe prokurorët sikurse edhe akademikët. Më 12 maj 2003 draft Ligjet e përkohshme I ishin parashtruar GPNSHDNJ, për shqyrtim nga perspektiva e të drejtave të njeriut.